

**RAPORT
PËR PUNËN E FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL
DHE INVALIDOR TË MAQEDONISË
PËR VITIN 2011**

Shkup, prill viti 2012

PËRMBAJTJA

I. HYRJE

3

II. TË DHËNA STATISTIKORE

8

1. Numri i të siguruarve

8

2. Numri i përfituesve të pensionit

10

3. Përfitues me vlerë më të ulët të pensionit

15

4. Përfitues të kompensimit në të holla me aftësi të ngelur për punë

17

5. Përfitues të kompensimit në të holla për dëmtim fizik

18

6. Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor

19

III. HARMONIZIMI I PENSIONEVE

20

IV. PUNA FINANCIARE E FONDIT

27

1. Të hyrat e Fondit

28

2. Të dalat e Fondit

34

3. Rezultate financiare

41

4. Aksione dhe pjesë

42

5. Pagesa e kontributeve të prapambetura

43

6. Informimi

45

V. REALIZIMI I TË DREJTAVE DHE ZBATIMI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

1. Zgjidhje e kërkesave në shkallën e parë

48

2. Përgatitje e vendimeve për të drejtat në shkallë të dytë

54

3. Realizim i të drejtave sipas marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social

60

4. Puna e Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë

65

5. Stazhi i sigurimit që konsiderohet me kohëzgjatje të shtuar

72

6. Evidentimi amë

74

7. Pagesa e pensioneve

78

8. Puna pronësores - juridike

81

9. Organet e menaxhimit të Fondit

84

1. Këshilli drejtues

84

2. Drejtori

86

10. Shërbimi profesional i Fondit

87

1. Organizimi i Shërbimit profesional të Fondit

87

2. Resurset njerëzore

92

3. Puna e Njësisë aktuaristikës

96

4. Puna e Seksionit për revizion të brendshëm

100

5. Kontrolli buxhetor

105

6. Furnizime publike

106

7. Fondi solidar

108

11. Sistemi i informatikës

112

12. Ekonomizimi me pronën e Fondit dhe standardi shoqëror i shfrytëzuesve të pensionit

117

VI. PËRFUNDIM

121

RAPORT PËR PUNËN E FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR TË MAQEDONISË PËR VITIN 2011

I. HYRJE

Sigurimi pensional dhe invalidor është segment i rëndësishëm në sigurimin social të Republikës së Maqedonisë. Zhvillimi i këtij sigurimi varet nga totali i lëvizjeve ekonomike, sociale dhe demografike në shoqëri të cilët direkt apo indirekt ndikojnë në sistemin e pensionimit të secilit vend. Rëndësia e sigurimit pensional dhe invalidor shprehet përmes numrit të të siguruarve të cilët paguajnë kontribut për sigurim pensional dhe invalidor, numri i përfituesve të pensionit dhe anëtarët e familjarëve të tyre të cilët jetojnë nga pensioni dhe lartësia e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor.

Raporti për punën e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë për vitin 2011 përmban të dhëna të detajuara, individuale dhe gjithëpërfshirëse me arsyetime të detajuara dhe komente për rezultatet e realizuara nga zbatimi i sigurimit pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, në raportin vjetor janë paraqitur të dhënat statistikore për të drejtat e realizuara nga sigurimi pensional dhe invalidor, të dhënat financiare për punën e Fondit, të dhëna për zgjidhjen e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, evidentimi amë, standardi shoqëror i përfituesve të pensionit si dhe të dhëna të tjera. Aktivitetet e Fondit janë të shumta dhe të ndryshme dhe të njëjtat ndikojnë në popullatën e moshuar në Vend, ndërsa në mënyrë indirekte edhe në anëtarët e familjeve të tyre.

Sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë zbatohet si sigurim i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratave (Shtylla e parë), sigurim pensional i detyrueshëm me financim kapital (Shtylla e dytë) dhe sigurim pensional vullnetar (Shtylla e tretë) në bazë të kursimit të kapitalizuar individual.

Në shtyllën e parë dhe të dytë nga sistemi i pensionimit detyrimisht janë përfshirë të gjithë të punësuarit në bazë të marrëdhënies së punës dhe kryerjen e detyrës, ndërsa shtylla e tretë është në bazë vullnetare.

Punët të cilët janë në kompetencë të Fondit në vitin 2011 janë kryer me pëlqim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, Buxhetit të Fondit dhe Programit për punën e Këshillit drejtues të Fondit.

Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor janë vërtetuar me ligje, dhe të njëjtave u është siguruar shkallë e dytë në procedurë dhe mbrojtje gjyqësore.

Në kuadër të sigurimit pensional dhe invalidor, sigurimin e saj social e realizojnë mbi 293.000 përfitues të së drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor apo 14,2% nga gjithsej popullsia e Republikës së Maqedonisë për vitin 2011 (2.057.284), ndërsa pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor arrin 9,7%.

Organe qeverisëse të Fondit janë Këshilli drejtues i Fondit dhe Drejtori i Fondit. Këshilli drejtues ka nëntë anëtarë të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë, ndërsa të njëjtit janë zgjedhur nga radhët e të siguruarve në periudhë prej katër vitesh.

Në fund të vitit 2011 numri i të siguruarve të pensionit arrinte në 489.608, përderisa numri i përfituesve të pensionit arrinte 280.891 përfitues (së bashku me përfituesit minimal të bujqve dhe përfituesit ushtarak) apo në lidhje me 1,74 të siguruar në 1 pensionist.

Në vitin 2011 Fondi realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 43.937,09 milion denarë dhe gjithsej të dala në shumë prej 44.305,77 milion denarë. Në punën

financiare të Fondit ndikim kishte edhe kriza ekonomike e cila solli që mos të realizohen në tërësi indikatorët e parashikuar makroekonomik të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e të hyrave nga kontributet. Për shkak të gjendjes së këtillë financiare, Fondi në vitin 2011 për pagesën e pensioneve në kohë të duhur, në afatet e caktuara gjatë pagesës së pensioneve shfrytëzonte hua nga Buxheti i Vendit.

Në vitin 2011, Fondi zbatoi harmonizim të pensioneve nga 1 janari për 0,75% dhe prej 1 korrikut për 2,10% që kishte ndikim në mirëmbajtjen e vlerës reale të përfitimeve pensionale.

Me harmonizimin e zbatuar të pensioneve, pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2011 (nga e drejta e punës) arriti në 10.628,00 denarë dhe në raport me vitin 2010 është më e lartë për 3,9%, ndërsa së bashku me pensionet minimale dhe pensionet ushtarake, pensioni mesatar arrinte në 10.701 denarë.

Në vitin 2011, Fondi udhëheqte politikë restriktive kadrovike në mbështetje me masat anti krizë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që mos të pranohen punonjës të rinj në vendet e lira në bazë të pensionimit apo kalimit në tjetër vend pune.

Në vitin 2011 filloi zbatimi i Projektit mbështetje teknike për dizajnimin e proceseve të reja afariste për realizimin e të drejtës për pagesën e pensioneve, me të cilin u soll proces i plotë i automatizuar i punës dhe shkurtesë të afatit kohor për zgjidhjen e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe pagesën e pensioneve.

Gjithashtu, në vitin 2011 u qasën ndaj implementimit të pjesërishëm të softuerit për resurse njerëzore HeRmes i cili mundësoi azhurnimin e evidencës kadrovike të punonjësve, sjellja e evidencës elektronike e orarit të punës në bashkëpunim me Filialet dhe Ekspoziturat e Fondit ndërsa me atë u lehtësua puna në më shumë segmente lidhur me punën e Shërbimit profesional të Fondit.

Gjatë vitit 2011 janë zgjidhur 33.136 kërkesa sipas gjitha bazave për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor (për pensione familjare, të pleqërisë dhe invalide, kompensime nga sigurimi invalidor, përcaktimin e stazhit të pensional dhe kërkesa të tjera), prej të cilave 19.414 kërkesat e para për realizimin e të drejtës së pensionit.

Fondi në vitin 2011 u ka paguar pensione 280.891 përfituesve të pensionit (ushtarake dhe minimale bujqësore) me vlerë mesatare mujore të të dalave në shumë prej 2.980,00 milion denarë në neto shumën dhe 377,00 milion denarë kontribut për sigurim shëndetësor apo së bashku 3.357,00 milion denarë.

Në vitin 2011, Enti shtetëror për revizion zbatoi revizion në punën financiare dhe revizion të përputhjes së Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor për vitin 2010. Gjithashtu, në vitin 2011 nga Enti shtetëror për revizion ishte i parashtruar Raport përfundimtar për revizionin e zbatuar të realizimit të drejtës së pensionit të pleqërisë dhe familjar për vitin 2009. Lidhur me revizionin në raportet financiare të Fondit për vitin 2010, Revizori i autorizuar shtetëror shprehu mendim se pasqyrat financiare paraqesin një pozicion të drejtë dhe korrekt të gjendjes financiare të Fondit, sipas gjitha aspekteve të rëndësishme, ndërsa rezultati nga aktivitetet financiare për vitin e njëjtë është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë është realizuar shfrytëzim ligjor dhe i qëllimtë i mjeteve.

Në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve të transferit nga Buxheti i Vendit, të cilat nga viti në vit zmadhohen, ndërsa transferimi i mjeteve të buxhetit për nevojat e Fondit zbatohet përmes Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, revizioni është i mendimit për shfrytëzim më efikas të këtyre mjeteve, transferimi i mjeteve buxhetore nga Buxheti i Vendit të zbatohet në mënyrë direkte në llogari të Fondit.

Nga 1 janari i vitit 2011 Fondi mundet që të realizon edhe mjete nga shitja e aksioneve dhe pjesëve të fituar në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror, deri më 100% nga kapitali i përgjithshëm i fituar sipas kësaj baze. Pikërisht, me ndryshimin e nenit 172-a nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 83/2010) kufizimi ligjor për shitje deri më 70% nga kapitali i përgjithshëm i Fondit vlente deri në fund të vitit 2010, ndërsa në vitin 2011 u mundësua shitje e plotë e aksioneve dhe pjesëve nga portfolio-ja e Fondit.

Fondi në vitin 2011 në mënyrë aktive morri pjesë në zbatimin e projektit të Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për “Rekreacion të banjës klimatike“ për përfituesit e pensionit. Parashtrimi i kërkesave si dhe përpunimi elektronik i të njëjtave zbatoheshin në Fond, mandej të njëjtat dorëzoheshin deri në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale ku ishte formuar Komision kompetent për rangimin e kërkesave të parashtruara. Pas rangimit të kryer nga ana e Komisionit deri te Fondi janë dorëzuar listat e shfrytëzuesve të pensionit të cilëve u është miratuar shfrytëzimi i shërbimit. Shërbimi profesional i Fondit me shkrim (përmes postës) dhe nëpërmjet telefonit njoftoi shfrytëzuesit e pensionit, ndërsa njëkohësisht listat janë shpallur edhe në ueb faqen e Fondit. Përfituesve të cilëve u ishte miratuar rekreacioni - klimaterik në banjë, Fondi ju lëshonte mjete për transport në llogarinë e transaksionit, ndërsa më pas Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të njëjtat mjete ia dedikonte Fondit.

II. TË DHËNA STATISTIKORE

1. Numri i të siguruarve

Në vitin 2011, Fondi ç'do muaj mbante evidencë për gjithsej numrin e të obliguarve dhe të siguruarve i cili në dhjetor të vitit 2011 arrinte në 489.608 të siguruar.

Tabela 1. Numri i të obliguarve dhe të siguruarve

Nr. rendor	Filiali	Të obliguar	Të siguruar
1	Berovë	662	3.011
2	Manastir	4.417	25.254
3	Vallandovë	357	2.272
4	Veles	2.141	11.854
5	Vinicë	580	4.266
6	Gjevgjeli	1.633	10.257
7	Gostivar	3.543	10.777
8	Dibër	700	2.300
9	Dellçevë	760	5.129
10	Demir Hisar	299	1.381
11	Kavadar	1.811	9.900
12	Kërçovë	1.899	6.464
13	Koçanë	1.723	9.913
14	Kratovë	248	1.331
15	Kriva Pallankë	602	3.004
16	Krushevë	273	937
17	Kumanovë	3.899	19.552
18	Makedonski Brod	280	1.049
19	Negotinë	1.049	4.979
20	Ohër	2.790	15.491
21	Prilep	3.567	19.108
22	Probishtip	467	2.946
23	Radovish	1.122	4.682
24	Resnjë	558	2.922
25	Shën Nikollë	923	4.485
26	Strugë	2.355	9.460
27	Strumicë	3.537	16.878
28	Tetovë	5.364	20.651
29	Shtip	2.029	19.292
30	Shkup	28.122	240.063
Gjithsej		77.710	489.608

Numri i të obliguarve arrin 77.710 prej të cilëve 28.122 apo 36,2% nga gjithsej numri gjenden në Shkup, ndërsa numri i të siguruarve arrin 489.608 të siguruar, nga të cilët 240.063 të siguruar apo 49,0% janë të regjistruar në Shkup.


Sipas të dhënave të Fondit, numri i të siguruarve (gjendja në dhjetor të vitit 2011) arrin 436.688 të siguruar apo 89,2% nga gjithsej numri i të siguruarve (489.608). Krahasimi në mes të siguruarve të cilët paguajnë kontribut dhe gjithsej numri i përfituesve të pensionit (280.891) arrin 1,55 të punësuar në një përfitues të pensionit, ndërsa krahasimi mes numrit të përgjithshëm të të siguruarve dhe përfituesve të pensionit arrin 1,74 të siguruar në 1 përfitues të pensionit.

Tabela 2: Numri i shfrytëzuesve të pensionit dhe numri i personave të punësuar

Viti	Numri i të puësuarve	Numri i përf. të pensionit (pa pens. mini.bujq. dhe ushtarake)	Numri i përfitues të pensionit në 1000 të punësuar	Numri i të punësuarve në 1 përfitues të pensionit
1991	534.887	180.749	338	3.0
1992	531.083	193.294	364	2.7
1993	503.010	210.537	418	2.4
1994	468.632	216.834	463	2.2
1995	427.658	219.307	513	2.0
1996	403.820	222.727	552	1.8
1997	381.723	227.099	596	1.7
1998	370.869	232.216	626	1.6
1999	374.025	235.839	631	1.6
2000	367.162	241.221	657	1.5
2001	351.009	247.200	704	1.4
2002	332.728	249.421	750	1.3
2003	321.105	254.262	775	1.3
2004	348.212	260.075	747	1.3
2005	348.500	265.152	761	1.3
2006	394.882	269.681	714	1.46
2007	424.338	272.386	693	1.55
2008	451.491	273.281	654	1.65
2009	475.780	273.977	576	1.74
2010	466.280	273.751	587	1.70
2011	489.608	280.891	573	1,74

Numri i të sigurve të regjistruar në dhjetor të vitit 2011 arrin 489.608 të sigurve dhe i njëjti në krahasim me numrin e të sigurve në dhjetor të vitit 2010 prej 466.280 është më i madh për 23.328 të sigurve, ndërsa numri i të sigurve për të cilët paguhet kontribut rritet prej 413.797 në vitin 2010 në 436.688 të sigurve në dhjetor të vitit 2011 apo më shumë për 5,5%.

Numri i të sigurve, përfituesve të pensionit dhe krahasimi i tyre është i dhënë në grafikonin e më poshtëm:



2. Numri i përfituesve të pensionit

Numri i përfituesve të pensionit, me gjendje më 31.12.2011 arrin 277.441 përfitues, prej të cilëve 156.016 përfitues të pensionit të pleqërisë apo 56,2% nga gjithsej numri i përfituesve të pensionit; 44.895 përfitues të pensionit invalidor apo 16,2% dhe 76.530 përfitues të pensionit familjar apo 27,6%.

Tabela 3: Numri i përfituesve të pensionit në fund të vitit 2011 dhe 2010

Nr. r.	Lloji i pensionit	Përfitues të pensionit 31.12.2010	Përfitues të pensionit 31.12.2011	Rritje/reduktim	Indeks 2011/2010
1	Pleqërisë	151.894	156.016	4.122	102,7
2	Invalidor	46.118	44.895	-1.223	97,3
3	Familjarë	75.739	76.530	791	101,0
	Gjithsej	273.751	277.441	3.690	101,3

Numri i përfituesve të pensionit në vitin 2011 është rritur për 3.690 pesnionist në raport me vitin 2010, gjegjësisht për 1,3% nga gjithsej numri i përfituesve të pensionit, si rezultat i rritjes së numrit të kërkesave të parashtruara për realizimin e të drejtës të pensionit të pleqërisë.

Rritje e numrit të përfituesve të pensionit në vitin 2011 është realizuar te përfituesit e pensionit të pleqërisë për 4.122 përfitues të rinj apo për 2,7% dhe 1,0% tek përfituesit e pensionit familjar, ndërsa reduktim ka tek përfituesit e pensionit invalidor për 2,7% apo për 1.223 përfitues.


Në Fond paguhen pensione edhe për 2.007 përfitues të pensionit ushtarak dhe 1.443 përfitues të pensionit minimal bujqësor, me të cilët numri i përgjithshëm i përfituesve të pensionit në fund të vitit arrin 280.891 përfitues. Pranë kësaj Fondi paguan dhe 2.085 përfitues të dëmtimit fizik si e drejtë e vetme nga sigurimi pensional dhe invalidor, gjegjësisht Fondi paguan 282.976 përfitues të drejtës në mbështetje të Ligjit për sigurim pesnional dhe invalidor.

Tabela 4. Gjendja sipas llojit të pensionit

Nr.r.	Loji i pensionit	Gjendje më 31.12.2010	Gjendje më 31.12.2011	Indeks
1	Përfitues të pensionit	273.751	277.441	101,3
2	Pensione ushtarake	2.161	2.007	92,9
3	Pensione të bujqve	1.817	1.443	79,4
4	Gjithsej	277.729	280.891	101,1

Gjithsej numri i përfituesve të pensionit (së bashku me pensionet minimale ushtarake dhe bujqësore) është më i madh për 3.162 përfitues të pensionit në raport me vitin 2010 apo 1,1% edhe atë për shkak të reduktimit të pensioneve minimale të bujqëve për 154 përfitues dhe për 374 përfitues të pensioneve ushtarake. Këto përfitues edhe në të ardhmen do të zvogëlohen me defluks natyror për shkak se këto përfitues të drejtën e tyre e kanë realizuar sipas dispozitave ligjore të cilat tanimë nuk zbatohen, ndërsa të drejta të reja nuk realizohen.

Struktura e përfituesve të pensionit sipas llojit të pensionit paraqitet në vijim:



Fluksi i përfituesve të rinj të pensionit të pleqërisë prej vitit 1991 deri në vitin 2011 është dhënë në grafikonin në vijim:





Tabela 5: Shkalla e rritjes e përfituesve të pensionit prej vitit 1991 - 2011 sipas llojit të pensionit

Periudha	Pleqërisë	Invalidor	Familjarë	Gjithsej
1992-1991	7,8	7,4	5,0	6,9
1993-1992	11,6	6,9	5,2	8,9
1994-1993	2,5	3,7	3,5	3,0
1995-1994	-0,3	2,3	3,3	1,1
1996-1995	0,7	2,0	3,0	1,6
1996-1991	23,1	24,1	21,7	23,2
1997-1996	1,0	3,1	3,1	2,0
1998-1997	0,9	3,7	3,0	2,3
1999-1998	1,2	1,7	2,3	1,6
2000-1999	3,0	0,9	2,0	2,3
2001-2000	3,3	0,1	2,8	2,5
2002-2001	1,0	-0,2	1,5	0,9
2003-2002	2,6	-0,5	2,6	1,9
2004-2003	3,6	-1,2	2,4	2,3
2005-2004	3,6	-2,7	2,1	2,0
2006-2005	2,8	-1,6	1,8	1,7
2006-1996	26	4,1	26,1	21,1
2007-2006	2,2	-2,7	1,1	1,0
2008-2007	-0,3	1,1	1,0	0,3
2009-2008	0,3	-1,3	1,2	0,3
2010-2009	1,2	-3,8	-0,3	-0,1
2011-2010	2,7	-2,7	1,0	1,3

Rritja e numrit të përfituesve të pensionit nga viti 1991 – 2011 është paraqitur në grafikonin e më poshtëm:




Fluksi i përfituesve të pensionit invalidor duke filluar nga viti 2004 gradualisht reduktohet, kryesisht për shkak të kushteve të rrepta për arritjen e të drejtës të pensionit invalidor.

Tabela 6: Lëvizja e numrit të përfituesve të pensionit sipas viteve

Viti	Pensioni i pleqërisë	Pensioni invalidor	Pensioni familjar	Gjithsej
1991	94.676	38.206	47.867	180.749
1992	102.021	41.030	50.243	193.294
1993	113.799	43.867	52.871	210.537
1994	116.617	45.472	54.745	216.834
1995	116.241	46.509	56.557	219.307
1996	116.560	47.431	58.254	222.245
1997	118.148	48.909	60.042	227.099
1998	119.194	51.208	61.814	232.216
1999	120.574	52.060	63.205	235.839
2000	124.210	52.549	64.462	241.221
2001	128.322	52.619	66.259	247.200
2002	129.648	52.514	67.259	249.421
2003	133.008	52.237	69.022	254.267
2004	137.840	51.589	70.646	260.075
2005	142.827	50.180	72.145	265.152
2006	146.852	49.364	73.465	269.681
2007	150.075	48.364	74.257	272.696
2008	149.682	48.562	75.037	273.281
2009	150.092	47.947	75.937	273.976
2010	151.894	46.118	75.739	273.751
2011	156.016	44.895	76.530	277.441

Paraqitje grafike e lëvizjes së numrit të përfituesve të pensionit



Sipas trafikonit të dhënë, del se më shumë se gjysma (56,2%) nga gjithsej numri i përfituesve të pensionit janë përfitues të pensionit të pleqërisë, ndërsa pjesa tjetër i dedikohet përfituesve të pensionit familjar dhe invalidor.

3. Përfitues të vlerës më të ulët të pensionit

Tabela 7: Numri i lartësisë së pensionit të përfituesve me shumë më të ulët të pensionit

GRUPET	Numri i përfituesve	Shuma e pensionit (denarë)
Grupi i parë		
Pensione të realizuara deri më 31.12.1996	2.825	8.274,50
Pensione të realizuara nga 1997-2001	7.974	6.816,50
Pensione të realizuara pas 2001	20.289	7.308,00
Gjithsej grupi i parë (mbi 35 vjet meshkujt dhe mbi 30 vjet femrat)	31.088	
Grupi i dytë		
Pensione të realizuara deri 31.12.1996	960	8.052,00
Pensione të realizuara nga 1997-2001	2.096	6.307,00
Pensione të realizuara pas 2001	12.979	6.773,00
Gjithsej grupi i dytë (mbi 25 vjet meshkujt dhe mbi 20 vjet femrat)	16.035	
Grupi i tretë		
Pensione të realizuara deri 31.12.1996	4.886	7.766,50
Pensione të realizuara nga 1997-2001	7.690	5.795,50
Pensione të realizuara pas 2001	18.006	6.238,00
Gjithsej grupi i tretë (deri 25 vjet meshkujt dhe mbi 20 vjet femrat)	30.582	
Gjithsej	77.705	

Vlera më e ulët e pensionit përcaktohet në mënyrë të pavarur nga lartësia e pensionit e ndarë në bazë të kohëzgjatjes së stazhit pensional dhe pagave të realizuara. Ajo do të thotë se të siguruarit i garantohet vlera e pensionit që është më e lartë nga pensioni i ndarë nga kohëzgjatja e stazhit pensional si dhe pagat e realizuara. Instituti i vlerës më të ulët të pensionit është i bazuar në pranimin e drejtësisë shoqërore si dhe lartësia e tij varet nga lartësia e kontributit të punës i shprehur në kohëzgjatjen e stazhit pensional edhe pse e njëjta është më e ulët, përfituesit i paguhet deri në pensionin më të ulët.

Në Fond, në fund vit paguhen pensione minimale të 77.705 përfituesve edhe atë: 30.582 përfitues apo 39,4% nga gjithsej numri i përfituesve të pensioneve minimale, prej grupit të tretë gjegjësisht me stazh më të ulët pensional (deri 25 vjet meshkujt, gjegjësisht deri 20 vjet femrat) në 16.035 përfitues nga grupi i dytë (mbi 25 vjet meshkujt dhe mbi 20 vjet femrat) apo 20,6% dhe në 31.088 përfitues të pensionit të grupit të parë (mbi 35 vjet meshkujt dhe mbi 30 vjet femrat) apo 40,0% nga gjithsej numri minimal i pensioneve. Numri i përfituesve të pensionit me shumë më të ulët të pensionit në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 (76.543) është i zmadhuar për 1,5% si rezultat i realizimit të pensioneve më të ulëta të përfituesve të rinj të cilët të drejtën e pensionit e kanë realizuar në vitin 2011.

Pavarësisht nga ky numër 37.002 përfitues të pensionit realizojnë të drejtën e pensionit me vlerë të pensionit mes grupeve. Me këta përfitues numri i përfituesve të pensionit të cilët pranojnë pensione më të ulëta, gjegjësisht pension deri më 8.274,50 denarë arrin 114.707 përfitues apo 41,0% nga gjithsej numri i përfituesve të pensionit. Mjetet për dallimet nga shuma e vërtetuar e pensionit deri në shumën që paguhet sigurohen nga Buxheti i Vendit.

4. Përfitues të kompensimit në të holla me aftësi të ngelur për punë


Në Fond në fund të vitit 2011 kishte 171 përfitues të cilët 145 për kohën e pritjes të punësimit të tyre apo ndonjë pune tjetër përkatëse, 16 përfitues me orar të shkurtuar pune dhe 10 përfitues për shkak të të ardhurave të ulëta personale në punë tjetër përkatëse. Në mbështetje me nenin 53 nga Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 153/2007), përfituesit e kompensimit në të holla në bazë të aftësisë së zvogëluar për punë në barë të mjeteve të Fondit të cilët këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar deri me hyrjen e këtij Ligji në fuqi sipas obligimit zyrtar kaluan në pensione invalidore sipas bazës së paaftësisë profesionale për punë, llogaritur nga 1 janari i vitit 2008.

Përfituesit e përhershëm të kompensimit në të holla deri në punësim, kompensimin e pagës për punë në tjetër vend pune dhe me orar të shkurtuar të punës, janë ata përfitues të cilët të drejtën e tyre e kanë realizuar para vitit 1997 dhe të njëjtën si të drejtë të fituar e realizojnë në Fond.

Tabela 8: Numri i përfituesve të kompensimit në të holla nga viti 1997 - 2011

Lloji i të drejtës Viti	Koha e pritjes për punë	Orar i shkurtuar i punës	Pagë e ulët	Të ngelura	Gjithsej
1997	947	1196	1616	1016	4775
1998	946	972	1501	972	4391
1999	950	837	1364	910	4061
2000	897	573	1115	812	3397
2001	893	286	733	724	2636
2002	1035	200	616	676	2527
2003	1123	147	332	645	2247
2004	1180	130	265	488	2063
2005	1407	90	170	0	1667
2006	1659	63	106	0	1828
2007	1768	67	113	0	1948
2008	202	15	8	0	225
2009	183	14	9	0	206
2010	158	13	6	0	177
2011	145	16	10	0	171

Në tabelën vijuese grafiki është paraqitur lëvizja e numrit të përfituesve të kompensimit në të holla sipas viteve.



Në vitin 2011 për përfituesit e kompensimit në të holla janë paguar mjete në shumë prej 8,12 milion denarë apo 4,4% më pak nga viti i kaluar.

5. Përfitues të kompensimit në të holla për dëmtim fizik

Numri i përfituesve të cilët pranojnë kompensim në të holla për dëmtim fizik në vitin 2011 arrinte 11,633 përfitues, prej të cilëve 2.085 përfitues të së drejtës së vetme dhe 9.548 përfitues me të drejtë pensioni. Numri i përfituesve për dëmtim fizik në vitin 2011, në krahasim me vitin 2010, është reduktuar për 412 përfitues apo për 3,5%.


6. Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor

Të dalat për sigurim pensional dhe invalidor, bruto prodhimi vendor dhe krahasimi i tyre janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 9: Të dala për SPI, BPV dhe pjesëmarrja e të dalave në BPV

Viti	Gjithsej të dala për SPI	BPV	Pjesëmarrja e të dalave për SPI në BPV
	në million denarë		
1990	60,87	506	12,0
1991	104	920	11,3
1992	1.337	11.794	11,3
1993	9.412	59.165	15,9
1994	18.445	146.409	12,6
1995	18.296	169.521	10,8
1996	18.925	176.444	10,7
1997	19.504	186.018	10,5
1998	20.533	194.979	10,5
1999	20.681	209.010	9,9
2000	22.942	236.389	9,7
2001	24.697	233.841	10,6
2002	25.889	243.970	10,6
2003	27.764	253.493	11,0
2004	29.117	258.751	11,3
2005	29.029	276.989	10,5
2006	31.207	298.140	10,5
2007	32.770	333.845	9,8
2008	38.733	405.014	9,6
2009	41.393	396.496	10,4
2010	42.507	425.628	10,0
2011	44.306	455.387	9,7

Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në vitin 2011 arrin 9,7% dhe e njëjta në raport me vitin 2010 është reduktuar për 0,3 pikë të indeksit.



III. HARMONIZIMI I PENSIONEVE

Harmonizimi i pensioneve nga 1 janari i vitit 2011 është kryer në mbështetje me nenin 37 nga ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor edhe atë: për 50% nga lëvizja e neto pagës mesatare të paguar të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë dhe 50% nga lëvizja e indeksit të shpenzimeve për jetë. Pensionet u harmonizuan nga 1 janari dhe 1 korriku sipas përqindjes e cila fitohet si mbledhje e lëvizjes së indeksit të shpenzimeve jetësore në gjashtëmujorin paraprak dhe përqindjen e lëvizjes të (bruto) pagës mesatare të paguar të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë në gjashtëmujorin paraprak në raport me gjashtëmujorin i cili i paraprinë.

Në mbështetje me dispozitat aktuale, ndërsa sipas të dhënave statistikore të shpallura nga ana e Entit shtetëror statistikor për rritjen e pagave të të punësuarve në Vend dhe Shpallja për lëvizjen e shpenzimeve për jetesë në Republikën e Maqedonisë, pensionet nga 1 janari i vitit 2011 janë rritur për 0,75% dhe nga 1 korriku për 2,10% apo gjithsej harmonizimi arrin 2,86%.

Harmonizimi i pensioneve në periudhën prej vitit 2001 deri në vitin 2011 është dhënë në pasqyrën vijuese:

Tabela 10 : Harmonizim i kryer i pensioneve prej vitit 2001 - 2011

Viti	Harmonizim i pensioneve më 1 janar	Harmonizim i pensioneve më 1 korrik	Gjithsej harmionizmi
2001	1,79%	-	1,79%
2002	0,63%	5,90%	6,56%
2003	2,97%	2,68%	5,72%
2004	0,80%	0,41%	1,21%
2005	-	0,40%	0,40%
2006	0,48%	2,18%	2,67%
2007	0,64%	1,04%	1,69%
2008*	13,00%	7,65%	21,66%
2009	3,50%	2,02%	5,59%
2010	0,30%	1,10%	1,40%
2011	0,75%	2,10%	2,86%

*Harmonizim i rregullt dhe plotësues

Në periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2011 pensionet më së shumti u rritën në vitin 2008, për shkak të harmonizimit plotësues të pensioneve me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të cilët kontribuan për të rritur vlerën reale të pensioneve dhe të përmirësohet siguria sociale dhe materiale e përfituesve të pensionit.

Me harmonizimet e kryera të pensioneve, pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2011 (nga e drejta e punës) arrinte 10.682 denarë, dhe e njëjta në krahasim me

vitin 2010 është më e lartë për 3,9%, ndërsa pensioni mesatar së bashku me përfituesit e pensioneve minimale të bujqve dhe ushtarake arrinte shumën në 10.701 denarë.

Tabela 11: Pensionet mesatare (nga e drejta e punës) sipas llojit, në dhjetor të vitit 2010 dhe 2011 arrijnë edhe atë:

Lloji i pensioneve	2010	2011	Indeks
	Në denarë		
Pension i pleqërisë	11.615	12.096	104,1
Pension invalidor	9.212	9.539	103,5
Pension familjar	8.225	8.473	103,0
GJITHSEJ	10.273	10.682	103,9

Krahasimi i pensionit mesatar (paguar në dhjetor të vitit 2011 prej 10.682 denarë) dhe paga mesatare (për muajin dhjetor të vitit 2011 prej 21.415 denarë) në Vend arrin 49,9% ndërsa për pensionin e pleqërisë pjesëmarrja arrin 56,5%.

Në grafikonin në vijim është treguar krahasimi i pensionit sipas llojit, në krahasim me pagën mesatare:




Tabela 12: Paga mesatare dhe pensione mesatare (në dhjetor) sipas llojit prej vitit 1991 - 2011

Viti	Paga neto	Pensioni i pleqërisë	Pensioni invalidor	Pensioni familjar	Gjithsej pension
	në denarë				
1991	119,74	86,53	62,7	59,39	79,31
1992	1.339,95	1.200,50	866,83	826,32	1.032,60
1993	6.315,00	5.327,00	3.912,00	3.742,00	4.634,00
1994	8.424,00	6.140,00	4.500,00	4.374,00	5.350,00
1995	8.435,00	6.438,50	4.735,00	4.623,50	5.609,00
1996	8.931,00	6.558,00	4.872,50	4.707,00	5.715,00
1997	9.096,00	6.634,00	4.969,50	4.733,50	5.773,00
1998	9.694,00	6.607,00	5.007,50	4.717,00	5.751,00
1999	10.029,00	7.188,00	5.439,00	5.132,00	6.251,00
2000	10.526,00	7.394,00	5.563,00	5.281,00	6.431,00
2001	10.592,00	7.498,00	5.672,00	5.354,50	6.535,00
2002	11.550,00	7.982,00	6.060,00	5.673,00	6.955,00
2003	11.955,00	8.421,00	6.425,00	5.971,00	7.346,00
2004	12.534,00	8.492,00	6.509,00	6.023,00	7.428,00
2005	13.125,00	8.517,00	6.543,00	6.018,00	7.463,00
2006	13.854,00	8.765,50	6.746,50	6.150,00	7.683,50
2007	15.543,00	8.947,00	6.898,00	6.243,00	7.848,00
2008	17.363,00	10.762,00	8.560,00	7.739,00	9.541,00
2009	20.483,00	11.347,00	9.079,00	8.126,00	10.057,00
2010	21.454,00	11.615,00	9.213,00	8.225,00	10.273,00
2011	21.415,00	12.096,00	9.539,00	8.473,00	10.682,00

Tabela 13: Pjesëmarrje e pensioneve në pagën mesatare

Viti	Pensioni i pleqërisë	Pensioni invalidor	Pensioni familjar	Gjithsej pension
	%			
1991	72,3	52,4	49,6	66,2
1992	89,6	64,7	61,7	77,1
1993	84,4	61,9	59,3	73,4
1994	72,9	53,4	51,9	63,5
1995	76,3	56,1	54,8	66,5
1996	73,4	54,6	52,7	64
1997	72,9	54,6	52	63,5
1998	68,2	51,7	48,7	59,3
1999	71,7	54,2	51,2	62,3
2000	70,2	52,9	50,2	61,1
2001	70,8	53,5	50,6	61,7
2002	69,1	52,5	49,1	60,2
2003	70,4	53,7	49,9	61,4
2004	67,8	51,9	48,1	59,3
2005	64,9	49,9	45,9	56,9
2006	63,3	48,7	44,4	55,5
2007	57,6	44,4	40,2	50,5
2008	62,0	49,3	44,6	55,0
2009	55,4	44,3	39,7	49,1
2010	54,1	42,9	38,3	47,9
2011	56,5	44,5	39,6	49,9

Pjesëmarrja e të gjitha llojeve të pensionit në raport me pagën mesatare të paguar në punëtor në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 është zmadhuar prej 47,9% në 49,9% .

Tabela 14: Struktura e përfituesve të pensionit (pa pensionet minimale të bujqve dhe ushtarake) sipas grupeve të vlerave të pensionit:

Grupe të vlerave	Familjare	Struktura	Invalidore	Struktura	Të pleqërisë	Struktura	Gjithsej	Struktura
në denarë	përfitues	%	përfitues	%	përfitues	%	përfitues	%
deri më 5.795,50	8.984	11,8	4.938	11,0	9.919	6,4	23.841	8,6
5.795,51 - 8.274,50	41.939	54,8	17.644	39,3	30.234	19,4	89.817	32,4
8.274,51 - 10.000,00	9.826	12,8	8.664	19,3	24.143	15,5	42.633	15,4
10.000,01 - 15.000,00	11.490	15,0	9.832	21,9	56.486	36,2	77.808	28,0
15.000,01 - 20.000,00	2.970	3,9	2.739	6,1	22.391	14,3	28.100	10,1
mbi 20.000,01	1.321	1,7	1.078	2,4	12.843	8,2	15.242	5,5
Gjithsej	76.530	100,0	44.895	100,0	156.016	98,40	277.441	100,0

Prej 277.441 përfituesve të pensionit, 23.841 përfitues apo 8,6% pranojnë pension deri më 5.795,50 denarë, që paraqet vlerë më të ulët të pensionit prej grupit të tretë të pensionit me vlerë më të ulët, 89.817 përfitues të pensionit pranojnë pension prej 5.795,01 deri më 8.274,50 denarë që paraqet vlerë më të lartë prej grupit të parë të pensioneve më të ulëta, gjegjësisht 113.658 përfitues të pensionit apo 41,0% pranojnë pension në lartësi prej 8.274,50 denarë që paraqet vlerë më të lartë prej grupit të parë të pensionit me vlerë më të ulët të pensioneve.

Përfituesit tjerë të pensionit pranojnë pension edhe atë:

- 42.633 përfitues apo 15,4% pranojnë pension prej 8.274,51 deri më 10.000,00 denarë,
- 77.808 përfitues apo 28,0% pranojnë pension prej 10.000,01 deri më 15.000,00 denarë
- 28.100 përfitues apo 10,1% pranojnë pension prej 15.000,01 deri më 20.000,00 denarë,
- 15.242 përfitues apo 5,5% pranojnë pension mbi 20.000,01 denarë.

Tabela 15: Numri i përfituesve të pensionit të cilët pranojnë pension nën vlerën e garantuar të pensionit më të ulët prej 5.795,50 denarë, për shkak të pranimit të pjesës proporcionale nga shtetet tjera sipas grupit të vlerave

Grupet e vlerave denarë	Përfitues	Struktura	Përfitues kumulativ	Struktura kumulative
Deri më 500,00	1.225	5,1	1.225	5,1
500,01-1.000,00	3.307	13,9	4.532	19,0
1.000,01-1.500,00	1.408	5,9	5.940	24,9
1.500,01-2.000,00	1.245	5,2	7.185	30,1
2.000,01-2.500,00	1.213	5,1	8.398	35,2
2.500,01-3.000,00	1.081	4,5	9.479	39,8
3.000,01-3.500,00	1.080	4,5	10.559	44,3
3.500,01-4.000,00	1.107	4,6	11.666	48,9
4.000,01-4.500,00	1.157	4,9	12.823	53,8
4.500,01-5.000,00	1.152	4,8	13.975	58,6
5.000,01-5.795,50	9.866	41,4	23.841	100,0
Gjithsej	23.841	100,0		

Sipas të dhënave të paraqitura 23.841 përfitues me vlerë më të ulët të pensionit marrin vlerë më të ulët nga vlera e garantuar e pensionit më të ulët, për shkak të pranimit të pjesës proporcionale të pensionit nga shtetet tjera.

Tabela 16: Struktura e përfituesve të pensionit nga grupi i tretë

Viti	Vlera më e ulët e pensionit	Shfrytëzues të vlerës më të ulët të pensionit nga grupi i tretë
2000	3.362,00	16.761
2001	3.422,00	19.436
2002	3.647,00	20.565
2003	3.856,00	20.809
2004	3.903,00	21.173
2005	3.918,00	21.577
2006	4.023,00	22.142
2007	4.091,50	22.102
2008	5.262,00	22.342
2009	5.556,00	22.575
2010	5.634,00	22.357
2011	5.795,50	23.841

Pjesëmarrja e përfituesve të vlerës më të ulët të pensionit në vitin 2000 (16.761) në raport të gjithsej numrit të pensionit (241.221) arrinte 6,9%, ndërsa në vitin 2011 arrin 8,6%, e cila tregon në faktin se është rritur pjesëmarrja e shfrytëzuesve të vlerës më të ulët të pensionit, e cila garantohet për përfitues të pensionit të cilët pensionin e realizojnë me stazh më të ulët të pensionit.

IV. PUNA FINANCIARE E FONDIT

Në punën financiare të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë në vitin 2011 kishte ndikim zbatimi i shkallës së kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor dhe lëvizja e indikatorëve makroekonomik si dhe masat e ndërmarra të Fondit rreth pagesës së kontributeve të prapambetura, të pa paguara, përfundimisht me vitin 2008 edhe atë:

- kontributi për sigurim pensional dhe invalidor nga 1 janari i vitit 2011 llogaritej në shkallë prej 18%, në mbështetje me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social i cili ndikonte në realizimin e të hyrave të Fondit nga kontributet,

- indikatorët makroekonomik, gjithashtu kishin ndikim në punën e Fondit. Pikërisht, gjatë planifikimit të mjeteve në Buxhetin e Fondit për vitin 2011 parashikohej se do të rritet punësimi për 3%, ndërsa pagat do të rriten për 4% dhe Fondi sipas kësaj baze do të realizojë kontribute të zmadhuara. Megjithatë këto parametra nuk u realizuan, ndërsa rritja e pagave në vitin 2011 në raport të vitit 2010 arrin 1,2%.

- masat e ndërmarra të Fondit për pagesën e kontributeve të prapambetura deri në vitin 2008, organizimi i takimeve rajonale me obliguesit, përgatitja e procesverbaleve, bllokimi i llogarive, kishin ndikim në rritjen e kontributit të pa paguar nga sigurimi pensional dhe invalidor. Sipas kësaj baze, Fondi në vitin 2011 pagoi rreth 334,00 milion denarë.

Mjetet që u realizuan nga kontributet si dhe me mjetet e dedikuara nga Buxheti i Vendit, Fondi në vitin 2011 realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 43.937,09 milion denarë. Me këto mjete dhe me mjetet e transferuara nga viti 2010 (766,91 milion denarë), Fondi zbatoi gjithsej të dala në shumë prej 44.305,77 milion denarë.

Për shkak të të hyrave më të ulëta të realizuara, Fondi gjatë pagesës së pensionit në afatet e caktuara shfrytëzonte hua nga Buxheti i Vendit, ndërsa të njëjtën e kthente pas pagesës së pensioneve dhe akumulimit të mjeteve nga kontributit. Gjithsej të hyrat e Fondit janë realizuar me 96,1% në raport të mjeteve të planifikuara me Buxhetin e Fondit për vitin 2011, ndërsa në krahasim me vitin 2010 të njëjtat janë më të larta për 5,9% për shkak mjeteve të rritura të transferimit për mbulimin e deficitit rrjedhës, ndërsa gjithsej të dalat janë kryer me 96,9% në raport të mjeteve të planifikuara me Vendim mbi shpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetor të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2011, ndërsa në krahasim me vitin 2010 të njëjtat janë më të larta për 4,2%.

1. Të hyrat e Fondit

Gjithsej të hyrat e Fondit në shumë prej 43.937,09 milion denarë janë realizuar nga burimet e më poshtme të financimit, edhe atë:

- nga të hyra burimore (kontribut nga paga, stazh i benificuar, kontribut nga personat që kryejnë veprimtari dhe të punësuar tek ata si dhe nga bujqit individual dhe Agjencia e punësimit) janë realizuar mjete në shumë prej 27.012,55 milion denarë apo 61,5% nga gjithsej të hyrat,

- mjete nga Buxheti i Vendit janë realizuar në shumë prej 15.704,97 milion denarë apo 35,7% nga gjithsej të hyrat,

- nga akcizat janë realizuar mjete në shumë prej 813,77 milion denarë apo 1,9% nga gjithsej të hyrat,

- nga dividenda janë realizuar mjete në shumë prej 7,22 milion denarë

dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve janë realizuar mjete në shumë prej 276,35 milion denarë apo gjithsej 283,57 milion denarë të cilat në raport të gjithsej të hyrave arrijnë 0,6%,

- nga të hyra të tjera janë realizuar mjete në shumë prej 122,23 milion denarë apo 0,3% nga gjithsej të hyrat.

Kontributi nga paga llogaritet në shkallë prej 18% të bruto pagës dhe është burim kryesor për financimin e Fondit. Në vitin 2011 sipas kësaj baze janë realizuar mjete në shumë prej 25.874,03 milion denarë dhe të njëjtat janë realizuar nën të planifikuarat me Buxhetin e Fondit (93,7%), ndërsa në krahasim me të hyrat e realizuara nga viti 2010 janë më të larta për 2,9%. Pjesëmarrja e kontributit nga paga në gjithsej të hyrat arrin 58,9%.

Kontributi nga paga sipas muajve në vitin 2011 dhe 2010 lëviz sipas dinamikës së mëposhtme:

Tabela 17: Kontribut nga paga sipas muajve

Muajt	Kontribute të paguara		Indeksi	Dallimi
	2011	2010		
Janar	1.712,99	1.763,34	97,1	-50,35
Shkurt	2.102,52	2.030,38	103,5	72,14
Mars	2.155,09	2.147,99	100,3	7,10
Prill	2.266,58	2.157,81	105,0	108,77
Maj	2.043,56	1.902,45	107,4	141,11
Qershor	2.172,00	2.083,45	104,2	88,55
Korrik	2.245,71	2.303,42	97,5	-57,71
Gusht	2.098,76	1.944,49	107,9	154,27
Shtator	2.188,97	2.113,61	103,6	75,36
Tetor	2.055,36	2.055,80	100,0	-0,44
Nëntor	2.209,74	2.122,86	104,1	86,88
Dhjetor	2.622,75	2.531,38	103,6	91,37
Gjithsej	25.874,03	25.156,98	102,9	717,05

Nga tabela shihet se kontributi nga paga në vitin 2011 në raport të vitit 2010 është më i lartë për 2,9%, ndërsa sipas muajve ka një realizim më të madh në muajin prill, maj dhe gusht të vitit 2011.

Të hyrat nga kontributi i përfitimit (346,19 milion denarë), të hyrat nga personat fizik që kryejnë veprimtari dhe të punësuarit tek ato (611,23 milion denarë) si dhe nga bujqit individual (58,91 milion denarë) janë realizuar në shumë prej 1.016,33 milion denarë dhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej të hyrat arrin 2,3%.

Të hyrat nga Agjencia e punësimit dedikohen në bazë të kontributit për personat e pa punë të cilët pranojnë kompensim në të holla. Në vitin 2011 në këtë bazë janë dedikuar mjete në shumë prej 122,19 milion denarë dhe të njëjtat në krahasim me vitin 2010 (163,90 milion denarë) janë më të ulëta për 41,71 milion denarë apo për 25,4%, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithsej të hyrat e Fondit arrin vetëm 0,3%. Këto mjete nga viti në vit reduktohen për shkak zvogëlimit të numrit të personave për të cilët paguhet kontribut për shkak ndryshimit të dispozitave ligjore të paguhet kontribut vetëm për personat të cilët nuk kanë 15 vjet përvojë pune. Gjithashtu, në mbështetje të Ligjit për kontribute nga sigurimi social i detyrueshëm, Agjencia e punësimit kontributin për sigurim pensional dhe invalidor e llogarit dhe paguan në shkallë prej 18,0% të neto bazës, në vend të bruto bazës, të njëjtin e llogarit në kompensim ndërsa jo në bazën nga e cila është llogaritur kontributi.

Të hyrat nga akcizat janë realizuar në shumë prej 813,77 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të hyrat marrin pjesë me 1,9%. Këto të hyra llogariten në shkallë prej 9,18% nga derivatet e naftës.

Mjetet transferuese nga Buxheti i Vendit janë realizuar në shumë prej 15.704,97 milion denarë dhe të njëjtat janë në kuadër të mjeteve të planifikuara me Buxhetin e Fondit (100,0%), ndërsa në krahasim me të hyrat e realizuara në vitin

2010 (14.218,12 milion denarë) janë më të larta për 10,5%. Mjetet e dedikuara dedikohen edhe atë:

- 3.929,80 milion denarë për obligime ligjore (për shfrytëzues të pensioneve minimale bujqësore, pensione ushtarake, luftëtarë para dhe pas 09.09.1943, shfrytëzues në barrë të Vendit, mësues, shfrytëzues në SHNP (shtëpia ndëshkimore përmirësuese) si dhe për pagesën e dallimeve në bazë të harmonizimit prej 8% për periudhë të kaluar në mbështetje me aktgjykimin e Gjykatës supreme të RM-së.

- 3.420,00 milion denarë për shpenzimet transitive, dhe

- 8.355,17 milion denarë për mbulimin e deficitit rrjedhës.

Pjesëmarrja e të hyrave nga Buxheti i Vendit në gjithsej të hyrat e Fondit arrin 35,7%. Mjetet nga Buxheti i Vendit janë të radhës së dytë të hyra sipas madhësisë dhe përfaqësojnë shkallë të rëndësishme në financimin e sigurimit pensional dhe invalidor. Të hyrat nga Buxheti i Vendit rregullisht janë dedikuar, me llogaritjet e dorëzuara paraprake mujore nga Fondi.


Të hyrat nga dividenda dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve në vitin 2011 janë realizuar në shumë prej 283,57 milion denarë edhe atë:

- nga dividenda janë realizuar mjete në shumë prej 7,22 milion denarë.

- nga shitja e aksioneve dhe pjesëve janë realizuar mjete në shumë prej 276,35 milion denarë, që është më pak për 7,9% nga mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit apo 92,1% nga të planifikuarat me Buxhetin.

- të hyra të tjera janë realizuar mjete në shumë prej 122,23 milion denarë.

Struktura e gjithsej të hyrave në vitin 2011 paraqitet në poshtë:



Sipas strukturës së dhënë më e madhe është pjesëmarrja nga kontributi i pagës 58,9%, nga Buxheti i Vendit me pjesëmarrje prej 35,7%, apo sipas të dy bazave pjesëmarrja e të hyrave arrin 94,6%, përderisa nga të gjitha të hyrat tjera mjetet e realizuara marrin pjesë me 5,4% në gjithsej të hyrat.

Tabela 18: Të hyrat e realizuara dhe të planifikuara të Fondit në vitin 2011, të krahasuara me vitin 2010 janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Nr. Ren .	Lloji i të hyrave	Buxheti për vitin 2011	Të realizuara janar-dhjetor 2010	Të realizuara Janar -dhjetor 2011	Indeksi 4:2	Indeksi 4:3
0	1	2	3	4	5	6
1	Kontribut nga paga	27.614,08	25.156,98	25.874,03	93,7	102,9
2	Kontribut nga të hyrat	390,00	350,14	346,19	88,8	98,9
3	Sektori privat	590,00	587,01	611,23	103,6	104,1
4	Bujq individual	42,00	43,36	58,91	140,3	135,9
5	Të hyra nga Agjencia e punësimit	179,24	163,90	122,19	68,2	74,6
	Gjithsej kontribute	28.815,32	26.301,39	27.012,55	93,7	102,7
6	Të hyra nga akcizat	772,00	787,57	813,77	105,4	103,3
7	Transfere nga Buxheti i Vendit	15.707,38	14.218,12	15.704,97	100,0	110,5
	1. Obligime të rregullta me ligj	3.838,38	4.295,67	3.829,40	99,8	89,1
	2. Mbulim i deficitit	8.346,00	6.718,66	8.355,17	100,1	124,4
	3. Shpenzime tranzitive	3.420,00	3.099,99	3.420,00	100,0	110,3
	4.Transfer nga Ministria e mbrojtjes	100,00	98,78	97,60	97,6	98,8
	5. Shpenzimet e udhëtimit për rekreacion në banjën klimaterike të pensionistëve	3,00	5,02	2,80	93,3	55,8
8	Të hyra tjera	100,00	112,17	122,23	122,2	109,0
9	Dividenda	15,00	10,00	7,22	48,1	72,2
10	Të hyra nga shitja e letrave me vlerë	300,00	40,78	276,35	92,1	677,7
	Gjithsej të hyra	45.709,70	41.470,03	43.937,09	96,1	105,9

2. Të dalat e Fondit

Gjithsej të dalat e Fondit në vitin 2011 arrijnë 44.305,77 milion denarë dhe të njëjtat janë më të larta për 4,2% në raport të të dalave të zbatuara në vitin 2010, ndërsa në raport me të dalat e planifikuara zbatimi arrin 96,9%.

Të dalat e Fondit kanë të bëjnë edhe atë:

- të dalat për pagesën e pensioneve arrijnë 35.751,31 milion denarë (35.223,13 milion denarë për pensione të rregullta, 444,85 milion denarë për pensione ushtarake dhe 83,33 milion denarë për pensione të bujqëve) apo 80,7% nga gjithsej të dalat.

- kontributi për sigurim shëndetësor për përfituesit e pensionit arrin 4.524,32 milion denarë dhe i njëjti në gjithsej të dalat merr pjesë me 10,2%. Të dalat për pensione të paguara së bashku me kontributin për sigurim shëndetësor arrijnë 40.275,63 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të dalat marrin pjesë me 90,9%.

- të dalat për pagesën e kompensimeve nga sigurimi invalidor, vendosjen e fëmijëve invalid në konvikt dhe dëmtim fizik arrijnë 101,65 milion denarë apo 0,2% nga gjithsej të dalat. Kompensimet nga sigurimi invalidor arrijnë 8,12 milion denarë dhe të njëjtat në krahasim me të dalat e vitit 2010 janë reduktuar për 32,3% si rezultat i ndryshimeve të dispozitave ligjore sipas të cilave këto kompensime janë transformuar në pension invalidor, ndërsa të drejta të reja nuk realizohen. Kompensimi për dëmtim trupor arrin 91,91 milion denarë, ndërsa për vendosje në konvikt 1,62 milion denarë.

- transferimi i mjeteve për fondet pensionale private në vitin 2011 arrin 3.482,61 milion denarë dhe të njëjtat në krahasim me vitin 2010 janë më të larta për 9,8% si rezultat i rritjes së anëtarëve të cilët u kyçën në fondet pensionale private, ndërsa në raport me mjetet e planifikuara janë zbatuar me 99,5%. Numri i të siguruarve, anëtarë në fondet pensionale private në fund të vitit 2010 arrinte 266.970 (me gjendje më 31.12.2010) dhe i njëjti më 31.12.2011 arrin 296.631 anëtarë apo

më shumë për 29.661 anëtarë, për shkak të anëtarësimit të detyrueshëm të të gjithë të punësuarve të rinj në fondet pensionale private. Këto mjete kompensohen nga Buxheti i Vendit.

- pagat e të punësuarve në shërbimit profesional të Fondit në vitin 2011 arrijnë 273,81 milion denarë apo 0,6% në raport të gjithsej të dalave. Të dalat e zbatuara për të punësuarit në shërbimin profesional janë më të ulëta në krahasim me të planifikuarat për 5,1% për shkak pensionimit të të punësuarve, ndërsa plotësimi i tyre nuk është kryer në mbështetje me konkluzionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që edhe në vitin 2011 mos të punësohen punëtorë të rinj. Numri i të punësuarve me gjendje në dhjetor të vitit 2011 arrin 709 të punësuar.

- të dalat e tjera në vitin 2011 janë zbatuar në shumë prej 156,19 milion denarë apo 0,4% në raport të gjithsej të dalave. Këto shpenzime në raport të të planifikuarave janë zbatuar me 86,7%, ndërsa në krahasim me të zbatuarat nga viti 2010 të njëjtat janë më të ulëta për 16,8%.

- shpenzimet kapitale janë zbatuar në shumë prej 11,62 milion denarë të cilat në krahasim me mjetet e planifikuara për këtë qëllim në shumë prej 15,00 milion denarë përfaqësojnë zbatim vetëm prej 77,5%.

- shpenzimet për rikonstruimin e objekteve afariste janë zbatuar në shumë prej 4,26 milion denarë, që përfaqëson zbatim prej 85,2% nga mjetet e planifikuara, ndërsa në krahasim me vitin 2010 janë më të larta për 17,7%.

Struktura e të dalave paraqitet në vijim:




Tabela 19: Të dalat e realizuara të Fondit në vitin 2011, krahasuar me të realizuarat në vitin 2010 janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Nr. ren	Lloji i të dalave	Buxheti Janar-dhetor viti2011	Realizuar Janardhjetor viti 2010	Realizuar Janar-dhjetor viti2011	Indeksi 4:2	Indeksi 4:3
1	Pensione	35.515,00	33.865,55	35.223,13	99,2	104,0
1a	Me vendim nga Kuvendi i RM-së pensione të rritura	900,00				
2	Pensione minimale bujqësor	95,00	120,13	83,33	87,7	80,6
3	Pensione ushtarake	474,00	468,36	444,85	93,9	95,0
	Gjithsej pensione	36.984,00	34.437,32	35.751,31	96,7	103,8
4	Pagesa deri te fondet pensionale private	3.501,00	3.172,93	3.482,61	99,5	109,8
5	Kompensim për dëmtim trupor	92,00	92,23	91,91	99,9	99,7
6	Kompensim nga sigurimi invalidor	12,00	8,49	8,12	67,7	95,6
7	Vendosja në konvikt	5,00	2,80	1,62	32,4	57,9
8	Gjithsej kontributi për sigurim shëndetësor	4.627,00	4.338,25	4.524,32	97,8	104,3
9	Paga dhe kompensime	288,50	251,55	273,81	94,9	108,8
10	Të dala tjera	180,20	187,68	156,19	86,7	83,2
11	Shpenzime kapitale	15,00	12,59	11,62	77,5	92,3
12	Rikonstium I objekteve afariste	5,00	3,62	4,26	85,2	117,7
	Gjithsej të dala	45.709,70	42.507,46	44.305,77	96,9	104,2

Realizimi i të hyrave dhe zbatimi i të dalave të Fondit në periudhën prej vitit 1994 deri në vitin 2011 janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Tabela 20: Lëvizja e të hyrave sipas viteve

Viti	Të hyra burimore	Agjencia e punësimit	Buxheti	Akcizat	Të hyra tjera	Dividenda	Shitja e aksioneve	Gjithsej
1994	13.598,92	35,78	2.944,61	835,15	79,82			17.494,28
1995	14.012,00	274,81	2.830,00	857,50	36,56			18.010,87
1996	13.644,78	535,43	3.289,00	778,87	31,46	47,18		18.326,72
1997	13.735,57	816,26	3.516,00	731,02	32,02	48,38		18.879,25
1998	14.500,28	967,72	3.618,57	693,86	120,87	49,94	569,48	20.520,72
1999	15.979,18	863,91	3.266,07	633,24	43,05	68,68	177,52	21.031,65
2000	16.662,36	1.100,07	4.174,42	802,07	88,22	53,86	15,55	22.896,55
2001	16.419,97	1.126,48	5.744,48	716,09	75,58	39,44	167,54	24.289,58
2002	16.535,92	1.403,34	6.960,91	687,83	29,20	19,68	172,51	25.809,39
2003	17.651,84	1.536,13	7.740,95	677,04	80,13	20,98	20,63	27.727,70
2004	18.034,17	1.718,70	8.486,44	660,97	56,09	20,60	50,91	29.027,88
2005	18.339,08	1.549,89	8.255,08	659,14	62,74	18,13	27,65	28.911,71
2006	19.948,52	1.219,77	9.370,85	661,00	223,75	22,75	962,60	32.409,24
2007	21.914,23	864,98	10.378,52	681,04	151,89	5,88	56,71	34.053,25
2008	25.581,91	773,58	10.181,99	717,40	247,71	21,48	97,63	37.621,70
2009	26.279,53	256,49	14.020,85	744,49	194,11	19,41	74,64	41.589,52
2010	26.137,49	163,90	14.218,12	787,57	112,17	10,00	40,78	41.470,03
2011	26.890,36	122,19	15.704,97	813,77	122,23	7,22	276,35	43.937,09

Gjithsej të hyrat në vitin 2011 në raport të vitit 1994 janë rritur për 151,1%, ndërsa në kuadër të këtyre, të hyrat burimore për 97,7%, mjetet nga Buxheti i Vendit për 433,3% . Mjetet nga akcizat janë reduktuar prej 835,15 në vitin 1994 në 813,15 milion denarë në vitin 2011. Të hyrat nga Agjencia e punësimit në mënyrë drastike janë reduktuar nga viti 2009 për shkak ndryshieve të dispozitave ligjore, në raport të fitimit të së drejtës si dhe në raport të bazave dhe përqindjes së llogaritjeve për realizim. Pikërisht, deri në vitin 2008 si bazë ishte bruto shuma e kompensimit në të holla dhe bazë më e ulët për llogaritjen dhe pagesën e kontributit prej 65%, ndërsa nga viti 2009 me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social kontributin e paguan në neto bazën e kompensimit ndërsa jo në bazën nga e cila është llogaritur kompensimi.

Në grafikonin e më poshtëm është paraqitur lëvizja e të hyrave sipas viteve:




Tabela 21: Lëvizja e të dalave sipas viteve


Viti	Pensione	Kontribute nga sigurimi invalidor	Kontribut shëndetësor	Shërbimi profesional	Të dala tjera kapitale	Shpenzime tranzitive	Gjithsej
1994	15.404,40	391,66	2.102,03	118,77	427,72		18.444,58
1995	15.684,34	204,11	2.082,07	127,20	198,97		18.295,69
1996	16.223,17	185,26	2.217,54	128,43	170,61		18.925,01
1997	16.694,20	179,22	2.292,43	128,33	209,89		19.504,07
1998	17.730,56	177,48	2.320,67	130,17	174,52		20.533,40
1999	17.757,99	177,80	2.450,13	132,14	163,53		20.681,29
2000	19.745,20	173,44	2.674,37	142,03	206,53		22.941,57
2001	21.282,34	170,19	2.800,73	153,37	290,23		24.696,86
2002	22.252,52	179,85	2.927,64	164,82	352,59		25.880,42
2003	24.028,33	182,89	3.183,98	171,41	197,74		27.764,35
2004	25.108,05	189,07	3.349,18	168,89	301,62		29.116,81
2005	24.970,08	199,61	3.416,82	171,73	272,67		29.028,91
2006	25.410,57	224,98	3.582,45	177,17	486,40	1.325,14	31.206,70
2007	26.305,27	247,79	3.714,03	240,33	385,13	1.877,00	32.769,55
2008	30.953,74	115,58	4.367,89	256,16	549,24	2.490,53	38.733,14
2009	33.537,64	107,53	4.290,57	264,64	260,39	2.932,20	41.392,97
2010	34.437,32	103,52	4.338,25	251,55	203,89	3.172,93	42.507,46
2011	35.751,31	101,65	4.524,32	273,81	172,07	3.482,61	44.305,77

Në periudhën prej vitit 1994 deri në vitin 2011, gjithashtu janë rritur edhe të dalat si rezultat i rritjes së numrit të përfituesve të pensionit dhe harmonizimit të pensioneve.

Të dalat për pagesën e pensioneve në vitin 2011 arrijnë 35.751,31 milion denarë dhe në krahasim me vitin 1994 janë rritur për 132,1%, kompensimet nga sigurimi invalidor janë reduktuar në 25,9% për shkak të transferimit të shpenzimeve për kujdes nga personi i tretë dhe ndihmë në institucion tjetër dhe transferimin e kompensimeve në të drejtën e pensionit invalidor në vitin 2008, në mbështetje me

ndryshimet e dispozitave ligjore, pagat e të punësuarve janë rritur për 130,5%, të dalat tjera në vitin 2011 arrijnë 172,07 milion denarë dhe të njëjtat në raport të disa viteve paraprake janë reduktuar për shumën e shpenzimeve postare për përfituesit e pensionit të cilët pensionin e kanë pranuar nëpërmjet postës, për shkak të pagesës së pensioneve nëpërmjet llogarive të transaksionit nga viti 2009. Gjithsej të dalat në krahasim me vitin 1994 janë rritur për 140,2%. Nga viti 2006 në mbështetje të ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, në Fond filluan të realizohen të dala në bazë të transferimit të mjeteve në fondet pensionale private për kontributin e sigurimit pensional dhe invalidor për anëtarët të cilët janë kyçur në fondet pensionale private. Këto të dala janë rritur nga 1.325,14 milion denarë në vitin 2006, në 3.482,61 milion denarë në vitin 2011 apo për 162,8%, për shkak numrit të rritur të anëtarëve.

Në grafikonin e mëposhtëm është paraqitur lëvizja e të dalave sipas viteve:



3. Rezultate financiare

Në vitin 2011, Fondi realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 43.937,09 milion denarë dhe të njëjtat në raport me të kryerat e realizuara janë me 96,1% ndërsa gjithsej të dalat arrijnë 44.305,77 milion denarë dhe të njëjtat në raport me të planifikuarat me Buxhetin e Fondit për vitin 2011 janë kryer me 96,9%.

Në vitin 2011 Fondi realizoi tepriçë të të dalave mbi të hyrat në shumë prej 368,68 milion denarë që përfaqëson 0,8% në raport me gjithsej të hyrat.

Me të hyrat e realizuara nga kontributi dhe mjetet nga Buxheti i Vendit, si dhe nga të hyrat tjera Fondi në vitin 2011 nuk siguronte mjete të mjaftueshme për ta kryer pagesën e pensioneve në javën e parë të muajit për muajin paraprak, me çka rregullisht shfrytëzonte hua nga Buxheti i Vendit. Huanë Fondi rregullisht e kthente pas pagesës së pensioneve dhe akumulimit të mjeteve nga të hyrat e realizuara.

Mungesa e mjeteve nga viti 2011 prej 368,68 milion denarë është transferuar në vitin 2012.

Duke pasur parasysh se edhe në vitin 2012 do të zbatohet shkallë e kontributit prej 18%, ndërsa mjetet nga Buxheti i Vendit janë më të larta vetëm për 5,0% në raport të vitit 2011, në kushte të të dalave të zmadhuara për pagesën e pensioneve dhe numrit të rritur të përfituesve të pensionit, Fondi do të ballafaqohet me probleme për sigurimin e mjeteve për pagesën e rregullt të pensioneve.

Fondi rregullisht do ta përcjell gjendjen financiare dhe në qoftë se realizimi i të hyrave nuk e siguron zbatimin e të dalave në vitin 2012 dhe haset në vështirësi në pagesën e pensioneve do ti informojë institucionet kompetente për ndërmarrjen e masave në drejtim të përmirësimit të gjendjes financiare.

4. Aksione dhe pjesë

Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë në mbështetje me nenin 19 nga Ligji për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror dhe neni 7 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror zotëron aksione dhe pjesë në nërmarrjet të cilat privatizohen sipas ligjit në fjalë.

Shitja e aksioneve dhe pjesëve të Fondit është rregulluar me Ligjin për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror, Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, Rregulloren e procedurës për shitjen e aksioneve dhe pjesëve nga gjithsej kapitali i arritur në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.108/2010) dhe Kriteret për shitjen e aksioneve dhe pjesëve, të arritur në bazë të Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror.

Me ndryshimet e nenit 172 –a nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.83/2010), duke filluar nga 1 janari i vitit 2011, Fondi mund të realizon mjete nga shitja e aksioneve dhe pjesëve deri më 100% nga gjithsej kapitali (deri më 31.12.2010 egzistonte kufizim për shitje deri më 70% nga gjithsej kapitali).

Në mbështetje të Buxhetit të Fondit për vitin 2011 në të cilin ishte paraparë realizim të mjeteve nga shitja e aksioneve dhe pjesëve në gjithsej shumën prej 300,00 milion denarë si dhe dispozitat ligjore të theksuara, në propozim të Komisionit për aksione dhe pjesë, Këshilli drejtues i Fondit në vitin 2011 solli dhjetë vendime për shitjen e aksioneve dhe pjesëve në pako dhe një Vendim për shitjen e aksioneve dhe pjesëve të Fondit në pako me aksionet e Republikës së Maqedonisë. Këta vendime ishin të krahasuara gjatë vitit 2011 sipas dinamikës së përcaktuar, përveç dy vendimeve të fundit, të cilët u sollën në dhjetor të vitit 2011 dhe janë zbatuar gjatë vitit 2012. Përfundimisht më 31 dhjetor të vitit 2011, u zhvilluan tetë ankande publike për të cilët për shitje u ofruan aksione të thjeshta dhe prioritare nga gjithsej

195 shoqëritë aksionare dhe pjesë nga 131 shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Janë shitur aksione nga 30 shoqëri aksionarësh dhe pjesë prej 28 shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Nga transaksionet e realizuara të ankandëve publike të zbatuar në vitin 2011, janë realizuar mjete në gjithsej shumën neto prej 276,35 milion denarë.

5. Pagesa e kontributeve të prapambetura

Duke filluar nga viti 2009, me ndryshimin e regullativës ligjore dhe transferimin e kompetencave për pagesën e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor dhe kontrollit të kontributeve të pa paguara në Drejtorinë e të Hyrave Publike, në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor mbeti kompetenca për pagesën e borxheve përfundimisht me vitin 2008 si dhe mundësia për kontrollin plotësues të vërtetimit të të dhënave për kontributet, sipas nevojave të vërtetuara personale.

Shërbimi profesional i Fondit në bazë të gjendjeve të shqyrtuara me kontributet e pa paguara të obliguesve udhëheq procedurë për pagesën e kontributeve të pa paguara vetëm të obliguesve aktiv në mbështetje me regullativën ligjore, përderisa për obliguesit pasiv (të likuiduar) nuk udhëheq procedurë, sepse nga të njëjtit nuk mund ta paguajë kontributin. Për obliguesit të cilët kanë të hapur procedura falimentuese për kontributin e pa paguar përfundimisht me 31.12.2008, Fondi dorëzon paraqitjen e kërkesës në procedurë falimentuese.

Shërbimi profesional i Fondit në vitin 2011 ndërmorri aktivitete të shumta për pagesën e kontributeve të pa paguara nga obliguesit të cilët janë aktiv dhe kanë borxhe nga viti 2008, si dhe për obliguesit tjerë zbatonte aktivitete për azhurnimin e bazave të të dhënave për obliguesit dhe të siguruarit (pastrimin e bazave të të dhënave).

Gjatë vitit 2011, Fondi udhëhiqte procedurë tek obliguesit tjerë të cilët nuk deklaruan llogaritje për kontribut, ndërsa janë aktiv në evidencën e Fondit, apo përsëri kanë paguar më pak kontribut, ndërsa nga 2.015 obligues në vitin 2011 është paguar kontribut dhe interes për pagesën e vonuar të kontributit mjete në shumë prej rreth 334,00 milion denarë.

Nga analizat e zbatuara është konstatuar se borxhi i obliguesve lëviz prej 500 deri mbi një milion denarë. Numri më i madh i obliguesve janë me borxh prej 100.000 denarë, ndërsa numër më i vogël me borxh të pa paguar prej mbi 1.000.000 denarë.

Në vitin 2011 Fondi nëpërmjet filialeve të tij dhe ekspoziturave të cilat janë kompetente për udhëheqjen e procedurës për pagesë të detyrueshme zbatoi kontroll të mbi 6.000 obliguesve. Nga ana e Fondit të gjithë obliguesit janë njoftuar për kontributet e pa paguara dhe obligimin për pagesën me dorëzimin e lajmërimeve, procesverbaleve dhe vendime për pagimin e borxhit. Obliguesit të cilët nuk e kanë paguar kontributin nga ana e Fondit është zbatuar bllokim i llogarive.

Shërbimi profesional i Fondit gjatë vitit 2011 ka mbajtur edhe më shumë takime me përfaqësuesit nga obliguesit ku ishin shqyrtuar gjendjet dhe kushtet për pagesën e kontributeve të pa paguara. Nga këto takime është paraqitur interes për pagesën e borxheve me çka një pjesë e tyre për shkak gjendjes ekonomike në të cilën gjenden dhe për shkak pagesës së rregullt të bruto pagës në vitin 2009, 2010 dhe 2011 dhe përcaktimit më tutje rregullisht ti paguajnë obligimet ndaj fondeve dhe Drejtoria e të Hyrave Publike, drejtohet deri te Fondi që ti mundësohet pagesë e borxhit në disa këste.

Fondi edhe në vitin 2012 do të vazhdojë intenzivisht të punojë në pagesën e borxheve të debitorëve në bazë të kontributeve të pa paguara deri në vitin 2008 nëpërmjet filialeve dhe ekspoziturave të Fondit dhe do të vazhdojë me azhurnimin e të dhënave në bazën e të obliguarve për llogaritjen dhe pagesën e kontributit. Fondi

përmes këtij kontrolli do të sigurojë baza të sakta të të dhënave për debitorë nga të cilët mund të pritët të paguhet kontributi i pa paguar.

5. Informimi

Informimi si një nga segmentet më të rëndësishëm për afirmimin e transparencës së Fondit në vitin 2011, zhvillohej nëpërmjet formave veç më të vendosura për komunikim të jashtëm dhe të brendshëm (ndaj publikut dhe të punësuarit në Fond).

Në vitin 2011 është mundësuar informim profesional, kualitativ dhe në kohë për të siguruarit, të obliguarit, përfituesit e pensionit, si dhe të punësuarit në Qendër, filialet dhe ekspoziturat e Fondit, për të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet nga puna e Fondit dhe sigurimit pensional dhe invalidor të Republikës së Maqedonisë.

Informimi është zhvilluar nëpërmjet gazetës për të punësuarit “Informator“, nëpërmjet Ueb faqes së Fondit, gazetës së Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë “Pensioner plus” si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me mjetet për informim publik (mediat e shtypura dhe elektronike).

Për shkak të sigurimit publik në punën e Fondit, në Ueb faqen tonë dhe në “Informator“ rregullisht, në mënyrë kualitative dhe në kohë të duhur janë publikuar përmbajtjet që janë shqyrtuar dhe sjellë – miratuar në seancat e Këshillit drejtues si dhe nga mbledhjet me Shërbimin profesional – Qendra e Fondit, konferencat për shtyp dhe realizimin e projekteve pensionale me publikimin e raporteve, teksteve dhe komenteve për afirmimin e punës së Shërbimit profesional të Fondit..

Në vitin 2011, Grupi për komunikim aktivisht dhe drejtpërdrejtë mori pjesë në organizimin dhe realizimin e mbledhjeve të shumta në përbërje të zgjeruar, prezantime, ligjërata profesionale, konferencë për shtyp, tryezë të rrumbullakët etj., për çka publiku dhe të punësuarit në Fond ishin informuar detajisht dhe me kohë.

Në periudhën raportuese janë dhënë 6 numra të gazetës interne për të punësuarit “Informator“-it, në faqet e të cilit janë publikuar gjithsej 73 tekste dhe 12 tekste profesionale dhe aktuale në 11 numrat e gazetës “Pensioner plus“ si dhe shtojca të cilat e afirmojnë politikën pensionale dhe punën e Fondit.

Në gazetën “Pensioner plus“ nëpërmjet teksteve të publikuara dhe komenteve, opinioni më i gjerë në mënyrë të kontinuar është njoftuar me qëllimet dhe detyrat, gjegjësisht punën e Fondit (Raporte vjetore dhe tremujorëshe, Programi për punën e Këshillit drejtues të Fondit si dhe tema interesante për përfituesit e pensionit në lidhje me shtëpitë e pensionistëve dhe klubet, objektet për pushim dhe rekreacion të pensionistëve, rekreacioni në banjën klimatike, harmonizimi i pensioneve, fondi solidar etj).

Me rastin e 65 vjetorit të organizimit të pensionistëve në shtetit tonë, Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë në vitin 2011 i shpërndau mirënjohje Fondit për bashkëpunimin e tij intensiv dhe të frytshëm me këtë organizatë të pensionistëve si dhe udhëheqëses së Grupit për komunikim për përfaqësim të rregullt dhe kualitativ me shtojcat e saja në faqet e gazetës “Pensioner plus“.

Grupi për komunikim në vitin 2011 përgatiti dhe shpalli më shumë lajmërimë në gazetatat ditore edhe atë për shitjen e aksioneve dhe pjesëve të Fondit, pagesën në kohë dhe ligjore të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor si dhe fletëparaqitjet për licitacion publik dhe shpallje tjera.

Ueb-faqja e Fondit (www.piom.com.mk) e cila plotësisht është ri dizajnuar në vitin 2011 është mënyrë më e rëndësishme dhe më bashkëkohore në komunikimin e Fondit me publikun, ndërsa vërtetim për këtë është që konceptioni dhe fizionomia e saj të shërbejë, gjegjësisht të jetë funksion direkt i shfrytëzuesve, obliguesve, pensionistëve dhe të punësuarve në Fond. Nëpërmjet saj kryhej shpallja e informacioneve të plota dhe kualitative, interpretim kualitativ për çështje të veçanta praktike, por edhe vendosje të komunikimit të përhershëm, të hapur dhe

reciprok ndërmjet Fondit dhe shfrytëzuesve të shërbimeve tona. Pikërisht, nëpërmjet Ueb-faqes së Fondit është arritur hapje edhe më e madhe drejt publikut dhe është siguruar qasje e thjeshtë por e shpejtë, e saktë dhe moderne deri tek të gjitha informacionet e rëndësishme nga puna e organeve dhe shërbimeve të Fondit, që janë dhe mbeten në interes të firmave.

Gjithashtu edhe në vitin 2011 vazhdoi të zbatohet dokumenti “Ditari i qytetarit” i Fondit, si instrument efikas për përmirësimin e shërbimeve publike. “Ditari i qytetarit” i Fondit si dhe të gjitha përshkrimet e shërbimeve që Fondi u ofron përfituesve me persona të caktuar përgjegjës – të punësuar, veçmas për çdo shërbim, janë publikuar në Ueb faqen e Qeverisë së RM-së, www.uslugi.gov.mk. Në vitin e kaluar nëpërmjet kësaj Ueb faqe nga qytetarët e RM-së deri te Fondi (persona të caktuar nga Grupi për komunikim), janë parashtruar 70 pyetje nga fusha e realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, të cilave më së voni në afat prej 5 ditësh u janë përgjigjur në mënyrë profesionale . Gjithashtu, në mbështetje me instrumentin “Ditari i qytetarit”, në hyrjen e Qendrës, filialet dhe ekspoziturat e Fondit janë vendosur kutitë me formularë – pyetësorë për qytetarët – shfrytëzues të shërbimeve tona të cilët i plotësojnë dhe paraqesin mendimin e tyre për punën, sjelljen, shërbimin dhe profesionalizmin e të punësuarve në Fond. Formularët e plotësuar, nga Qendra, filialet dhe ekspoziturat në mënyrë elektronike rregullisht janë dërguar deri te Ministria e shoqërisë së informacionit dhe administrimit për shqyrtim në seancat e Qeverisë së RM-së.

Në kuadër të Departamenti për resurse njerëzore, në mënyrë aktive punonte Komisioni për mbrojtjen e së drejtës për qasje publike deri në informacionet e Fondit, si ndërmjetësues gjatë realizimit të së drejtës për qasje publike deri te informacionet e Fondit, si posedues i informacioneve, gjegjësisht akt. Për punën e Komisionit për vitin 2011 është përgatitur Raport i cili është pjesë përbërëse nga Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtjen e së drejtës për qasje publike të informacioneve pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Në këtë

raport janë përmbajtur informacione nga karakteri publik në nivel të Fondit, ndërsa kanë të bëjnë kryesisht me realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, vlerës së pensioneve, shfrytëzimit të rekreacionit të banjës klimaterike. Në vitin 2011 janë parashtruar gjithsej 22 kërkesa prej të cilave 19 kërkesave u është përgjigjur pozitivisht ndërsa vetëm 3 kërkesave u është përgjigjur negativisht sepse kishin të bëjnë me kërkesën e të dhënave personale nga persona fizik.

Në vitin 2011, në mënyrë aktive veprime në parashtrës dhe propozimet e arritura në Fond, gjegjësisht udhëhiqej komunikim me gojë për ankesat për të cilat menjëherë është përgjigjur, si dhe korrespondencë me dorëzuesit e parashtrësve. Në vitin 2011 janë përkthyer të gjitha materialet për 25 seancat e mbajtura të Këshillit drejtues të Fondit, 73 tekste për “Informatorin“ lajmërimi për publikun, tekste të publikuara për Ueb – faqen e Fondit, ndërsa është realizuar edhe përkthim simultan në çdo seancë të Këshillit drejtues.

Në Fond, për shkak të komunikimit më të mirë me qytetarët, punon edhe Call-qendra, (02/15-215), e cila është e hapur për publikun ç’do ditë pune dhe nëpërmjet së cilës jepen përgjigje në të gjitha pyetjet e parashtruara nga ana e personave fizik ose juridik.

V. REALIZIMI I TË DREJTAVE DHE ZBATIMI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

1. Zgjidhja e kërkesave në shkallë të parë

Gjatë vitit 2011 në filialet e Shërbimit profesional të Fondit, janë parashtruar 27.723 kërkesa për realizimin e të drejtës për sigurim pensional dhe invalidor, prej të cilave 18.805 kërkesa për realizimin e të drejtës së pensionit, 2.320

kërkesa për realizimin e të drejtës të sigurimit invalidor (dëmtim fizik, nuk ekziston invaliditet, paaftësi profesionale për punë, paaftësi e përgjithshme për punë) dhe 6.598 kërkesa të përsëritura.

Tabela 22: Gjithsej numri i kërkesave të parashtruara dhe të zgjidhura sipas llojit, me gjendje më 31 dhjetor të vitit 2011

Përshkrim	Kërkesa të pazgjidhura në fillim të vitit	Numri i kërkesave të parashtruara në vitin 2010	Gjithsej për zgjidhje	Kërkesa të zgjidhura		Kërkesa të zgjidhura deri më 30 ditë		Kërkesa jo të zgjidhura deri në fund të vitit	
				numri	%	numri	%	numri	%
Kërkesat e para për realizimin e pensionit	1.271	18.805	20.076	19.414	96,7	18.656	96,1	662	3,4
Kërkesa nga sigurimi invalidor	60	2.320	2.380	2.329	97,9	2.329	100,0	51	0,3
Kërkesa të ngelura	60	6.598	6.658	6.640	99,7	6.640	100,0	18	1,4
Gjithsej	1.391	27.723	29.114	28.383	97,5	27.625	97,3	731	2,6
Kërkesa të zgjidhura prej 35 deri më 60 ditë sipas gjitha bazave						758	3,9		
Gjithsej kërkesa të zgjidhura						28.383			

Gjatë vitit 2011 të zgjidhura janë 28.383 kërkesa sipas gjitha bazave për realizimin e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor, prej të cilëve 19.414 kërkesa të para për realizimin e të drejtës së pensionit.


Numri i kërkesave të para, të parashtruara për realizimin e të drejtës së pensionit në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 është rritur për 1.162 kërkesa apo për 6,6%.

Në vitin 2011 me fillimin e zbatimit të Projektit mbështetje teknike për dizejnimin e proceseve të reja për realizimin e të drejtës dhe pagesën e pensioneve u soll proces plotësisht i automatizuar i punës, ndërsa kjo solli deri në shkurtimin e afatit për zgjidhjen e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor. Skadimi i afatit për zgjidhjen e të drejtave është vërejtur te pensionet invalidore për shkak të mos ekipimit të komisionit të mjekëve të cilët punuan me numër të reduktuar të resurseve (gjithsej pesë mjek), ndërsa Fondi edhe pranë kësaj, rregullisht e kryente funksionin e tij në interes të përfituesve të së drejtës. Nga gjithsej kërkesat e para të zgjidhura për pension invalidor (3.258) në afat prej 30 ditë janë zgjidhur 3.053 kërkesa, ndërsa 205 kërkesa apo 6,3% nga gjithsej kërkesat e zgjidhura janë prej 35 ditë deri më 6 muaj.

Në vitin 2011, së bashku me kërkesat e bartura të vitit 2010, gjithsej për zgjidhje kishte 20.076 kërkesa të para prej të cilëve të zgjidhura janë 19.414 apo 96,7%. Procedura për zgjidhjen e kërkesave zgjat deri më 30 ditë; prej 30-40 ditë dhe prej 40-60 ditë. Në afat prej 30 ditë janë zgjidhur 18.656 kërkesa apo 96,1%, ndërsa prej 35 deri 60 ditë janë zgjidhur 758 kërkesa apo 3,9%. Kërkesat të cilët janë plotësisht të kompletuara zgjidhen menjëherë (deri më 30 ditë), përderisa për lëndët jo plotësisht të kompletuara, procedura zgjat më shumë, gjegjësisht deri në sigurimin e të dhënave nga parashtruesi i kërkesës për vërtetimin e stazhit të pensionit për personat të cilët kanë punuar në firmat private.

Në vitin 2011 nga gjithsej 19.414 kërkesa të para të zgjidhura, 10,633 kanë të bëjnë me pensionet e pleqërisë apo 54,8%, 3.258 apo 16,8% me pensionet invalidiore

dhe 5.523 kërkesa me pensionet familjare. Struktura e kërkesave të zgjidhura është paraqitur në grafikun e më poshtëm:



Në fund të vitit 2011 kishte 662 kërkesa të pa zgjidhura apo 3,4% nga gjithsej numri për zgjidhje. Mbetje më e madhe e kërkesave të pa zgjidhura ka në filialet edhe atë: Kimanovë (127), Ohër (103), Koçan (90), Shtip (84), Shkup (65), Prilep (44) dhe Kavadar (40), për shkak të mos kompletimit në lidhje me stazhin dhe pagat të cilat janë elemente të rëndësishme për realizimin e të drejtës së pensionit.

Numri i kërkesave të parashtruara për realizimin e të drejtës të sigurimit invalidor (dëmtim fizik, nuk ekziston invaliditet paaftësi profesionale për punë dhe paaftësi e përgjithshme për punë) në vitin 2011 arrin në 2.320 kërkesa dhe së bashku me 60 kërkesat e pazgjidhura prej vitit 2010, gjithsej për zgjidhje kishte 2.380 kërkesa. Nga ky numër të zgjidhura ishin 2.329 kërkesa apo 97,9%.

Gjatë vitit 2011 ishin të parashtruara 4.753 kërkesa për vërtetimin e stazhit për të gjitha llojet e sigurimit. Numri i kërkesave të parashtruara dhe të zgjidhura, në krahasim me vitin 2010 është i zmadhuar për 1.146 kërkesa apo për 31,8%. Në vitin 2011 janë zgjidhur të gjitha kërkesat 4.753, gjegjësisht është vërtetuar cilësia e

të siguruarit për të gjitha kërkesat e parashtruara dhe për të njëjtat janë sjellë vendime për pranimin e sigurimit. Zmadhimi i kërkesave të parashtruara në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 është rezultat i numrit më të madh të kërkesave të parashtruara.

Gjithsej kërkesat e para të zgjidhura sipas të gjitha bazave (për realizimin e pensionit, kërkesa nga sigurimi invalidor dhe kërkesa për vërtetimin e stazhit të pensionit) në vitin 2011 arrin 26.496 dhe në krahasim me vitin 2010 (24.515) janë zmadhuar për 1.981 kërkesa apo për 8,1%.

Kërkesat e zgjidhura sipas gjitha bazave, në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010, janë dhënë në grafikun e më poshtëm:





Tabela 24: Lëvizja e kërkesave të pranuar dhe të zgjidhura sipas gjitha bazave (pension moshe, invaliditeti dhe familjar, kompensime nga sigurimi invalidor, stazhi i pensionit dhe kërkesa tjera), në periudhën prej vitit 1991 deri më 2011

Viti	Kërkesa të pazgjidhura në fillim të vitit	Kërkesa të pranuar	Gjithsej për zgjidhje	Kërkesa të zgjidhura	Kërkesa të pazgjidhura në fund të vitit
1991	1.159	49.688	50.847	50.101	746
1992	746	54.819	55.565	53.360	2.205
1993	2.205	56.921	59.126	54.906	4.220
1994	4.220	37.480	41.700	40.594	1.106
1995	1.106	42.555	43.661	42.727	934
1996	934	39.357	40.291	39.160	1.131
1997	1.131	34.857	35.988	35.193	795
1998	795	39.407	40.202	39.659	543
1999	543	36.160	36.703	36.060	643
2000	643	41.723	42.366	41.642	724
2001	724	41.227	41.951	41.375	576
2002	576	39.784	40.360	39.372	988
2003	988	39.868	40.856	40.102	754
2004	754	41.202	41.956	40.823	1.133
2005	1.133	38.269	39.402	38.635	767
2006	767	36.053	36.820	36.217	603
2007	603	37.262	37.865	37.163	702
2008	702	34.546	35.248	34.837	411
2009	411	31.575	31.986	31.568	418
2010	418	32.160	32.578	31.187	1.391
2011	1.391	32.476	33.867	33.136	731



Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, mundet që të shihet se numri i kërkesave të parashtuara dhe të zgjidhura duke filluar prej vitit 2000 fillojnë të reduktohen si rezultat i acarrimit të kushteve për realizimin e të drejtës së pensionit në mbështetje me ndryshimet në rregullativën ligjore, gjegjësisht realizimin e të drejtës së pensionit. Në vitin 2011 vërehet rritje e lehtë në kërkesat e pranuar dhe të zgjidhura të të gjitha llojet e pensionit.


1. Përgatitja e vendimeve për të drejtat në shkallë të dytë

Deri në Komisionin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për zgjedhjen në shkallë të dytë sipas lëndëve nga sigurimi pensional dhe invalidor gjatë vitit 2011, janë parashtuar 1.408 ankesa dhe së bashku me ankesat e pazgjidhura (105 nga viti 2010) gjithsej për zgjidhje kishte 1.513 ankesa. Në krahasim me vitin 2010 kur ishin parashtuar 2.105 ankesa, në vitin 2011 ka reduktim të numrit të ankesave të parashtuara për 697 apo për 33,2%. Nga gjithsej numri i ankesave janë përgatitur 1.513 vendime apo 100% për periudhën prej 21.10.2011.


Tabela 25: Numri i ankesave të parashtruara dhe të zgjidhura prej vitit 1991 – 2011.

Viti	Kërkesa të parashtruara	Gjithsej kërkesa për zgjidhje	Kërkesa të zgjidhura	% e kërkesave të zgjidhura në raport me gjithsej kërkesat e zgjidhura
1991	3.413	3.466	3.222	93
1992	3.187	3.431	3.343	97,4
1993	4.010	4.098	3.770	92
1994	4.988	5.316	4.622	86,9
1995	5.054	5.748	5.461	95
1996	3.870	4.157	3.764	90,5
1997	4.394	4.787	3.504	73,2
1998	3.738	5.021	4.640	92,4
1999	2.990	3.371	3.087	91,6
2000	2.805	3.089	2.956	95,7
2001	3.706	3.839	3.526	91,8
2002	3.767	4.080	3.833	93,9
2003	3.880	4.127	3.850	93,3
2004	3.497	3.774	3.599	95,4
2005	2.939	3.114	2.876	92,4
2006	2.750	2.988	2.871	96,1
2007	2.975	3.092	2.954	95,5
2008	2.905	3.043	3.004	98,7
2009	2.243	2.281	2.156	94,5
2010	2.105	2.230	2.125	95,3
2011	1.408	1.513	1.513	100

Krahasimi i kërkesave të zgjidhura në raport me gjithsej kërkesat, në periudhën prej vitit 1991 deri në vitin 2011 është paraqitur në grafikonin e më poshtëm:




Numri i ankesave të zgjidhura në vitin 2010 dhe 2011 është paraqitur në grafikun e më poshtëm:



Nga gjithsej (1.513 ankesat e zgjidhura) struktura e vendimeve të sejlla në vijim:

- 659 apo 43,6% i dedikohen pensionit të pleqërisë dhe pensionit familjar,
- 652 apo 43,1% u dedikohen të drejtave nga sigurimi invalidor, gjegjësisht pensione invalidore dhe të drejtës së vazhduar të sistematizimit në tjetër punë si dhe vazhdimit të së drejtës së punës me orar të shkurtuar,
- 77 apo 5,1% i dedikohen të drejtave sipas konventave ndërkombëtare,
- 94 apo 6,2% i dedikohen stazhit pensional kontestues dhe
- 31 vendime apo 2,0% i dedikohen të drejtave të sigurimit bujqësor (obligues të tatimit mbi të hyrat nga zbatimi i veprimtarisë bujqësore).

Struktura e vendimeve të sjella:



Në vitin 2011 janë asgjësuar gjithsej 173 vendime apo 11,4% nga gjithsej projekt vendimet e sjella (1.513), ndërsa 12 vendime apo 0,8% janë ndryshuar. Vendimet e azgjësuar janë kthyer sërish në procedurë nga to

- 83 vendime i dedikohen vlerësimit të gabuar të aftësisë për punë,
- 2 vendime janë asgjësuar në pjesën e sigurimeve bujqësore për shkak zbatimit të gabuar të dispozitave dhe mos veprimit sipas këndvështrimit juridik të Fondit,

- 68 vendime janë asgjësuar për shkak të vërtetimit të gabuar të të dhënave për stazh dhe pagë, vërtetim i gabuar i pagesës fillestare të pensioneve,
- 12 vendime për shkak të të dhënave të vërtetuara në evidentimin amë pa dëshmi përkatëse dhe

- 8 vendime në pjesën e marrëveshjeve ndërkombëtare që i dedikohen zbatimit të gabuar të dispozitave të kontratave për sigurim social.

Në pjesën e realizimit të të drejtave, në vitin 2011 janë ndryshuar 12 vendime, gjegjësisht në mënyrë meritore është vendosur sipas tyre edhe atë pas 7 vendimeve nga sigurimi invalidor, 2 vendime nga sigurimi i pensionimit dhe 3 vendime sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.

Në periudhën raportuese deri te filialet e Shërbimit profesional të Fondit, është dhënë pëlqim paraprak për veprim të drejtë ndaj pranimi të të drejtës së sigurimit pensional dhe invalidor në 17 kërkesa.

Në pjesën e kontesteve administrative të Gjykatës administrative të Republikës së Maqedonisë janë sjell 116 aktgjykime, prej të cilave 41 aktvendime apo 69,5% janë negative, ndërsa 75 aktvendime apo 64,7% janë asgjësuar dhe kthyer organit të shkallës së parë me të cilët është vërtetuar ligjshmëria e vendimeve të sjella nga Komisioni i Qeverisë së Vendi për zgjidhjen në shkallë të dytë sipas lëndëve nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Nga Gjykata administrative janë 380 kërkesa për parashtrimin e aktgjykimeve me verifikimin e kontestit administrativ, ndërsa nga Komisioni i Qeverisë janë parashtruar 217 përgjigje të kërkesave të paditura dhe 39 përgjigje ankesa deri te Gjykata administrative.

Nga gjithsej 1.513 lëndët e zgjidhura, 935 lëndë janë me vendime të përgatitura (785 janë vendime në procedurë sipas ankesës dhe 150 vendime janë në

plotësimin e aktgjytimeve të Gjykatës administrative), ndërsa për 578 lëndë janë sjellë vendime. 935 vendimet e përgatitura nuk janë sjellë nga Komisioni i Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për zgjidhje në shkallë të dytë sipas lëndëve nga sigurimi pensional dhe invalidor, meqë përfundoi mandati i kryetarit të Komisionit të Qeverisë prej 1 korrikut të vitit 2011.

Prej 21.10.2011 hyri në fuqi Ligji për Komision shtetëror për vendosjen në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës, sipas të cilës procedura e shkallës së dytë dhe kontestet administrative kalojnë në kompetencë të këtij komisioni. Me dispozitën e mëparshme nga neni 11 paragrafi 1 nga Ligji për themelimin e Komisionit shtetëror për vendosje në procedurën administrative dhe në procedurë nga marrëdhënia e punës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr: 51 prej 13.04.2011), procedurat e filluara dhe procedurat që do të fillojnë para Komisioneve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen në Procedurë administrative në shkallë të dytë çështje të caktuara administrative deri në fillimin e zbatimit të këtij ligji do të mbarohen nga ana e komisioneve në afat prej 6 muaj prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Në periudhën raportuese është përgjigjur në 98 parashtresa nga Avokati i popullit, parashtresa të dorëzuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, të siguruar, përfitues të pensionit si dhe nga organizatat punuese), Me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta Zyrtare 51/2011) ndërpritet funksioni i Komisionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen në shkallë të dytë sipas lëndëve nga sigurimi pensional dhe invalidor. Me ligjin e njëjtë është ndryshuar edhe ligji 141 nga Ligji për SPI, sipas të cilit ndaj vendimeve të sjella në shkallë të dytë parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ankese deri te Komisioni shtetëror për vendim marrje në procedurë administrative dhe procedura të punësuar në shkallën e dytë.

Procedurat e filluara para Komisionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen në procedurën administrative në shkallën e dytë për çështje të caktuara administrative janë mbaruar nga ana e Komisionit në afat prej gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për themelimin e Komisionit shtetëror për vendim marrje në procedurën administrative dhe procedura të punësuar në shkallën e dytë (Gazeta Zyrtare e RM-së 51/2011, gjegjësisht të njëjtit janë përfunduar më 21 tetor të vitit 2011.

Në mars dhe prill të vitit 2011, si dhe në nëntor dhe dhjetor të vitit 2011 ishte kryer mbikëqyrje dhe instruktim në filialet dhe ekspoziturat e Fondit në drejtim të zbatimit të përfitimeve të projektit të pensionit, gjegjësisht funksionimin e lëndës elektronike në të gjitha fazat e tij nga parashtrimi i kërkesës deri në një vendim përfundimtar dhe pagesën e pensioneve.

3. Realizimi i të drejtave sipas marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social

Në vitin 2011, Fondi i SPIM-së vazhdoi t'i kryejë punët rrjedhëse në zbatimin e marrëveshjeve bilaterale për sigurim social si organ kompetent për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor . Në periudhën raportuese kanë hyrë në fuqi tre marrëveshje ndërkombëtare për sigurim social edhe atë:

- Marrëveshje me Australinë, hyri në fuqi më 01.04.2011
- Marrëveshje me Malin e Zi, hyri në fuqi më 01.08.2011
- Marrëveshja me Kanadanë, hyri në fuqi më 01.11.2011.

Gjatë vitit 2011, Fondi merrte pjesë me përfaqësues të tij në negociatat shtetërore për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social edhe atë:

- Në maj të vitit 2011 në Shkup u mbajtën bisedime ndërmjet delegacionit maqedonas dhe atij shqiptar ku ishte i shqyrtuar projekt teksti i Marrëveshjes për sigurim social ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë;


- Në nëntor të vitit 2011, gjithashtu në Shkup u mbajtën bisedime ndërmjet delegacionit maqedonas dhe atij italian për vërtetimin e Marrëveshjes administrative mbi zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet dy vendeve për sigurim social i parafuar më 1 dhjetor të vitit 2010;

- Në mars të vitit 2011 në Fond janë mbajtur bisedime me përfaqësuesit e fondit sloven në të cilat bisedime janë zgjidhur disa çështje të caktuara kontestuese dhe probleme gjatë zbatimit të Marrëveshjes mes dy vendeve.

Në Departamentin për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social pranë Qendrës së Shërbimit profesional në vitin 2011, nga të siguruarit apo nëpërmjet bartësve të huaj të sigurimit janë parashtruar 4.642 kërkesa të para për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor dhe kërkesa tjera (kërkesë për përsëritjen e procedurës, vendime të asgjësuar për pension familjar dhe për vlerën më të ulët të pensionit). Nga gjithsej numri i kërkesave për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë, australiane janë 2.673 kërkesa. Së bashku me kërkesat e pa zgjidhura nga viti 2010 (73), në vitin 2011, gjithsej për zgjidhje kishte 4.715 kërkesa. Nga gjithsej numri i kërkesave të zgjidhura dhe të kontrolluara arrin 3.939 apo 83,6%, ndërsa të pazgjidhura në fund të vitit kanë mbetur 776 kërkesa apo 16,4%.

Tablela 26: Numri i kërkesave për zgjidhje dhe kërkesa të zgjidhura

Nr. rendor	Përshkrim	Viti 2010	Viti 2011	Indeks
1	Kërkesa të bartura	91	73	
2	Kërkesa të zbatueshme	2.225	4.642	205,9
3	Gjithsej kërkesa	2.316	4.715	203,5
4	Kërkesa të zgjidhura	2.243	3.939	175,6
5	Kërkesa të pa zgjidhura	73	776	



Numri i kërkesave të zgjidhura në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 është rritur për 1.696 kërkesa apo për 75,6%, ndërsa kërkesat e pazgjidhura në fund të vitit 2011 arrijnë 776 kërkesa dhe në krahasim me vitin 2010 janë rritur për 703 kërkesa.

Nga të dhënat e lartëpërmendura mund të konstatohet se gjatë këtij viti kërkesat e parashtruara janë rritur dy herë më shumë në krahasim me vitin 2010, gjithashtu është rritur edhe numri i kërkesave të zgjidhura. Kjo është rezultat i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për sigurim social me Australinë prandaj papritmas

u rrit numri i kërkesave të parashtruara për realizimin e të drejtës në baza të ndryshme në mbështetje të Marrëveshjes.

Nga gjithsej 4.961 kërkesa të parashtruara, Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë për Australinë parashtoi 2.288 kërkesa për realizimin e të drejtës sipas dispozitave të tyre.

Gjatë vitit 2011 janë kryer edhe detyra të tjera, edhe atë:

- deri te bartësit e huaj të sigurimit janë përpunuar në formularë dygjuhësor dhe janë parashtruar 2.919 kërkesa për pension;
- Pas kërkesave të parashtruara për realizimin e të drejtës për pension, është udhëhequr korrespondencë me palët, filialet dhe bartësit e huaj, me qëllim të kompletimit të kërkesave dhe realizimit më të shpejtë të të drejtës (7.893 korrespondenca);
- Është ngritur procedurë sipas 348 kërkesave për konfirmimin e stazhit pensional të mbushur jashtë vendit për të siguruarit të cilët nuk realizojnë të drejtën e pensionit dhe në mënyrë reciproke për nevojat e bartësve të huaj është konfirmuar stazhi i Maqedonisë me formularë dygjuhësor;
- Në Komisionin invalidor të shkallës së parë janë dhënë 317 lëndë për vlerësimin e aftësisë për punë;
- Është përgjigjur për 82 shkresa;

Më datën 8 dhe 9 të muajit shkurt në Shkup u mbajtën ditë këshilluese për zbatimin e Marrëveshjes për sigurim social ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Gjermanisë ku janë shqyrtuar çështje për konfirmimin e stazhit dhe procedurën për realizimin e pensionit.

Në Mavrovë prej 11 deri më 15 prill me ftesë të Këshillit të Europës dhe Komisionit Evropian ishte mbajtur Trajnim rajonal i Komisionit evropian dhe Këshillit të Evropës për dispozitat e mbrojtjes sociale dhe koordinimit në të cilën

morren pjesë edhe përfaqësues nga Departamenti për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të Fondit.

Më 27 dhe 28 tetor në Shkup ishte mbajtur takim me përfaqësuesit e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë dhe Fondit të Malit të Zi, në të cilin takim u prezantuan sistemet pensionale të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Malit të Zi, u shkëmbyen përvoja dhe çështje në lidhje me zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor në të dy shtetet dhe çështje në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për sigurim social.

Më 15 dhe 16 nëntor të vitit 2011 u mbajt takim i drejtorëve të fondeve pensionale nga ish republikat e Jugosllavisë në të cilin takim janë shqyrtuar çështjet për shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet bartësve të sigurimit social, problemet aktuale gjatë zbatimit të marrëveshjeve për sigurim social, zhvillimi i bisedimeve më të shpeshta në nivel të organeve për lidhje dhe vazhdimi i këtyre takimeve në nivel të drejtorëve edhe në të ardhmen.

Në vitin 2011 gjithashtu ishte përgatitur dhe Plan për ditë të hapura në filialet e Fondit për të siguruarit të cilët kanë realizuar stazh në vendet e huaja. Takimi i parë u mbajt në Manastir me përfaqësues nga Departamenti për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të siguruarit. Takimi i dytë u mbajt në Gostivar dhe të njëjtat do të vazhdojnë edhe në vendet tjera të Maqedonisë gjatë vitit 2012.

Në zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare në Fond, gjatë vitit 2011 është kryer përkthim i 6.635 faqeve (nga frenqishtja në maqedonisht dhe anasjelltas 2.056 faqe, nga gjuha angleze në atë maqedonase dhe anasjelltas 1.294 faqe, prej italishtes në maqedonisht dhe anasjelltas 564 faqe dhe 2.721 faqe prej gjermanishtes në maqedonisht). Për nevojat e bartësve të huaj për sigurim social janë shfrytëzuar edhe përkthyes nga jashtë për përkthimin e 254 faqeve nga gjuha çeke, polake, hungareze, bullgare, suedeze, turke, sllovaqe, holandeze, greke, rumune, gjuha flamene, daneze, angleze dhe nga gjuha sllovene në atë maqedonase, janë plotësuar formularë njëgjyhësor për pensione, janë dhënë vërtetime për jetë,

janë përkthyer formularë për bisedime sipas marrëveshjeve të reja si dhe detyra të tjera nga fusha e këtij sigurimi.

4. Puna e Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë

Në procedurën për realizimin e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor, rëndësi të madhe ka vlerësimi i aftësisë për punë sepse në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit fizik realizohen të drejtat materiale afat gjate nga sfera e sigurimit pensional dhe invalidor.

Në mbështetje me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, tek i siguruari ekziston invaliditet kur për shkak ndryshimeve të përhershme të gjendjes shëndetësore të të siguarit janë shkaktuar lëndime në punë, sëmundje profesionale, lëndim jashtë punës apo me sëmundje që nuk mund të shmangen me mjekim ose me masa të rehabilitimit medicinal, do të shfaqet reduktim apo humbje e aftësisë për punë për kryerjen e punëve në vendin e punës ku i siguruari ka qenë i sistemuar para shkaktimit të invaliditetit.

Invaliditeti tek i siguruari si bazë për realizimin e të drejtës së sigurimit pensional dhe invalidor, vërtetohet në Fond nëpërmjet Komisionit për vlerësimin e aftësisë së punës i cili zbaton këqyrje detale në dokumentacionin mjekësor dhe në dokumentacion tjetër të parashtruar si dhe në bazë të kontrollit të drejtpërdrejtë të të siguarit.

Në vitin 2011 Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë punonte në dy grupe me nga dy mjekë – specialistë. Komisioni për kontroll të detyrueshëm mjekësor punonte në një përbërje me nga tre mjekë, ndërsa Komisioni për përcaktimin e kompletimit dhe rregullimit të dokumentacionit punonte me një anëtarë, ndërsa që lëndët të kompletohen me kohë, herë pas here ishin angazhuar edhe mjekë tjerë.

Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë si organ i vetëm kompetent pas gjendjes së vërtetuar faktike dhe kontrollit të kryer solli konstatim, vlerësim dhe

mendim për aftësinë e humbur për punë, për përcaktimin e aftësisë së mbetur për punë, për përqindjen e dëmtimit fizik, konstatim për përcaktimin e paaftësisë për punë, realizimin e të drejtës së pensionit familjar për një anëtarë të familjes si dhe konstatim për përcaktimin e invaliditetit tek personi me invaliditet, ndërsa me qëllim të punësimit të të njëjtit në ofiqinë mbrojtëse dhe rrezik të drejtëpërdrejtë nga shkaktimi i invaliditetit etj.

Gjithashtu, në mbështetje të Ligjit për mbrojtje sociale, Komisioni sillte Konstatim, vlerësim dhe mendim për realizimin e të drejtës së ndihmës së përhershme monetare, vërteton statusin e personit me invaliditet në mbështetje të Ligjit për persona me invaliditet etj.

Në vitin 2011, deri te Komisioni invalidor i shkallës së parë kanë arritur dhe verifikuar 5.782 lëndë për vlerësimin e aftësisë për punë. Në krahasim me vitin 2010 kur janë parashtruar 7.304 lëndë, evidentohet numër i reduktuar i kërkesave të arritura për 1.522 lëndë apo 20.8%.

Gjatë vitit raportues nga gjithsej lëndët e arritura dhe të regjistruara është vepruar sipas lëndëve në vijim:

1. Kërkesa të pranuar dhe regjistruara - 5.782
2. Lëndë të kompletuara dhe palë të ftuar në procedurën e realizimit të së drejtës në bazë të invaliditetit – 5.586
3. Lëndë të kompletuara dhe palë të ftuar në procedurën e kontrollit të detyrueshëm mjekësor – 506,
4. Letra të dërguara deri te palët për rikompletimin e dokumentacionit mjekësor dhe dokumentacionit të punës – 629.
5. Letra të dërguara deri te filialet për refuzimin e kërkesave për shkak mungesës së dokumentacionit të punës dhe atij mjekësor -79
6. Letra të dërguara deri te pala me kërkesë të komisionit të revizionit për rikompletimin e dokumentacionit mjekësor - 176

Për lëndët e pakompletuara nga ana e Departamentit për vlerësimin e aftësisë për punë janë përgatitur shkresa për rikompletimin e tyre për sjelljen e konstatimit përkatës, vlerësim dhe mendim sipas kërkesës. Konstatohet se në pjesën më të madhe lëndët nuk janë kopmletuar me dokumenatacion përkatës mjekësor, ka mungesë të formularit nr.3, propozim për një ekspertizë mjekësore nga mjeku amë, formular A1, - kushtet për punë dhe detyrat e punës, kontroll i të dhënave për stazh dhe paga. Gjithashtu, te një pjesë e kërkesave ka ekzistuar dokumentacion me afat të skaduar, apo kërkesa të parakohshme për vlerësim të sërishëm të aftësisë për punë. Një pjesë e lëndëve kthehen në filialet sepse të siguruait nuk janë paraqitur në dy apo në më shumë ftesa nga ana e Komisionit.

Komisioni për kompletimin dhe rregullimin e lëndëve në vitin 2011 i realizoi aktivitetet në vijim: 915 lëndë janë kthyer deri te filialet për shkak të ndërprerjes së procedurës për vlerësimin e aftësisë për punë me arsye të ndryshme (kërkesë e parakohshme, pa dokumentacion mjekësor minimal, mos mbushjen e 1/3 e stazhit sipas nenit 63 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, bashkim me lëndë të vjetër, përcaktimin e stazhit jashtë vendit, pala nuk i është paraqitë dy herë ftesës apo kërkuesi ka vdekur).

Gjatë vitit 2011, Departamenti për vlerësimin e aftësisë për punë vepronte edhe sipas 131 lëndëve për punësimin e personave invalid në mbështetje të nenit 2 nga Ligji për punësimin e personave invalid.

Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë në vitin 2011 vepronte sipas 5.586 kërkesave të parashtruara dhe 1.525 lëndëve të cilët nuk kanë qenë të zgjidhura në vitin 2010, apo gjithsej 7.111 lëndë. Nga ky numër i lëndëve, ndërsa në bazë të gjendjes së caktuar faktike në vitin 2011 u sollën gjithsej 3.987 konstatime, apo për 31,8% më pak në krahasim me vitin 2010. Reduktimi i numrit të lëndëve sipas të cilëve është sjellë konstatim përkatës ndodh për shkak reduktimit të numrit të personave profesional (mjek specialistë), me çka Komisioni nuk është në gjendje që të veprojë me kohë për të gjitha kërkesat.

Për shkak të këtyre arsyeve në mesataren ditore veprohet në 24 ftesa të parashtruara për kontroll të drejtpërdrejtë dhe sjellje të konstatimit.

Nga gjithsej numri i 7.111 lëndëve, Komisioni solli 3.313 konstatime për vlerësimin e aftësisë për punë, dy konstatime për mbrojtje shëndetësore dhe 201 konstatime për caktimin e përqindjes të dëmtimit trupor.


Struktura dhe lloji i kërkesave të ekspertuara në vitin 2011 paraqitet në vazhdim:

- 1.273 kërkesa apo 38,4% për realizimin e të drejtës së pensionit invalidor, edhe atë: 801 kërkesa apo 62,9% për paaftësi të përgjithshme, 8 kërkesa apo 0,6% edhe mëtutje paaftësi e përgjithshme për punë dhe 464 kërkesa apo 36,5% paaftësi profesionale për punë me të drejtë të pensionit;
- 110 kërkesa apo 3,3% për aftësi të zvogëluar pune me orar të shkurtuar të punës ;
- 53 kërkesa apo 1,6% për ndryshimin e vendit të punës ;
- 138 kërkesa apo 4,2% edhe më tej aftësi e zvogëluar pune;
- 455 kërkesa apo 13,7% mjekimi nuk ka mbaruar;
- 675 kërkesa apo 20,4% nuk ekziston invaliditet;
- 20 kërkesa apo 0,6% raste tjera;
- 385 kërkesa apo 11,6% kontrole të sërishme;
- 118 kërkesa apo 3,6% për pension familjar , dhe
- 86 konstatime apo 2,6% për bartësit e huaj të sigurimit

Tabela 27: Pasqyrë e kërkesave të zgjidhura për vlerësimin e aftësisë për punë sipas llojit në vitin 2011 dhe 2010 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr. rendor	Lloji i rasteve	Viti 2010		Viti 2011		Indeksi
		numri	struktura	numri	struktura	2011/2010
1	Paaftësi e përgjithshme për punë	1.486	32,5	1.273	38,4	85,7
2	Orari i shkurtuar i punës	135	3,0	110	3,3	81,5
3	Ndryshim i punës	120	2,6	53	1,6	44,2
4	Edhe më tej aftësi e zvogëluar për punë	250	5,5	138	4,2	55,2
5	Mjekimi nuk ka mbaruar	632	13,8	455	13,7	72,0
6	Nuk ekziston invaliditet	1.241	27,2	675	20,4	54,4
7	Raste tjera	19	0,4	20	0,6	105,3
8	Kontrolle mjeksore të sërishme	421	9,2	385	11,6	91,5
9	Pensioni familjarë	175	3,8	118	3,6	67,4
10	Konstatime për bartësit e huaj	93	2,0	86	2,6	92,5
	GJITHSEJ I	4.572	100,0	3.313	100,0	72,5
1	Mbrojtje shëndetësore	14	0,7	2	0,3	14,3
2	Dëmtim trupor	254	28,6	201	29,8	79,1
3	Kontroll mjekësor	1.003	70,7	471	69,9	47,0
	GJITHSEJ II	1.271	100	674	100	53,0
	GJITHSEJ (I +II)	5.843		3.987	100	68,2

Struktura e kërkesave të ekspertuara mund të vërehet nga grafikoni i mëposhtëm:



Sipas të dhënave në tabelë në vitin 2011 në raport me vitin 2010 vërehet se është reduktuar numri i kërkesave të zgjidhura për të drejtën e pensionit me paaftësi të përgjithshme dhe profesionale për punë për 14,3%, ndërsa ekziston edhe reduktim i kërkesave të zgjidhura për mjekimi nuk ka mbaruar për 28,0% dhe mosekzistim i invaliditetit për 45,6%.

Tabela 28. Numri i konstatimeve të sjellura për vlerësimin e aftësisë për punë sipas viteve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti	Vlerësim i aftësisë për punë	Dëmtim trupor	Kujdes nga person tjetër dhe ndihmë	Kërkesa tjera	Gjithsej
1991	15.074	498	1.448	11.191	18.211
1992	13.080	359	1.209	1.105	15.761
1993	14.347	258	1.523	457	16.585
1994	13.114	327	1.783	558	15.782
1995	12.529	323	3.128	726	16.706
1996	10.773	315	5.157	845	17.090
1997	13.493	458	6.088	475	20.514
1998	13.796	510	7.057	414	21.777
1999	11.940	492	9.380	383	22.195
2000	10.738	467	11.357	379	22.941
2001	11.557	436	13.441	220	25.654
2002	10.530	423	16.364	277	27.594
2003	10.762	456	14.090	317	25.625
2004	8.936	421	15.544	238	25.139
2005	8.770	432	15.797	146	25.145
2006	8.450	402	13.273	293	22.418
2007	7.397	345	-	963	8.705
2008	6.605	297		1.689	8.591
2009	6.221	358		1.069	7.648
2010	4.479	254		1.110	5.843
2011	3.225	201		561	3.987

Sipas të dhënave në tabelë rrjedh se edhe në vitin 2011 vazhdon tendenca për reduktimin e konstatimeve të sjella mbi vlerësimin e aftësisë për punë në raport të viteve paraprake, duke filluar nga viti 2004.

Komisioni për kontrollin e detyrueshëm mjekësor të përfituesve të pensionit të përkohshëm invalidor, gjegjësisht pensionit familjar gjatë vitit 2011 ka ekspertuar në 471 raste. Nga ato, 356 lëndë janë dërguar deri te Komisioni për revizion të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit me të cilët është përcaktuar invaliditet, gjegjësisht paaftësia për punë. Komisioni për revizion ka vërtetuar 313 konstatime apo 88%, ndërsa nuk ka vërtetuar 43 konstatime apo 12%. Në vitin 2011 sipas konstatimeve të sjella të Komisionit për kontroll të detyrueshëm dhe Komisionit për revizion janë ndërprerë 169 pensione me vlerësim se nuk ekziston kategori e invaliditetit e cila përfshin të drejtën për pension.

Në mbështetje të nenit 139-a nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/2004) është vërtetuar konstatimi, vlerësimi dhe mendimi i Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë me të cilat është vërtetuar invaliditet, gjegjësisht paaftësi për punë, në bazë të të cilave përfitohet e drejta e pensionit, të jetë subjekt i vlerësimit – revizion nga Komisioni për rivlerësim – revizion i konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit, gjegjësisht paaftësisë për punë.

Në bazë të evidencës së plotë të konstatimeve të kthyera nga Komisioni i revizionit është vërtetuar gjendja e mëposhtme:

2011	Aftësi e humbur për punë	Konstati me negative	Kontroll i detyrueshëm mjekësor konstatime pozitive	Kontroll i detyrueshëm mjekësor konstatime negative	Gjithsej
Gjithsej	1218	929	301	55	2.503
Të vërtetuara	1209	820	277	36	2.342
Të pavërtetuara	9	109	24	19	161

Në vitin 2011 me kërkesë të Komisionit për revizion pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale janë parashtruar 929 konstatime negative. Nga këta Komisioni për revizion vërtetoi 820 konstatime apo 88,3% nga gjithsej numri i konstatimeve negative, ndërsa të pa vërtetuara janë 109 apo 11,7%.

Gjithashtu janë parashtruar edhe 1.218 konstatime pozitive deri te Komisioni për revizion pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale prej të cilëve janë vërtetuar 1.209 konstatime apo 99,3%, ndërsa të pavërtetuara janë 9 konstatime apo 0,7%.

5. Stazhi i sigurimit i cili konsiderohet me kohëzgjatje të shtuar

Në vitin 2011 Fondi në mbështetje të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta Zyrtare e RM-së 153/2007) i cili hyri në fuqi në vitin 2011 në pjesën e stazhit të sigurimit me kohëzgjatje të shtuar, gjegjësisht me hyrjen e Rregullores në fuqi të sjellë nga Ministri i punës dhe politikës sociale për vendet e punës në të cilat është i paraparë stazh i sigurimit me kohëzgjatje të shtuar është ndërprerë procedura lidhur me përcaktimin e vendeve

të punës të cilëve stazhi i sigurimit u llogaritet mekohëzgjatje të shtuar, si dhe me obligimin që të zbatohet revizion i vendeve të punës për të cilët veç më është i përcaktuar stazhi me kohëzgjatje të shtuar.

Pikërisht me ndryshimet e nenit 126 nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor është paraparë që vendet e punës të cilave stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar përcaktohen me Rregulloren e sjellë nga Ministri i punës dhe politikës sociale, pas pëlqimit të marrë paraprak nga ana e institucioneve përkatëse profesionale.

Për këto arsye me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe Rregullorja pushojnë të vlejnë vendimet për përcaktimin e vendeve të punës për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të shtuar të sjella nga Këshilli drejtues i Fondit prej 01-01-1975 deri më 31-12-2010.

Këshilli drejtues i Fondit në seancën e mbajtur më 30.03.2011 i ndërpreu të gjitha vendimet e miratuara në këtë periudhë në lidhje me vendet e punës të cilave stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar.

Gjithashtu, me ndryshimet e nenit 127 të Ligjit të njëjtë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor është përcaktuar se, po qe se disa nga vendet e punës të cilave stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar nuk janë përfshirë me Rregulloren e nenit 126-a, shkallën e rritjes së stazhit të sigurimit me kohëzgjatje të shtuar për këto vende të punës e përcakton Fondi me akt të përgjithshëm.

Komisioni për stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar mbajtën një mbledhje dhe e shqyrtuan dokumentacionin e marrë dhe pas marrjes së mendimit pozitiv nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale i propozon Këshillit drejtues të Fondit që ta miratojë.

Për këta vende të punës të përcaktuara dhe të cilave stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar në mbështetje të Ligjit për sigurim pensional

dhe invalidor është paraparë edhe revizion nga ana e Fondit, në periudhë maksimale prej 5 vjetësh. Kjo ndodh me arsye se zhvillimi i proceseve teknologjike mund të mundësojë ndryshim në vështirësitë e punës si dhe në rreziqet që çojnë deri në ndryshimet e vendeve të punës.

Në vitin 2011 deri te Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor nga punëdhënësit nuk ka të ngritur procedurë në kërkesat e para si dhe në procedurën e revizionit dhe nuk janë miratuar vendime nga Këshilli drejtues i Fondit.

6. Evidentimi amë

Në vitin 2011, Shërbimi profesional i Fondit në pjesën e evidentimit amë i zbatonte detyrat që dalin nga puna e vazhdueshme e Shërbimit dhe detyrat që kanë të bëjnë me zbatimin e proceseve të reja të domosdoshme për funksionimin e reformave në sistemin pensional.

Gjatë periudhës raportuese u theksuan veçanërisht këta aktivitete:

1. Implementimi i projektit “Zgjidhja dhe pagesa e pensioneve”

Gjatë implementimit të vendimeve të reja aplikative për zbatimin e procedurës për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, paralelisht janë kryer edhe ndryshime dhe plotësime të vendimeve aplikative në aspektin e përmirësimit të tyre.

Nga problemet e konstatuara në punën e ekspoziturave dhe filialeve të Fondit, dolën edhe kërkesa të veçanta deri te zhvilluesi i softuerit për përmirësimin dhe përsosjen e vendimeve aplikative.

Si rezultat i këtyre aktiviteve, dolën më shumë ndryshime dhe plotësime mbi aplikimin në pjesën e evidentimit amë për të siguruarit, ndër të cilat më të rëndësishme janë:

- krijimi i një opsioni për ndjekjen dhe saktësimin e të dhënave të pavlefshme për stazhin e sigurimin dhe pagat;

- implementimi i korrigjimeve të zbatuara mbi identifikuesin themelor NVAQ në të gjitha tabelat me të dhënat për të siguruarit dhe përfituesit e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor;
- përcaktim zyrtar të NVAQ-së
- regjistrim në mënyrë automatike, të Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2 me të dhëna për të siguruarin në dosjen elektronike të lëndës së pensionit;
- përfundimi i të dhënave për stazhin e sigurimit dhe pagat për personat të cilët kanë realizuar të drejtën e pensionit. Të dhënat për këta persona do të mund të ndryshojnë kur do të parashtrohet kërkesë mbi përsëritjen e procedurës apo atëherë kur është iniciuar procedurë tjetër ligjore për shkak të së cilës duhet të ndryshohen të dhënat në evidentimin amë.

Gjatë kësaj periudhe punohej edhe në zgjidhjen e problemeve të veçanta të paraqitura nga filialet dhe ekspoziturat. Komunikimi me zhvilluesin e softuerit dhe parashtrimi i kërkesave zhvillohej nëpërmjet një aplikimit të veçantë modern (Redmine) për komunikim, për të cilën ishin autorizuar disa nga udhëheqësit në Qendrën e Fondit.

2. Implementimi i pilot - Projektit "Zarfi i portokalltë"

Pilot - projekti "Zarfi i portokalltë" doli nga nevoja për krijimin e një lloji të ri të komunikimit me të siguruarit dhe sigurimin e transparencës më të madhe në punën e Fondit. Qëllimet kryesore të projektit janë:

- rritja e vetëdijes së qytetarëve mbi të drejtën e tyre për realizimin e pensionit e cila varet nga obligimet e rregullta të dokumentuara për kontribute të paguara nëpërmjet informimit të qytetarëve për rregullsinë e dokumentacionit të tyre, gjegjësisht stazhin e regjistruar në sistemin elektronik të Fondit;

- rritja e sigurisë në sistem nëpërmjet informimit për lartësinë e pensionit të cilën qytetarët mund ta realizojnë po që se pensionohen në moshën 62 vjeçe gjegjësisht 64 vjet apo më vonë;

- rritja e besimit në sistem nëpërmjet informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre pensionale dhe në mënyrë të njëjtat mund të realizohen.

Në fillim me Projektin u përfshinë një pjesë e filialeve dhe ekspoziturave, edhe atë Kavadar, Negotinë, Vallandovë, Makedonski Brod dhe Strugë.

Për zbatimin e këtij projekti u përgatit vendim i veçantë aplikativ për gjenerimin e letrave me njoftime për të siguruarit, ndërsa paralelisht u zbatua saktësimi dhe përcaktimi i të dhënave për stazhin e sigurimit dhe pagat në filialet dhe ekspoziturat e përmendura.

Përcaktimi dhe saktësimi i të dhënave ndodhi me qëllim që të sigurohen të dhëna më të plota dhe më të sakta për të siguruarit, prej ku edhe do të dalin informacionet përkatëse në “Zarfin e portokalltë”, për stazhin e sigurimit, kontributet e paguara dhe vlerësimi i llogaritjes së pensionit të të siguruarve të cilët janë dy vite para pensionimit, (gjegjësisht 60 vjet gra dhe 62 vjet burra);

Në tetor të vitit 2011 ishin dërguar zarfe portokalli për 28.967 të siguruar, edhe atë: në Kavadar (10.753), Strugë (9.458), Makedonski Brod (1.132), Vallandovë (2.733) dhe në Negotinë (4.891).

Nga analizat e bëra mbi realizimin e projektit u vërtetua se nga gjithsej njoftimet e parashtruara mbi 6.200 apo 21,4% nga gjithsej të siguruarit e njoftuar janë paraqitur apo drejtpërdrejtë janë drejtuar në filialin përkatës të Fondit për kompletimin e të dhënave për stazh dhe pagë. Nga gjithsej 6.200 të siguruar, për 4.000 të siguruar apo 64,5% në vend ngjarje është bërë zgjidhja e të dhënave të pa kompletuara për stazh dhe pagë që tregon se shërbimi nga ana e filialeve të Fondit është efektive dhe cilësore. Për 2.200 të siguruarit e tjerë është nevojitur procedurë plotësuese për kompletimin e stazhit të sigurimit dhe pagave, për shkak se stazhi u soll nga ndonjë shtet tjetër apo subjekti juridik nuk ka ekzistuar. Për këta raste

filialet e Fondit me detyrë zyrtare nëpërmjet këmbimit të të dhënave me institucionet tjera dhe organet e shteteve tjera i përfundojnë procedurat, ndërsa me këtë mundësohet kompletimi i të dhënave në kohë të duhur nga fusha e sigurimit social.

3. Gjenerimi dhe përcaktimi i të dhënave për stazhin e sigurimit dhe pagat

Në filialet dhe ekspoziturat e Fondit në kontinuitet zbatohet gjenerimi dhe përcaktimi i të dhënave për stazh dhe pagë, por me intensitet më të rritur në tre muajin e fundit nga viti 2011. Kjo ndodh nga arsyeja se resurset njerëzore në pjesën më të madhe ishin të kahëzuara në testime dhe implementimin e aplikimit të ri të Projektit për zgjidhjen dhe pagesën e pensioneve.

4. Implementimi i Regullores për përcaktimin e vendeve të punës të cilave stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar

Në mbështetje të Regullores për përcaktimin e vendeve të punës të cilave stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 32/2011) është miratuar Vendim për plotësimin e Vendimit për përcaktimin e kodeksit të vetëm të shifrave mbi regjistrimin e të dhënave në evidentimin amë, i shpallur në Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 89/2011. Për vendet e punës të cilat stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar janë vendosur shifra të reja për shënimin e stazhit dhe të njëjtat janë azhurnuar në aplikimin si dhe në softuerin për parashtrimin e LLMKR fletëparaqitjeve në Drejtorinë e të Hyrave Publike.

5. Lidhja e Marrëveshjeve për bashkëpunim dhe këmbimi i të dhënave me institucione tjera

Në mars të vitit 2011 janë lidhur marrëveshje për bashkëpunim dhe këmbimin e të dhënave me Ministrinë e Drejtësisë – Drejtorinë për Udhëheqjen e Librave Amë dhe me Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë.

Gjithashtu, janë përgatitur edhe Propozim marrëveshje për bashkëpunim me Lidhjen e shoqatave të Maqedonisë, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministrinë e Arsimit – Inspektorati shtetëror arsimor.

Në vitin 2011 në kontinuitet ishin marrë të dhëna për persona të ndjerë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe është kryer krahasim me të dhënat për përfituesit e të drejtës të evidentuara në evidentimin amë të Fondit, janë përgatitur kërkesa për ndryshime dhe plotësime të aplikimit, është kryer mbikëqyrje dhe instruksion në pjesën më të madhe të filialeve dhe ekspoziturave të Fondit, ndërsa ishin zbatuar edhe punët rrjedhëse të cilat dolën nga puna e rregullt në pjesën e evidentimit amë.

7. Pagesa e pensioneve

Me implementimin e softuerit të ri në pjesën e zgjidhjes dhe pagesës së pensioneve, nga fillimi i vitit 2011 është vendosur lëndë elektronike me çka në një shkallë më të lartë është eliminuar puna manuale dhe është siguruar kontroll automatik në procesin për pagesën e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor.

Letrat dhe dokumentet e dedikuara për palët dhe institucionet e jashtme të cilat kanë parashtruar kërkesë të caktuar, skanohen dhe depozitohen në lëndë elektronike.

Implementimi i lëndës elektronike siguron qasje direkte në dokumentacionin e lëndëve, pa lëvizje fizike në formë letre.

Pagesa e të ardhurave pensionale e përfituesve të pensionit është njëra nga funksionet themelore të Fondit gjatë zbatimit të sigurimit pensional dhe invalidor. Në vitin 2011 në javën e parë të muajit kryhej pagesa e pensionit për muajin paraprak.

Në vitin 2011 u zbatua harmonizimi i rregullt i pensioneve në mbështetje të rregullativave ligjore, edhe atë: 0,75% nga 1 janari dhe 2,10% nga 1 korriku i vitit 2011.

Gjatë vitit janë kryer pagesa sikurse për përfituesit e pensionit ashtu edhe për përfituesit me dëmtim fizik dhe kompensimeve në të holla.

Përveç pagesës së rregullt, Fondi çdo muaj kryente edhe pagesa manuale të pensioneve për përfituesit e ndjerë deri në ditën e vdekjes me kërkesë të trashëgimtarëve dhe dallime sipas vendimit për periudhën e kaluar.

Për të gjithë përfituesit e rinj të pensionit Departamenti për likuidimin dhe pagesën e përfitimeve pensionale formoi dosje financiare për të drejtën e parë të përfituesit të pensionit, kontrollin e tij dhe përcaktimin e pagesës.

Me dispozitat e Ligjit për qarkullim pagesor dhe Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për formën dhe përmbajtjen e instrumenteve të pagesore për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend u ndërpre pagesa e pensioneve në para të gatshme. Pagesa e fundit në para të gatshme (me urdhëresë) është bërë në dhjetor e cila zbatohet përfundimisht me pagesën pensionale për muajin nëntor të vitit 2009.

Përfituesit e pensionit të cilët pas 1 janarit të vitit 2010 nuk kanë hapur llogari të transaksionit, pagesa e pensioneve u ishte ndërprerë deri në hapjen e llogarisë së transaksionit.

Në vitin 2011 pagesën e plotë Fondi e kryente nëpërmjet llogarive të transaksionit të përfituesve të pensionit.

Fondi gjatë vitit 2011, përveç pagesës së pensioneve të përfituesve të pensionit të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë kryente edhe pagesën pensioneve të përfituesve të Maqedonistë me vendbanim jashtë Vendit, edhe atë që e veçantë është pagesa për ish republikat e RSFJ-së dhe pagesë e veçantë për pensionistët të cilët jetojnë jashtë rajonit të të njëjtit. Për përfituesit e rinjt të pensionit janë hapur dosje financiare dhe është bërë kontroll për të njëjtit, llogaritje, likuidim dhe kontroll i të gjitha vendimeve për ripërtëritje, parapensionim, vendime ndërprerëse të cilat janë parashtruar nga filialet e Fondit, si dhe kontroll i një numri më të madh të vendimeve ekzekutive të cilat janë parashtruar nga gjyqet dhe ekzekutuesit, kyçje, çkyqje dhe evidentim i ndryshimeve në shumat e pensionit sipas bazave të ndryshme.

Në fillim të vitit 2011 deri të këta përfitues janë dërguar kërkesa për parashtrimin e vërtetimeve për jetë. Të gjitha vërtetimet e arritura për jetë janë përpunuar dhe këtyre pensionistëve u është vazhduar pagesa e pensionit. Për ata përfitues të cilët nuk kanë parashtruar vërtetime për jetë pensioni u vu në pritje deri në marrjen e vërtetimit, sikurse për pensionistët të cilëve pensioni u paguhet nëpërmjet pensionit të autorizuar ashtu edhe për personat e paaftë të cilët pensionin e pranojnë nëpërmjet tutorit ndërsa nuk kanë parashtruar vërtetim për jetë.

Për të gjithë përfituesit e pensionit familjar – fëmijë më të moshuar se 15 vjet të cilët kanë parashtruar vërtetime shkollore deri më 01.09.2011 për nxënës, gjegjësisht deri më 01.10.2011 për studentë, e drejta e shfrytëzimit të pensionit u vazhdohet, derisa për të tjerët të cilët nuk kanë parashtruar, pensioni u vu në pritje deri në parashtrimin e tyre.

Gjithashtu, në mbështetje të rregullativës ligjore në vitin 2011 është bërë përfshirje e ndalesës së pensioneve sipas bazave të ndryshme (vendime gjyqësore dhe vendime tjera), mbajtje në bazë të pagesës së dëmeve për më shumë apo pensione të paguara gabimisht, si dhe është përjashtuar pagesa e përfituesve të

pensionit të cilët janë në marrëdhënie pune në mbështetje me ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor. Në bashkëpunim me Sektorin e informatikës dhe Departamentin për evidentimin amë është kryer dizajnim, përpunim, testim dhe shfrytëzim i vendimeve aplikative për lëshimin e vërtetimeve për llogarinë e transakcionit gjatë parashtrimit të kërkesës për realizimin e të drejtës së pensionit. Është kryer administrim i të dhënave në bazën e plotë për pagesën pensione me të dhënat nga Ministria e Punëve të Brendshme si dhe Ministria e Drejtësisë – Drejtoria për udhëheqjen e librave amë nga e cila një herë në muaj dorëzohen lista me të dhëna për personat e vdekur si dhe pensionistë të shpërngulur. Sipas të njëjtave janë ndërmarrë aktivitete në mbështetje të regulativës ligjore ekzistuese.

Gjithashtu, në vitin 2011 janë lëshuar vërtetime për statusin e përfituesit të pensionit, vërtetime mbi përfitimet e realizuara pensionale mujore, vërtetime për tatim, vërtetime për lartësinë e pensionit nga e drejta e parë e përfituesit të pensionit me kërkesë të Department of Human Services-Centrelink International Australi në formular të përcaktuar në mbështetje të marrëveshjes ndërkombëtare e cila hyri në fuqi në vitin 2011.

7. Puna pronësoro juridike

Gjatë vitit 2011 Shërbimi profesional i Fondit, në pjesën e punës pronësoro-juridike ka ndërmarr më shumë aktivitete për shkak të mbrojtjes së interesave, mjeteve dhe pronës së Fondit.

Për këtë qëllim aktivitetet e Shërbimit profesional ishin kahëzuar drejt:

- pagesës së kërkesave sipas fletëparaqitjeve të parashtruara për pagesa të pabaza në barrë të Fondit nëpërmjet përgatitjes dhe dërgimit të vërejtjeve para padisë, lidhje të marrëveshjeve për pagesë vullnetare të borxhit;

- vazhdim të procedurës para gjyqeve për lëndët nga vitet e kaluara si dhe për lëndët nga viti 2011 në bazë të regresit të pa paguar, ndërsa me vërejtje të dorëzuar paraprake;
- përgatitje të padive për kërkesat të cilat debitorët nuk i kanë paguar pas vërejtjes;
- ngritje të procedurave falimentuese dhe paraqitje të kërkesave në procedura të ngritura falimentuese;
- inicim të procedurave gjyqësore për qiratë nga shfrytëzimi i hapësirës afariste;
- pagesë gjyqësore të regresit nga aksidentet e shkaktuara në komunikacion dhe fatkeqësitë në punë;
- përfaqësim në procedurat e marrëdhënies së punës
- përfaqësim në procedura penale;
- përfaqësim të interesave të Fondit në procedura gjyqësore në të cilat Fondi paraqitet si anë në padi.

Në vitin 2011 shërbimi juridik i Fondit ka ndërmarr aktivitete me vazhdimin e procedurave pas padive në lidhje me borxhet e pa paguara. Këto procedura kanë të bëjnë me dëmet e shkaktuara në bazë të pensioneve të ndërprera invalidore si dhe punësimi i përfituesve aktiv të pensionit, pagesa e pensionit të përfituesve të ndjerë të pensionit si dhe pagesa e pensioneve familjare të përfituesve të pensionit të cilëve u është ndërprerë e drejta në mbështetje me dispozitat ligjore dhe sipas bazave tjera.

Sipas të gjitha bazave në vitin 2011 në Fond janë pranuar 974 fletëparaqitje – kalkulime për dëme dhe për të njëjtat janë formuar lëndë për kërkesa të dëmtuara me çka për të gjitha janë përgatitur vërejtje para padisë dhe të njëjtat u janë dorëzuar debitorëve. Gjithsej kërkesat sipas dëmeve të nënvizuara arrijnë 44,05 milion denarë, ndërsa janë paguar 2,87 milion denarë apo vetëm 6,5% nga gjithsej borxhi. Për pagesën e kërkesave në mënyrë gjyqësore apo jashtë gjyqësore kanë

mbetur 41,18 milion denarë. Janë iniciuar 74 procedura gjyqësore. Për pjesën më të madhe të lëndëve aktive janë dhënë deklarata për pagim në këste, ndërsa të tjerat janë në fazën e përgatitjes për padi.

Gjithashtu, në Seksionin për punë pronësoro juridike ndërmerren aktivitete dhe përgatiten padi për pagesën e mjeteve në bazë të pensioneve fiktive. Përfundimisht me vitin 2011 janë pranuar 264 lëndë të gjithsej borxhit prej 93,59 milion denarë prej të cilëve 44,27 milion denarë janë paguar apo 47,3%. Borxhin tjetër debitorët e paguajnë në këste, ndërsa për një pjesë udhëhiqen procedura gjyqësore të cilat janë në faza të ndryshme para gjyqeve kompetente.

Fondi udhëheq edhe procedura tjera gjyqësore siç janë: falimentimet, kontestet e shoqatave të pensionistëve si dhe procedura penale kundër palëve, përfitues të pensionit të cilët kanë realizuar pension të pleqërisë në bazë të stazhit fiktiv.

Theks i veçantë në shërbimin juridik të Fondit vihet në procedurat falimentuese për të cilat në vitin 2011 janë parashtruar 31 fletëparaqitje për kërkesa. Këto kërkesa të paraqitura nga falimentimi në vitin 2011 arrijnë 105,91 milion denarë prej të cilave si borxh kryesorë janë 71,41 milion denarë, ndërsa në bazë të interesit 34,50 milion denarë. Që të paguhet një pjesë e kërkesave e cila në procedurat falimentuese realizohet shumë vështirë, zbatohen të gjithë mekanizmat juridik të cilat janë në dispozicion. Pjesa më e madhe e procedurave falimentuese përfundojnë me mbylljen e procedurës për shkak mungesës të pronës së debitorit falimentues apo në shndërrimin e pronës në para, ndërsa në zëvendësimin e mjeteve monetare ofrohen aksione apo mjete themelore, ndërsa lartësia e pronës së shndërruar në para varet nga përqindja e pjesëmarrjes në pasurinë falimentuese.

Në Fond, në vitin 2011 janë ndërmarr edhe aktivitete në sferën e procedurave penale. Në vitin 2011 janë ngritur 15 fletëparaqitje deri te prokuroria themelore publike për persona-përfitues të pensionit të cilët pa bazë kanë realizuar të drejtën

e pensionit si dhe përfaqësim para gjykatës kompetente në gjyqin penal dhe procedurat e zbatuara.

Në vitin 2011 në Fond udhëhiqen edhe lëndë pronësore për shtëpitë e pensionistëve me të cilat ekonomizon Fondi. Këto procedura iniciohen nga ana e shoqatave të pensionistëve, me qëllim që të njëjtat të fitojnë të drejtën e pronësisë.

9. Organet e menaxhimit të Fondit

1. Këshilli drejtues

Në vitin 2011 puna e Këshillit drejtues të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë si organ më i lartë menaxhimi është realizuar në mbështetje të Ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor, Statutit të Fondit dhe Rregullores për punën e Këshillit drejtues, si dhe në mbështetje të Programit për punën e Këshillit drejtues.

Në vitin 2011 Këshilli drejtues i Fondit ka mbajtur 25 seanca me gjithsej 90 pikë në rend dite.

Në seancat e mbajtura janë sjellë 43 vendime, nga të cilat më të rëndësishme janë: Vendim për miratimin e Llogarisë përfundimtare të Fondit për vitin 2010, Vendim për miratimin e propozim buxhetit të Fondit për vitin 2011, Vendim për shitjen e aksioneve dhe pjesëve, Vendim për emërimin e Komisionit të konkursit për zbatimin e procedurës për zgjidhjen dhe emërimin e Drejtorit të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë, Vendim për shpallje të konkursit për zgjidhjen dhe emërimin e Drejtorit të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor, Vendim për emërimin e Drejtorit të Fondit. Me përfundimin e procedurës së plotë për zgjidhjen dhe emërimin e drejtorit të ri në seancën e 99 të Këshillit drejtues të Fondit e cila u mbajt më 6 dhjetor të vitit 2011, ndërsa me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për Drejtor të ri është emëruar Bekim Neziri.

Në vitin 2011, Këshilli drejtues i Fondit solli tre rregullore edhe atë: Rregullore për kushtet dhe mënyrën e fitimit të së drejtës për ndarjen e hapësirës banesore me qira në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit me të cilat qeveris Fondi, Rregullore për kushtet dhe mënyrën e dhënies së hapësirës afariste me qira me të cilën qeveris Fondi dhe Rregullore për ndryshimin e rregullores për kushtet dhe mënyrën e dhënies së hapësirës afariste me qira me të cilën qeveris Fondi.

Janë sjell edhe dy programe, edhe atë: Program për punën e Këshillit drejtues të Fondit për vitin 2011 dhe Program për rikonstruimin, adaptimin e objekteve afariste të Fondit dhe furnizim të mjeteve themelore.

Gjithashtu, Këshilli drejtues ka shqyrtuar edhe 29 informacione prej të cilave më të rëndësishme janë: Informacion për shitjen e zbatuar të aksioneve të Fondit të cilat menjëherë janë procesuar deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Informacion për mjetet e dedikuara dhe të paguara për fondin solidar për përfituesit e ndjerë të pensionit në periudhën janar – nëntor të vitit 2011, Informacion për shpenzimet transitive në bazë të bartjes së një pjese të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor deri te fondet pensionale private, Informacion për aktivitetet e ndërmarra për pagesën e kontributeve të pa paguara përfundimisht me 31-12-2008, Informacion për gjendjen pronësoro juridike me pronën e Fondit, Informacion për pagesën e kërkesave të Fondit në emër të dëmeve nga pagesat e pa baza të shfrytëzuesve të së drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor me propozim masash për eliminimin e arsyeve për shkak të të cilëve vije deri në deflukt të mjeteve.

Në vitin 2011 para Këshillit drejtues është prezantuar edhe Informacioni për shitjet e zbatuara të aksioneve dhe pjesëve të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

Këshilli drejtues i Fondit ka shqyrtuar edhe 7 raporte, edhe atë: Raport për regjistrimin e kryer mbi pronën e Fondit dhe shtëpitë për jetesë si dhe klubet si

objekte të veçanta ndërtimore për përfituesit e pensionit me të cilat menaxhon Fondi, me gjendje më 31.12.2010, Raporti nga Enti shtetëror për revizion mbi revizionin e zbatuar të raporteve financiare të Fondit për vitin 2010 dhe revizion i pajtueshmërisë në të cilin është paraqitur mendimi i revizionit për punën ligjore dhe objektive të Fondit në të gjitha aspektet e punës financiare. Këshilli drejtues gjithashtu ka shqyrtuar edhe Raportin aktuar i cili i përmban projeksionet e të gjitha parametrave prej të cilëve varet stabiliteti i sistemit pensional dhe krijimi i politikës së pensioneve.

Këshilli drejtues i Fondit në seancën e mbajtur më 31 gusht të vitit 2011 solli Buxhetin e Fondit për vitin 2012, ndërsa më pas është shqyrtuar edhe Informacioni për dallimet e Buxhetit të Fondit për vitin 2012 i përcaktuar nga Këshilli drejtues i Fondit me propozim Buxhetin e dorëzuar nga Ministria e financave deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për miratim.

Këshilli drejtues si organ më i lartë i menaxhimit në Fond, në vitin 2011 tregoi aktivitet të madh dhe të përmbajtur në zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor.

2. Drejtori

Drejtori i Fondit udhëheq me Fondin dhe e përfaqëson atë para personave të tretë. Në kuadër të autorizimeve të tij në vitin 2011, drejtori me sukses e ka udhëhequr punën e Fondit, gjë e cila kontribuoi në realizimin e rezultateve pozitive në të gjitha segmentet e zbatimit të sigurimit pensional dhe invalidor. Drejtori ka propozuar Programin e punës së Këshillit drejtues për vitin 2011 dhe është kujdesur për zbatimin e tij. Gjithashtu ka ndërmarrë më shumë masa për pagesën e kontributit të pa paguar përfundimisht me vitin 2008, ndërsa në kuadër të kompetencave ligjore veçanërisht është përpjekur për trajnimin dhe edukimin e

resurseve njerëzore si dhe ndërmarrjen e masave për ligjshmërinë e punës së Fondit.

Si organ ekzekutiv i Fondit, drejtori ka propozuar deri te Këshilli drejtues, raporte, analiza, vendime dhe materiale tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor, ndërsa njëkohësisht është kujdesur edhe për zbatimin e vendimeve, drejtimeve dhe përfundimeve të sjella nga Këshilli drejtues i Fondit.

Si drejtor i Shërbimit profesional të Fondit organizon dhe koordinon punën e të punësuarve të Fondit dhe vendos për realizimin e të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës.

10. Shërbimi profesional i Fondit

1. Organizimi i Shërbimit profesional të Fondit

Me organizimin e Shërbimit profesional të Fondit sigurohet zbatim i vetëm, i njëtrajtshëm dhe profesional i Ligjit, Statuti dhe aktet e tjera të përgjithshme të Fondit, realizim ligjor dhe dyshkallësh ndaj të drejtave të të siguruarve dhe shfrytëzuesve të së drejtave si dhe lidhshmëri funksionale e zbatimit të punëve në kompetencë të Shërbimit profesional të Fondit.

Punët menaxheriale, financiare, profesionale, administrative si dhe punët tjera për realizimin e sigurimit pensional dhe invalidor i kryen Shërbimi profesional, filialet dhe ekspoziturat nëpër komuna.


Detyrë themelore e Shërbimit profesional të Fondit është që në mënyrë ligjore dhe në afatet e përcaktuara ligjore të sjell vendime për realizimin e të drejtave të të siguruarve dhe të kryej pagesë të rregullt të pensioneve si dhe të të drejtave tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Organizimi në Shërbimin profesional siguron dyshkallësi në zgjidhje, si dhe unitet në zbatimin e punëve nën kompetencat e tyre.

Me punën e Shërbimit profesional të Fondit udhëheq drejtori i Fondit. Drejtori i Fondit ka zëvendës – drejtor i cili e zëvendëson drejtorin gjatë mungesës së tij dhe kryen edhe punë tjera të përcaktuara me Statutin e Fondit.

Puna e Shërbimit profesional të Fondit organizohet në:

1. Qendër – për punët e zbatimit të sigurimit pensional dhe invalidor në territorin e Republikës së Maqedonisë;
2. Filiale – për punët në rajonet e një apo më shumë komunave dhe
3. Ekspozitura – për një pjesë të punëve të Filialit kur ajo është e organizuar në rajonin e më shumë komunave.



Në Qendër puna zhvillohet në kuadër të sektorëve:

- Sektori për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor,

- Sektori për çështje financiare,
- Sektori për resurse njerëzore, punë juridike dhe të përgjithshme, dhe
- Sektori për informatikë .


Me ata udhëheqin ndihmësit e drejtorit .

Në Qendër zbatohen kryesisht këto punë: përcaktim dhe zbatim i politikës së zhvillimit të avancimit të sigurimit pensional dhe invalidor, përpilim i Buxhetit të Fondit dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij, pagesa e pensioneve, punë financiare, grumbullim dhe shpërndarje e mjeteve për pagesë nga të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor, zgjidhje e të drejtave nga procedura e shkallës së dytë nga siguriimi pensional dhe invalidor, pjesëmarrje në bisedimet ndërkombëtare për zbatimin e marrëveshjeve për siguriim social dhe lidhje e procedurave të reja me konteste administrative, punë për kompensim të dëmit, mbështetje informatike për punën e tërësishme, përgatitje e seancave të Këshillit drejtues të Fondit, dhënie të kumtesave dhe publikimeve profesionale – informative.

Filialet e Fondit janë të organizuara për punë në rajonin e një apo më shumë komunave dhe të njëjtat janë të vendosura në komunat: Shkup, Manastir, Prilep, Veles, Kumanovë, Tetovë, Strumicë, Ohër, Shtip, Gostivar, Strugë, Kavadar, Kriva Pallankë, Gjevgjeli, Probishtip, Dellçevë, Koçanë, Resnjë, Berovë dhe Kërçovë.

Ekspoziturat janë organizuar për një pjesë të punëve nga Filiali kur i njëjti është organizuar në rajonin e më shumë komunave, ndërsa janë të vendosura në komunat: Demir Hisar, Krushevë, Shën Nikollë, Kratovë, Vallandovë, Dibër, Radovish, Vinicë, Negotinë dhe Makedonski Brod.

Skema organizative e filialeve dhe ekspoziturave është kjo:



Filialet dhe ekspoziturat i zbatojnë këto punë: zgjidhjen e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, kontrollin e të dhënave nga obliguesit për pagesën e kontributit, gjenerimin dhe vërtetimin e të dhënave për pagën dhe stazhin e të siguruarve, kompletimin e lëndëve për përcaktimin e cilësisë të të siguruarit për shkak të realizimit të së drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor etj.

2. Resurset njerëzore

Shërbimi profesional i Fondit në vitin 2011 i zbaton detyrat e punës të parapara me Programin e Këshillit drejtues të Fondit për vitin 2011 dhe detyrat nga zbatimi i sigurimit pensional dhe invalidor, si dhe është qasur drejt implementimit të tërësishëm të Ligjit për marrëdhënie pune, Ligjit për nëpunës publik dhe Vendimit për organizim të punës dhe sistemim të vendeve të punës në Fond.

Seksioni për resurse njerëzore në vitin 2011 është kyçur ndaj implementimit të softuerit për resurse njerëzore Hermes me azhurnimin e evidencës kadrovike të të punësuarve si dhe me vendosjen e evidencës elektronike të orarit të punës në bashkëpunim me filialet dhe ekspoziturat e Fondit.

Në Shërbimin profesional të Fondit, me gjendje në dhjetor të vitit 2011 janë angazhuar 709 të punësuar. Në krahasim me vitin 2010 numri është reduktuar për 28 të punësuar për shkak të plotësimit të kushtit për pension (21 të punësuar), ndërsa një pjesë e të punësuarve janë larguar nga Fondi për shkak punësimit në vende tjera të punës (7 të punësuar). Edhe në vitin 2011 vazhduan masat për antikrizë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me të cilat është paraparë ndalimi i përkohshëm i punësimeve të reja në Fond.


Numri i të punësuarve në vitin 2011 arrin, edhe atë: 258 në Shërbimin profesional – Qendër – Shkup dhe 451 në filialet dhe ekspoziturat e Shërbimit profesional të Fondit. Numri nëpër filiale dhe ekspozitura arrin edhe atë: Berovë 9 të punësuar, Manastir 27, Makedonski Brod 4, Vallandovë 5, Veles 19, Vinicë 6,

Gjevgjeli 10, Gostivar 22, Dibër 6, Dellçevë 11, Demir Hisar 5, Kavadar 17, Kërçovë 7, Koçanë 12, Kratovë 5, Kriva Pallankë 11, Krushevë 7, Kumanovë 23, Negotinë 8, Ohër 16, Prilep 20, Probishtip 8, Radovish 4, Resnjë 8, Shën Nikollë 9, Strugë 17, Strumicë 17, Tetovë 35, Shtip 22 dhe Shkup 81 të punësuar.

Struktura e kualifikimit të të punësuarve në Shërbimin profesional të Fondit është e kënaqshme, respektivisht më shumë nga gjysma e të punësuarve (56,8%) janë me arsim superior dhe arsim të lartë, që mund të vërehet nga pasqyra në vijim:

Tabela 29: Struktura e kualifikimit të të punësuarve në Fond

Përgatitja profesionale	2010	Struktura	2011	Struktura
Superior	310	42,1	312	44,0
I lartë	99	13,4	91	12,8
I mesëm	298	40,4	277	39,1
Fillor	30	4,1	29	4,1
Gjithsej	737	100,0	709	100,0



Struktura e të punësuarve sipas përgatitjes arsimore në vitin 2011 në raport me vitin 2010 është rritur vetëm tek përgatitja e lartë profesionale, ndërsa reduktim i vërtetë vërehet tek përgatitjet e tjera profesionale.

Tabela 36. Struktura e të punësuarve në Fond sipas gjinisë

Filiale Ekspozitura	Burra		Gra		Gjithsej	
	Numri	Struktura	Numri	Struktura	Numri	Struktura
Berovë	6	66,7	3	33,3	9	100,0
Manastir	10	37,0	17	63,0	27	100,0
Makedonski Brod	1	25,0	3	75,0	4	100,0
Vallandovë	2	40,0	3	60,0	5	100,0
Veles	8	42,1	11	57,9	19	100,0
Vinicë	1	16,7	5	83,3	6	100,0
Gjevgjeli	3	30,0	7	70,0	10	100,0
Gostivar	10	45,5	12	54,5	22	100,0
Dibër	4	66,7	2	33,3	6	100,0
Dellçevë	3	27,3	8	72,7	11	100,0
Demir Hisar	2	40,0	3	60,0	5	100,0
Kavadar	3	17,6	14	82,4	17	100,0
Kërçovë	2	28,6	5	71,4	7	100,0
Koçanë	3	25,0	9	75,0	12	100,0
Kratovë	4	80,0	1	20,0	5	100,0
Kriva Pallankë	3	27,3	8	72,7	11	100,0
Krushevë	3	42,9	4	57,1	7	100,0
Kumanovë	13	56,5	10	43,5	23	100,0
Negotinë	3	37,5	5	62,5	8	100,0
Ohër	6	37,5	10	62,5	16	100,0
Prilep	9	45,0	11	55,0	20	100,0
Probishtip	7	87,5	1	12,5	8	100,0
Radovish	2	50,0	2	50,0	4	100,0
Resnjë	4	50,0	4	50,0	8	100,0
Shën Nikollë	2	22,2	7	77,8	9	100,0
Strugë	6	35,3	11	64,7	17	100,0
Strumicë	7	41,2	10	58,8	17	100,0
Tetovë	19	54,3	16	45,7	35	100,0
Shtip	10	45,5	12	54,5	22	100,0
Shkup	30	37,0	51	63,0	81	100,0
Qendër	97	37,6	161	62,4	258	100,0
Gjithsej	283	39,9	426	60,1	709	100,0

Nga të dhënat për të punësuarit sipas gjinisë, vërehet qartë se në Fond dominojnë gratë, të cilat më 31.12.2011 arrijnë 426 apo 60,1% nga gjithsej numri i të punësuarve, ndërsa burrat marrin pjesë me 39,9%.

Tabela 31: Lëvizje e numrit të të punësuarve në Shërbimin profesional të Fondit, në periudhën nga 1995-2011.

Viti	Shërbimi profesional Qendra-Shkup	Njësitë rajonale	Gjithsej
1995	221	409	630
1996	226	409	635
1997	217	404	621
1998	216	395	611
1999	214	406	620
2000	218	407	625
2001	209	415	624
2002	216	419	635
2003	217	406	623
2004	218	389	607
2005	233	423	656
2006	256	448	704
2007	254	430	684
2008	254	462	716
2009	251	427	678
2010	263	474	737
2011	258	451	709

Sipas të dhënave mund të konstatohet se numri i të punësuarve deri në vitin 2004 është i pandryshueshëm dhe në mesatare arrin 623 të punësuar. Pas vitit 2005, për shkak të vëllimit të zmadhuar të detyrave të punës në kushte të implementimi të reformës së pensionit, numri është rritur kryesisht me informaticient, juristë dhe ekonomistë për zbatim të suksesshëm të proceseve të reja afariste. Në vitin 2010 rritja e numrit të të punësuarve është rezultat i transformimit të zbatuar të të punësuarve nga Agjencia e punësimeve të përkohshme në marrëdhënie të rregullt pune. Me pranimin e të punësuarve të rinj

me përgatitje të lartë arsimore, është përmirësuar ekipimi kadrovik i Fondit si dhe struktura e vjetërsisë së të punësuarve. Në vitin 2011 numri i të punësuarve në krahasim me vitin 2010 është reduktuar për 3,8%, për shkak plotësimit të kushteve për pensionim, një pjesë e të punësuarve janë larguar nga Fondi, ndërsa vendet e lira nuk janë plotësuar.

Sipas përgatitjes profesionale bruto paga mesatare (dhjetor 2011) arrin:

Përgatitje profesionale	2011 (denarë)
Superiore	37.950,00
E lartë	32.200,00
E mesme	26.150,00
Fillore	21.300,00
Gjithsej	31.500,00

Kompensimet e Shërbimit profesional të Fondit në vitin 2011 arrijnë 273,81 milion denarë dhe të njëjtat në gjithsej të dalat e Fond marrin pjesë me 0,6%.

3. Puna e Njesisë së aktuaristikës

Njësia e aktuaristikës në kuadër të detyrimeve të rregullta në fillim të vitit 2011 zbatoi azhurnimin e modelit aktuaristik i cili përdoret për përpilimin e projeksioneve të aktuaristikës. Modeli i aktuaristikës është një nga instrumentet e planifikimit të politikës së pensioneve. Me këtë model mund të simulohet një këndvështrim i gjerë i politikës së pensioneve, respektivisht më shumë lloje të reformave, reforma parametrare të shtyllës së financuar të pensioneve dhe ndryshime lidhur me shtyllën e dytë. Me ndihmën e modelit të aktuaristikës bëhen projeksione për gjendjen në sistemin e pensioneve në bazë të parametrave të supozuar demografik dhe ekonomik si dhe supozime të ndryshme të politikës së

pensioneve. Modeli gjeneron të dhëna mbi të hyrat dhe të dalat në Fond, të dhëna për pensionet dhe përfituesit e pensionit sipas llojit të pensionit, shpërndarje e të siguruarve midis shtyllës së parë dhe të dytë dhe të dhëna më domethënëse nga fusha e pensioneve.

Për azhurnimin e modelit, të dhënat për pensionistët dhe të siguruarit si dhe parametrat financiar mbi punën e Fondit sigurohen nga baza e të dhënave të Fondit dhe Seksionit për Koordinimin e buxhetit, të dhënat demografike sigurohen nga Enti shtetëror i statistikës, ndërsa indikatorët makroekonomik nga Ministria e Financave. Pas azhurnimit të modelit krijohen skenarë të ndryshëm dhe merren rezultatet dalëse për parametra të ndryshëm dhe domethënës për sistemin e pensioneve.

Detyrë kryesore për aktuaristikë është vlerësimi i statusit të sistemit të pensioneve për të cilin përpunohen projeksione aktuaristike dhe analiza të afatit të mesëm dhe të gjatë për çdonjërin nga propozimet dhe realizimi i ndryshimeve në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor si dhe sistemin e pensioneve.

Me përdorimin e modelit të aktuaristikës për projeksione afatgjate, Njësia e aktuaristikës gjatë vitit 2011 ka hartuar skenarë të ndryshëm, kalkulime, analiza dhe parashikime të kërkesave të Fondit, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Agjencisë për kontroll të sigurimit pensional me financim kapital, Ministrisë së Financave dhe institucioneve tjera të jashtme.

Gjatë vitit 2011 me kërkesë të Agjencisë për kontrollin e sigurimit pensional me financim kapital dhe Bankës botërore janë hartuar më shumë analiza me skenarë të ndryshëm për implikimet financiare nga reduktimi i mëtejshëm i shkallës së kontributit apo mbajtjen e tyre në nivel të njëjtë dhe mirëmbajtjen e sistemit të pensioneve.

Në çdonjërin nga analizat në varësi të kërkesës për reduktimin e shkallës së kontributit apo mirëmbajtjes së tij janë përpiluar skenare të ndryshme me projeksione afatgjate. Në përpilimin e projeksioneve merren parasysh edhe

ndryshimet e projeksioneve për indikatorët makroekonomik të shpallur nga ana e Ministrisë së Financave. Në këto analiza janë përmbajtur projeksione afatgjate dhe afatshkurte të aktuaristikës mbi të hyrat dhe të dalat në Fond si dhe transferimi i duhur i buxhetit.

Në janar të vitit 2011 me kërkesë të Fondit të shëndetësisë të Republikës së Maqedonisë janë bërë dhe dorëzuar projeksione për popullsinë sipas moshës dhe gjinisë. Projektionet janë bërë me modelin aktuaristik për parashikim në bazë të të dhënave të fundit të shpallura nga ana e Entit shtetëror për statistikë.

Gjatë muajit shkurt të vitit 2011 me iniciativë të Lidhjes së Sindikatave të Republikës së Maqedonisë dhe Konfederatës së sindikatave të lira për vendosjen e më shumë kushteve për pensionim, ndërsa me kërkesë të Agjencisë për kontroll të sigurimit pensional me financim kapital, është përpiluar Informacion për implikime financiare ndaj Fondit nga ndryshimet e propozuara në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor. Në këtë informacion janë bërë kalkulime aktuaristike për:

- realizimin e të drejtës së pensionit në bazë të stazhit të mbushur pensional;
- numrit të të siguruarve, burra dhe gra me minimum 60 vjet dhe minimum 15 vjet stazh pensional të cilët do të pensionoheshin gjatë 5 viteve të ardhshme si dhe pensionit mesatar të realizuar sipas kësaj baze dhe implikimeve fiskale;
- mundësisë së riblerjes së stazhit pensional për 3 vjet, për shkak mbushjes minimale prej 15 vjet stazh pensional;
- vlerës së pensionit të reduktuar për 3%, 4% dhe 5% dhe shkallës zëvendësuese të reduktuar për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për periudhën prej 5 viteve para kushteve të rregullta (57 vjet jetë për grua dhe 59 vjet jetë për burrë).

Gjatë vitit 2011 janë përpiluar procedura për punën e Njesisë, ndërsa është azhurnuar modeli aktuaristik me të dhëna për vitin 2010.

Gjithashtu në vitin 2011 të punësuarit në Njësi morën pjesë në Konferencën ndërkombëtare të reformave pensionale dhe nxitjeve të ardhshme e cila është mbajtur me rastin e shënimit të pesë vjetorit të vendosjes së sigurimit pensional me financim kapital dhe përfundimin e bashkëpunimit të suksesshëm me Bankën Botërore në fushën e reformave pensionale. Në konferencë morën pjesë edhe përfaqësues nga Bulgaria, Romania, Kosova, Kroacia dhe Polonia.

Në maj të vitit 2011 në Serbi është mbajtur Simpoziumi ndërkombëtar për aktuarë të autorizuar nga fusha e sigurimit ku morën pjesë edhe dy përfaqësues nga njësia e aktuaristikës. Gjithashtu në zyrat e këshillit britanik në Shkup dy përfaqësues nga Njësia e aktuaristikës morën pjesë në ligjërata profesionale, këshillim, të organizuar nga ana e Qendrës për reforma në njoftimet financiare në Bankën botërore. Gjatë muajit tetor, dy anëtarë të Njesisë së aktuaristikës morën pjesë në Trajnime për modelim stohastik me ftesë të shoqatës aktuale Bullgare në Sofje, Bullgari.

Kah mesi i vitit është përgatitur „Raport për sistemin e pensioneve në Republikën e Maqedonisë me projeksione aktuaristike për vitin 2010”. I njëjti është përkthyer në Njësine për aktuaristikë edhe në gjuhën angleze me qëllim të njoftimit të institucioneve dhe konsulentëve me sistemin e pensioneve në Republikën e Maqedonisë dhe projeksionet për të njëjtin.

Në shtator të vitit 2011 me kërkesë të Entit shtetëror të statistikës, ndërsa për projektin UNICEF – TRANSMONEE janë dorëzuar të dhëna deri tek i njëjti nga ana e Njesisë së aktuaristikës, që janë në kompetencë të Fondit.

Në vitin 2011 është përpiluar edhe Analizë për sistemin e pensioneve me zbatimin e shkallës së kontributeve në mbështetje të Ligjit të propozuar për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social dhe zbatimi i harmonizimit ligjor të pensioneve si dhe zbatimi i projeksioneve të indikatorëve makroekonomik nga Ministria e financave.

Me kërkesë të Sektorit për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor janë përgatitur kalkulime financiare për mjetet e kursyera në bazë të ndërprerjes të së drejtës së shfrytëzimit të pensionit të përfituesve të pensionit të përkohshëm invalidor , respektivisht pensionit familjar.

Deri te Agjencia për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital për zbatimin e analizave dhe kalkulimeve, janë hartuar dhe dorëzuar projeksione të detajuara afatgjate të aktuaristikës mbi numrin e anëtarëve, kontributeve të paguara dhe mjeteve të akumuluar në shtyllën e dytë.

Projeksionet janë bërë sipas tre skenarëve prej të cilëve i pari bazohet në shkallën e kontributeve sipas Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social, ndërsa dy skenarët e tjerë janë projektuar me shkallë të kontributit sipas Programit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vitin 2011 – 2015.

Deri te Banka botërore janë dorëzuar të dhëna për azhurnimin e indikatorëve për përcjelljen e suksesit të SPIL projektit.

Gjatë vitit 2011 Njësia e aktuaristikës si pjesë e detyrimeve të rregullta të saja vazhdoi me përcjelljen e shpenzimeve transitive dhe numrin e të siguruarve – anëtarëve në shtyllën e dytë, si pjesë e rëndësishme në planifikimin e Buxhetit të Fondit. Projeksionet mbi shpenzimet transitive afatgjate dhe afatshkurtër si rezultate dalëse fitohen nga modeli i aktuaristikës.

4. Puna e Seksionit për revizion të brendshëm

Revizioni i brendshëm është i pa varur në kompetencën e tij dhe në punën e tij si revizion i punës së institucionit dhe me konstatimet e tij dhe vërejtjet kontribuon në përmirësimin e punës së Fondit.

Kompetencat e tij Revizioni i brendshëm i ka realizuar në mbështetje të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar , Standardeve ndërkombëtare të

revizionit të brendshëm të institutit për revizor të brendshëm, Rregullores për mënyrën e zbatimit të revizionit të brendshëm, Rregullores për kodeks etik të revizorëve të brendshëm, Rregullores për ndarjen e revizionit të brendshëm, Udhëzimit për punë si dhe akte tjera nga sfera e revizionit të brendshëm.

Revizioni i brendshëm në vitin 2011 i ka realizuar aktivitetet e parapara në Planin Vjetor për punë.

Gjatë vitit 2011 revizioni i brendshëm ka zbatuar këto detyra:

1. Revizion të procesit të realizimit të së drejtës së pensionit me stazh të huaj në Qendrën e Fondit me pagesën e pensioneve jashtë vendit në Departamentin për pagesën e pensioneve.

2. Revizion në procesin e pagesës së borxhit të pa paguar nga kontributet e pa paguara për sigurim pensional dhe invalidor përfundimisht me 31.12.2008 në filialet në Shkup, Kumanovë, Kratovë, Strugë, Ohër dhe Tetovë.

3. Revizion i procesit të evidentimit amë të vërtetimit të stazhit në filialin Prilep.

4. Raport për zbatimin e rekomandimeve që janë dhënë nga ana e revizionit të brendshëm, ndërsa janë pranuar nga subjekti i rishikuar për konstatime të cilat janë vërtetuar gjatë revizionit të sistemit të kontrollit të brendshëm në procesin e veprimit sipas kalkulimeve nga Departamenti për pagesën e pensioneve për dëmet e shkaktuara në Departamentin e punës pronësoro juridike.

5. Raport për zbatimin e rekomandimeve që janë dhënë nga ana e revizionit të brendshëm, ndërsa janë pranuar nga subjekti i rishikuar për konstatime të cilat janë vërtetuar gjatë revizionit të sistemit të kontrollit të brendshëm në procesin e pagesës së Fondit solidar të trashëgimtarëve të përfituesve të ndjerë të pensionit në filialin në Shkup.

6. Revizion të procesit të përgatitjes së procedurës për dhënie të drejtimeve për punë dhe zbatim të kontrollit të punës së Filialeve dhe ekspoziturave të Fondit në Departamentin e evidentimit amë Qendra Shkup.

Në mbështetje të revizioneve të zbatuara dhe konstatimeve janë dhënë rekomandime adekuate nga ana e revizionit të brendshëm të Fondit.

1. Revizioni i procesit të realizimit të së drejtës së pensionit me stazh të huaj në Qendrën e Fondit

Revizioni i brendshëm në vitin 2011 zbatoi revizion në Seksionin për realizimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ku subjekt i revizionit ishte puna dhe efikasiteti në realizimin e të drejtave sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe gjatë kësaj solli pesë konkluzione për realizimin e rekomandimeve dhe ruajtjen e afateve të parapara ligjore për realizimin e të drejtave mbi miratimin në kohë të vendimeve për të ndaluar pagesën e pensioneve dhe dorëzimin e vërtetimeve për jetë nga ana e shfrytëzuesve të pensionit.

2. Revizion në procesin e pagesës së borxhit të mbetur nga kontributet e pa paguara për sigurim pensional dhe invalidor përfundimisht me 31.12.2008

Nga revizioni i zbatuar i procesit të pagesës së kontributeve të pa paguara për sigurim pensional dhe invalidor është konstatuar se procesi i automatizuar për kontroll nëpërmjet modulit për monitorim elektronik plotësisht filloi të funksionojë në vitin 2010. Me zbatimin e tij fitohen të dhëna automatike për kontrollin e obliguesve në Republikën e Maqedonisë të cilët nuk kanë paguar kontributin, me çka është eliminuar faktori subjektiv në zbatimin e kontrollit. Deri në vitin 2011 janë bërë dy cikle, i pari në vitin 2008 ndërsa i dyti në vitin 2009 pas së cilës janë ndërmarrë aktivitete për pagesë në filialet dhe ekspoziturat e Fondit në mbështetje me regulativën ekzistuese ligjore.

Pikërisht, janë përgatitur njoftime, procesverbale për kontributet e pa paguara, ndërsa për obliguesit të cilët nuk kanë paguar kontributet është zbatuar bllokim dhe gjatë vitit 2010 dhe 2011 janë paguar mjete mbi 1.000 milion denarë.

Për obliguesit të cilët nuk janë aktiv, ndërsa ende udhëhiqen në bazën e obliguesve të Fondit është rekomanduar që të ndërmerren aktivitete me institucionet kompetente (Regjistri qendror, gjyqet) për azhurnimin e tyre.

Gjithashtu është rekomanduar përmirësimi i programit aplikativ gjatë evidentimit të obliguesve për pagesën e kontributeve me qëllim që të jepet mundësia për evidencë automatike në rastet kur obliguesi kryen ndryshim në numrin e të punësuarve me M1/M2 fletëparaqitjet.

3. Revizion i procesit të evidentimit amë për vërtetimin e stazhit në filialin në Prilep

Nga ana e revizionit është vërtetuar se kanë ekzistuar parregullsi në pjesën e vërtetimit të stazhit i cili ishte i evidentuar dhe regjistruar në kundërshtim me Ligjin për evidentimin amë. Rekomandimet janë realizuar për shtatë përfitues të cilët kanë realizuar të drejtën e pensionit dhe janë sjell vendime për ndalesën e pensionit, ndërsa për shtatë të siguruar tek të cilët është vërtetuar stazh i “falsifikuar “ i njëjti në mbështetje të Ligjit për evidentimin amë është fshirë. Kundër personave të punësuar në filialin në Prilep janë sjell fletëparaqitjet e duhura përkatëse nga organet kompetente.

4. Follow up revizion apo Revizion për monitorimin e rekomandimeve të zbatuara në sistemin e kontrollit të brendshëm në procesin e trajtimit sipas kalkulimeve në Departamentin për pagesën e pensioneve për dëmet e shkaktuara në Departamentin për punë pronësoro juridike.

Pas revizionit për monitorimin e rekomandimeve të zbatuara në sistemin e kontrollit të brendshëm në procesin e trajtimit sipas kalkulimeve në Departamentin për pagesën e pensioneve për dëmet e shkaktuara në Departamentin për punë pronësoro juridike është formuar komision nga Këshilli

drejtues i Fondit me anëtarë nga më shumë departamente me detyrë që të bëhet regjistrim fizik për të gjitha lëndët në Departamentin për punë pronësoresh juridike. Komisioni duhet të zbatojë analizë të dosjes dhe t'i përcaktojë arsyet për gjendjen e vjetërsimit tek lëndët në të cilat do të konstatohet e njëjta.

Rekomandimi në raport me problemet në funksionimin e programit aplikativ i cili do ta rrumbullakojë procesin e kompensimit të dëmit nga pagesat e pa baza, duhet të zbatohet me ndërmarrjen e aktiviteteve ndryshme dhe plotësime të të njëjtës me qëllim të funksionimit të plotë të aplikimit.

Gjithashtu në lidhje me rekomandimet për problemet teknike në programet aplikative për regjistrimin e të gjitha veprimeve procedurale të ndërmarra për çdo lëndë e cila udhëhiqet në arkivin e Departamentit për punë pronësore juridike, janë ndërmarr masa për eliminimin e problemeve teknike me qëllim të funksionimit të plotë të tyre.

5. Gjatë zbatimit të revizionit mbi rekomandimet e zbatuara për revizionin e zbatuar të procesit të pagesës së fondit solidar të trashëgimtarëve të përfituesve të ndjerë të pensionit në Filialin Shkup është vërtetuar se rekomandimet e dhëna janë zbatuar. Pikërisht është përgatitur procedurë në mbështetje të zgjidhjes së re të programit dhe është vendosur në linkun përkatës – Procedurë në dispozicion për shfrytëzimin e të punësuarve në Fond.

6. Revizion për harmonizimin e procesit mbi përgatitjen e procedurës për dhënien e drejtimeve për punë dhe zbatim të kontrollit të punës në filialet dhe ekspoziturat e Fondit në evidentimin amë – Qendra Shkup

Me zbatimin e revizionit në procesin e vërtetimit të stazhit me kohëzgjatje të shtuar janë sjell disa konkluzione për zbatimin e rekomandimeve. Harmonizim të

Kodeksit të vetëm të shifrave për regjistrimin e të dhënave në evidentimin amë dhe vendosjen e shifrave të reja për stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar të cilat nuk janë përmbajtur në Rregulloren për vendet e punës për stazhin me kohëzgjatje të shtuar me rekomandim të kërkohej nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ndryshime dhe plotësime të Rregullores. Rekomandimi është zbatuar.

7. Kontrolli Buxhetor

Gjatë vitit 2011 kontrolli buxhetor në tërësi i realizoi të gjitha detyrat e parapara me Programin për punë, zbatim të rregullt të Ex-ante dhe Ex-post kontrolleve të të gjitha marrëveshjeve të lidhura financiare të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë me institucionet tjera dhe monitorim të realizimit të tyre.

Gjithashtu janë bërë kontrolle në punën financiare në disa departamente ku është konstatuar nevoja e procedurave të shkruara në punë.

Është zbatuar kontroll në Departamentin për pagesën e pensioneve dhe është konstatuar që të ndërpritet pagesa e përfituesve të pensionit të cilët jetojnë jashtë Republikës së Maqedonisë, po qe se nuk parashtrojnë me kohë vërtetime për jetë. Gjithashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë është bërë kontroll i të gjithë përfituesve të cilëve u bëhet pagesa dhe janë ndërmarr aktivitete sipas gjendjes së konstatuar.

Pikërisht, në pjesën e pensioneve janë bërë analiza të detajuara në llogaritë e përfituesve të ndjerë të pensionit në bankat ku Fondi i dedikon mjetet dhe janë përgatitur kërkesa deri tek bankat për kthimin e tyre dhe pjesën më të madhe të mjeteve bankat ia kthejnë Fondit.

Për vitin 2012 kontrolli buxhetor përgatiti rekomandime për respektimin e procedurave të shkruara nga ana e të gjitha kompetencave në sektoret dhe departamentet e Fondit.

8. Furnizimet publike

Në vitin 2011 Departamenti për furnizime publike zbatoi të gjitha furnizimet publike në mbështetje me nevojat dhe planin për furnizime publike të sjell nga Fondi dhe Ligjin për furnizime publike (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 136/07, nr. 130/08, 97/10 dhe 53/11) me shfrytëzimin e sistemit elektrik të integruar për furnizime publike.

Departamenti me shfrytëzimin e sistemit elektronik për furnizime publike gjatë zbatimit të procedurave të furnizimeve publike arriti transparencë të madhe, konkurrencë më të madhe ndërmjet operatorëve ekonomik, efikasitet të madh dhe ekonomizim në zbatimin e procedurave, kursime më të mëdha në mjetet nga Buxheti i Fondit dhe përgjegjësi më të madhe dhe transparencë në shpenzimin e mjeteve të parapara për të gjitha qëllimet.

Departamenti për furnizime publike i Fondit në mbështetje të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2011 si dhe me ndryshimet dhe plotësimet e të njëjtit gjatë vitit 2011, zbatoi procedurat e planifikuara për zbatimin e furnizimeve publike.

Në vitin 2011, Fondi publikoi 26 shpallje për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike prej të cilave 7 shpallje për kërkesë mbi mbledhjen e ofertave, 16 shpallje për procedurë të hapur, 3 procedura me negociim pa shpallje paraprake.

Sipas llojit të lëndës së marrëveshjes për furnizime publike, janë publikuar 9 shpallje për ndarjen e marrëveshjeve për furnizimin e mallrave, për shërbime janë publikuar 16 shpallje ndërsa për punë 1 shpallje.

Të gjitha të dhënat në lidhje me marrëveshjet e lidhura për furnizime publike në Fond të shpallura në ueb-faqen e Byrosë <https://e-nabavki.gov.mk> dhe janë plotësisht në dispozicion të opinionit.

Në tabelën vijuese janë paraqitur numri dhe vlera e marrëveshjeve të lidhura për furnizime publike për vitin 2011 sipas llojit të procedurës për ndarjen e marrëveshjes.

Tabela 32

Lloji i procedurës për ndarjen e marrëveshjes	Numri i marrëveshjeve të lidhura	Vlera e marrëveshjeve të lidhura (në milion denarë)
Procedurë me kërkesë për mbledhjen e ofertave pa shpallje	28	8,10
Procedurë me kërkesë për mbledhjen e ofertave me shpallje	10	7,22
Procedurë e hapur	27	56,00
Procedurë për negociim pa shpallje paraprake	3	2,19
Gjithsej	68	73,51

Të dhënat nga njoftimet për asgjësimin e procedurave në vitin 2011 nëpërmjet SEFB (sistemi elektronik për furnizime publike) janë plotësuar dhe shpallur gjithsej 4 njoftime për asgjësimin e procedurës.

Gjatë vitit 2011 nga ana e operatorëve ekonomik ishin parashtuar gjithsej 4 ankesa. Shërbimi profesional u përgjigj mbi ankesat e operatorëve ekonomik dhe të njëjtat i dorëzoi deri te Komisioni shtetëror për ankesa sipas furnizimeve publike.

Gjatë zbatimit të procedurës për furnizime publike në mbështetje të nenit 24 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për furnizime publike nga 1 janari i vitit 2011 është shfrytëzuar edhe e-ankandi në më së paku 70% nga numri i shpalljeve të publikuara nga procedurat e planifikuara për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike, në mbështetje të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit rezultoi me realizimin e kursimeve të mjeteve buxhetore dhe rritjen e transparencës në procedurat për furnizime publike.

Gjatë zbatimit të procedurës për ndarjen e marrëveshjes për furnizime publike nëpërmjet SEFB të gjitha veprimet në procedurë (publikimi i shpalljes, dokumentacioni i tenderit, dorëzimi i ofertave, hapja publike dhe evaulimi, miratimi i vendimeve, njoftimi për vendimet e miratuara , komunikimi me operatorët ekonomik) realizoheshin në formë elektronike.

Në vitin 2011, Fondi publikoi 16 shpallje për procedura të cilat udhëhiqen në mënyrë elektronike, prej të cilave 14 shpallje janë për procedurat të cilat kanë përfunduar me ankand elektronik.

Përvoja nga viti 2011 tregon se nga realizimi i procedurave për furnizime publike me shfrytëzimin e sistemit elektronik për furnizime publike me e-ankand janë kursyer mjete nga Buxheti dhe janë reduktuar shpenzimet e organit kontraktues.

Gjatë vitit 2011 ishin caktuar gjithsej 30 ankande elektronike, të cilat u miratuan me sukses (ofruesit limituan me çmimet).

7. Fondi solidar

Në mbështetje të nenit 130-a nga Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, Fondi përfituesit të pensionit, me pëlqimin e tij i

ndalon një pjesë nga pensioni për anëtarësim në shoqatë përkatëse dhe një pjesë për Fondin solidar – mjete për pagesën e ndihmës së pas vdekjes, pas vdekjes së përfituesit të pensionit. Në mbështetje të Vendimit të organizatës së regjistruar nga Lidhja e pensionistëve numër 02-02/847 nga 23.12.2010, mbajtja për Fondin solidar për vitin 2011 arrinte 120 denarë, ndërsa për anëtarësi ka ndryshuar lartësia e shumës në vend 20 denarë është rritur në 30 denarë në muaj.

Ndihma e pas vdekjes për përfituesit e ndjerë të pensionit në vitin 2011 arrin 30.000 denarë.

Në vitin 2011 janë mbajtur mjete nga përfituesit e pensionit për Fondin solidar – ndihmë e pas vdekjes në shumë prej 377,58 milion denarë, derisa anëtarëve të familjeve të 13.112 përfituesve të ndjerë të pensionit u janë paguar mjete në shumë prej 393,36 milion denarë.

Tabela 33. Lëvizja e mjeteve të ndara dhe mjeteve të paguara për Fondin solidar -ndihmë e pas vdekjes nga përfituesit e pensionit sipas muajve në vitin 2011

Muajt	Përfitues të pensionit	Fondi solidar	Të ndjerë	Mjete të paguara
Janar	263.432	31.611.840	928	27.840.000
Shkurt	262.475	31.497.000	1.210	36.300.000
Mars	261.581	31.389.720	1.391	41.730.000
Prill	260.982	31.317.840	1.070	32.100.000
Maj	262.510	31.501.200	1.088	32.640.000
Qershor	262.533	31.503.960	1.137	34.110.000
Korrik	262.181	31.461.720	975	29.250.000
Gusht	262.068	31.448.160	956	28.680.000
Shtator	262.021	31.442.520	1.028	30.840.000
Tetor	261.375	31.415.160	1.177	35.310.000
Nëntor	262.246	31.469.520	1.183	35.490.000
Dhjetor	262.742	31.529.040	969	29.070.000
Gjithsej		377.587.680	13.112	393.360.000

Mjetet e ndara për ndihmë të pas vdekjes në shumë prej 377,58 milion denarë në raport të mjeteve të paguara në shumë prej 393,36 milion denarë janë më të ulëta për 15,78 milion denarë, që tregon se mjetet e paguara për vitin 2011 nuk janë plotësisht të mbuluara me mjetet e ndara për këtë qëllim.

Në periudhën e vitit 2008 deri në vitin 2011 mjetet e ndara dhe të paguara për ndihmë të pas vdekjes arrijnë edhe atë:

Viti	Mesatarja e përfituesve	Mjete të ndara	Shfrytëzues të ndjerë	Mjete të paguara
2008	263.911	314.019.269	11.312	339.360.000
2009	263.500	446.862.922	12.780	410.888.560
2010	262.370	377.910.674	12.617	378.501.162
2011	262.179	377.587.680	13.112	393.360.000

Numri i përfituesve të ndjerë të pensionit në vitin 2011 arrin 13.112 përfitues, ndërsa në vitin 2008 arrin 11.312 të ndjerë dhe në raport të vitit 2008 ky numër është rritur për 1.800 përfitues.

Në vitin 2011 numri i përfituesve të ndjerë të pensionit arrin 13.112 përfitues apo në mesataren mujore 1.092 përfitues. Lëvizja sipas muajve e përfituesve të ndjerë të pensionit është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 34. Numri i përfituesve të ndjerë të pensionit në vitin 2011 sipas muajve

Muajt	Përfitues të ndjerë
Janar	928
Shkurt	1.210
Mars	1.391
Prill	1.070
Maj	1.088
Qershor	1.137
Korrik	975
Gusht	956
Shtator	1.028
Tetor	1.177
Nëntor	1.183
Dhjetor	969
Gjithsej	13.112

Nga tabela shihet se vdekshmëria e përfituesve të pensionit ndryshon sipas muajve, përjashtohet muaji mars ku numri më i madh i përfituesve të ndjerë arrin deri në 1.391 të ndjerë për një muaj, ndërsa më i vogël është në janar me 928 përfitues të ndjerë të pensionit.

Shërbimi profesional i Fondit në vitin 2011 kryente pagesë të rregullt të ndihmës së pas vdekjes.

11. Sistemi i informatikës

Teknologjia informatike dhe e komunikimit është njëri nga elementet themelore për zbatim efikas dhe efektiv të sigurimit pensional dhe invalidor. Pajisja informatike është bartëse dhe lidhje themelore për realizimin e proceseve afariste në të gjitha segmentet e punës së Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

Në vitin 2011 nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë janë iniciuar më shumë projekte me të cilat është insistuar këmbimi i të dhënave elektronike ndërmjet institucioneve dhe klientëve (të siguruar dhe pensionistë).

Në Departamentin për Softuer aplikativ në mënyrë të vazhdueshme është punuar në mirëmbajtjen dhe përsosmërinë e të gjitha linjave ekzistuese, vendime aplikative për përkrahjen e proceseve afariste për kryerjen e aktiviteteve rrjedhëse në Shërbimin profesional të Fondit. Në pjesën e evidentimit amë, të shfrytëzuesve të së drejtës dhe pagesës së të ardhurave pensionale sipas të gjitha bazave janë bërë ndryshime thelbësore:

- Kalimi i orakl platformës në pjesën e softuerit për evidentimin amë të shfrytëzuesve të së drejtës dhe pagesës së të ardhurave pensionale. Në vitin 2011 u lëshua VMS sistemi operativ i vjetër në të cilin më shumë se 25 vjet servohej pagesa e përfitimeve pensionale. Janë emigruar të gjitha të dhënat nga sistemi i vjetër (të gjitha të dhënat për shfrytëzuesit e të drejtës, dadotekat financiare për pagesë prej vitit 1989 deri në vitin 2010) në orakl platformën e re.

- Analizë dhe miratim i softuerit të ri për pagesën e përfitimeve pensionale të orakal platformës dhe analizë plotësuese të proceseve afariste si dhe plotësim të softuerit për pagesën e përfitimeve pensionale dhe evidentimi amë i shfrytëzuesve të së drejtës.

- Ndryshime të rregullta dhe plotësime për pagesën mujore të përfitimeve

pensionale të shfrytëzuesve aktiv të cilët të drejtën e kanë realizuar në bazë të sigurimit të punës, të siguruesve aktiv të cilët të drejtën e kanë realizuar në Republikën e Maqedonisë ndërsa jetojnë në ish Republikat Jugosllave, pagesa javore për përfitimet pensionale të pa paguara (pensione manuale) për shfrytëzuesit e të drejtës sipas të gjitha bazave, raporte statistikore të rregullta mujore, tre mujorë dhe vjetore për shfrytëzuesit e të drejtës dhe pagesë e përfitimeve pensionale si dhe të dhëna mujore të rregullta për obligimet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për shfrytëzuesit të cilët të drejtën e kanë realizuar nën kushte më të volitshme.

- Mirëmbajtje të vendimeve aplikative për shërbimin e pagesës së fondit solidar nëpërmjet Fondit (mjete për ndihmë të pas vdekjes të cilat paguhën për trashëgimtarët e përfituesve të ndjerë për të cilët në pagesat mujore të përfitimeve pensionale është kryer mbajtje për këtë qëllim).

- Në pjesën e realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor është bërë bartje e oral platformës në pjesën e softuerit për realizimin e të drejtës dhe u lëshua sistemi i vjetër operativ në të cilin më shumë se 15 vjet ishte servuar realizimi i të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor.

- Miratim në mënyrë automatike i vendimeve për realizimin e të drejtës së parë të pensionit të pleqërisë, familjarë, invalidor, e drejtë e kompensimit për dëmtim fizik, (P10/P11) sipas dispozitave të brendshme dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social si dhe vendime në ripërtëritjen e procedurës (vendime përfundimtare me zbatimin e koeficienteve më të rinj për valorizimin e pagesave në nivel të vitit paraprak si dhe vendime përfundimtare për të drejtën e pensionit invalidor dhe familjar me kontroll mjekësor).

- Në pjesën e Vlerësimit të aftësisë për punë janë bërë analiza dhe miratim i softuerit të ri të orakl platformës, ndryshime të rregullta dhe plotësime të softuerit për përkrahjen e procesit tek vlerësimi i aftësisë për punë në mbështetje me ndryshimet ligjore, vendimet e Qeverisë apo kërkesave tjera. Gjithashtu, është bërë

mirëmbajtje e aplikimit për punë të arkivit në shkallë të parë (pranim dhe ekspeditë e lëndëve), shkresa, njoftime dhe konkluzione të Komisionit për rregullsi dhe kompletimin e dokumentacionit, caktimin e kontrollit me kërkesë të të siguruarve për vlerësimin e aftësisë për punë, radhitjen e lëndëve nëpër komisione dhe evidentimin e tyre.

Në vitin 2011 detyrë me prioritet në Departamentin për zhvillimin e sistemit të informatikës është që të sigurohet shpërndarje e fluksit të mjeteve mbi kontributin për sigurimin pensional dhe invalidor , me lidhjen e të dhënave të fituara nga Trezori me të dhënat për LLMPI fletëparaqitjet e paguara të cilat deri te Fondi i dorëzon Drejtoria e të hyrave publike, ndërsa kontrollohen dhe vërtetohen nga Agjencia e supervizionit të sigurimit pensional me financim kapital në raport të anëtarësisë në Fondet pensionale private, dhe distribuohen edhe atë një pjesë nga mjetet e llogarisë institucionale të Fondit, ndërsa një pjesë e llogarive në fondet pensionale private, përveç mjeteve distribuohen edhe të dhënat për çdo person. Me përfundimin e kësaj detyre sigurohen mjete për pagesën e përfitimeve pensionale si dhe përfundimi i të dalave tjera të Fondit.

Në raste të caktuara në pjesën e pagesës së kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor, shpërndarja nuk bëhet menjëherë, por me zgjidhje plotësuese. Në koordinim me departamentin për kontrollin e të dhënave nga kontributet për sigurim pensional dhe invalidor, dhe me kërkesë të tyre bëhen analiza për të gjetur mënyrë për zgjidhjen e tyre. Në mënyrë reale mbërrijnë pagesat, ndërsa për to nuk kanë arritur të dhënat nga Drejtoria e të hyrave publike apo me arsye tjera nuk mund të jenë mjete të shpërndara. Një pjesë e këtyre pagesave problematike i zgjedh pjesa afariste me procedurat e vendosura, por edhe në sektorin e informatikës kryhen analiza dhe propozohen zgjidhje qoftë përmes proceseve ekzistuese dhe aplikimeve, apo përsëri përgatiten mjete të reja – aplikime për procesin e zgjidhjes së pagesave problematike. Pjesa më e rëndësishme nga pagesat e pashpërndara – jo të alokuara ka të bëjë me të dhënat

nga Drejtoria e të hyrave publike (LLMPI fletëparaqitje) për të cilat nuk ka fletëparaqitje përkatëse M1/M2.

Kthimi i mjeteve nga fondet pensionale private përmes Agjencisë për sigurim pensional me financim kapital. Për shkak natyrës së procesit të parashtrimit të LLMKRr /LLMPI fletëparaqitjeve, në disa raste nevojitet të bëhet kthimi i kontributit për sigurim pensional dhe invalidor në disa raste. Procesi është nën kontrollin e departamentit për pagesën dhe kontrollin e kontributeve. Në vitin 2011 automatizohet zbatimi i procedurave për kthim në nivel të ciklit ditor, por për shkak regjimit të këmbimit të të dhënave me Agjencinë për sigurim pensional me financim kapital realisht kompletohen për disa javë.

Në modulën e kontrollit ishte siguruar përkrahje informatike për gjenerimin e vendimeve për obliguesit tek të cilët është shkaktuar ndryshim në të dhënat në sistemin për pagesën e kontributeve. Janë paraqitur ndryshimet e të dhënave në Byronë e kredisë Maqedonase.

Për përgatitjen e projektit për shërim në banjën klimaterike të përfituesve të pensionit, nga Ministria e punës dhe politikës sociale, është përpunuar aplikacion i ri i Orakl platformës, sepse përfundoi përdorimi i BMS sistemit të vjetër. Aplikacioni do të shfrytëzohet në fillim të vitin 2012 përderisa detyrat rrjedhëse, mirëmbajtja e aplikacioneve të cilat kanë specifikat e tyre që dalin nga definicionet afariste, teknologjia e informatikës dhe vendimi i programit në tërësi për çdo njëërën prej tyre kryhen ndryshime apo intervenime të rregullta, kontrollin e rezultateve, qasje analitike dhe kryerje me kohë e korrigjimeve në vendimet afariste – aplikative.

Aktivitetet për implementimin e projektit për Resurse njerëzore, në të cilin është edhe aplikimi i përhershëm për kalkulimin e pagës, duhet të përfundojë. Për këtë qëllim është bashkëpunuar me firmë të jashtme dhe janë transferuar të dhëna që të sigurohet kontinuitet.

Në vitin 2011 departamenti për Komunikim dhe sistemi i inxhinierisë me sukses i ka implementuar dhe realizuar aktivitetet në vijim:

1. Zgjerimin e hapësirës së IMB System Storage DS4800 model 88 duke shtuar disqet e forta dhe zgjerimin e RAM Memories të blade serverëve ku është instaluar VMWARE, implementimi i propozimeve nga projekti për depërtimin e rrjetit të Fondit, furnizim të San (storage of Array Networks) të ri për arkiv të M4, M8 të skenuara dhe mikrofilmat, instalim të softuerit për menaxhim qendror të serverëve dhe kompjuterëve, instalim dhe konfigurim të dikaster center, përmirësim të shpejtësisë së MetroEternitetot dhe aktivizimin e VPN me instalim të ruterit, furnizim dhe instalim të Rack 42U për njësitë rajonale për vendosjen e pajisjes së instaluar (dokumentacioni i tenderit, procedura, instalim).

2. Furnizim dhe instalim i Switch Cisco 24/48 ports 10/100/1000 bps për NJR (dokumentacion të tenderit, procedurë, realizim), implementim të Quality of Service (QoS) të ruterëve, projekt i përkrahur nga grantet e Bashkimit Europian për digjitalizim të plotë të arkivave me Mikrofilm dhe dosje pensionale, implementim të Oracle Single Sign – on co Active Directory.

Në pjesën e sistemit të përpunimit të të dhënave janë realizuar dhe harmonizuar këto përpunime:

- Pranimi i e-mail –eve të arritura çdo ditë nga Trezori dhe të njëjtat azhurnohen në oracle – 260 e-mail-e.
- Pranimi i e-mail-eve të arritura çdo ditë nga DHP dhe të njëjtat azhurnohen në oracle – 26 e-mail-e (m11)
- Pranimi i ndryshimeve nga bankat (lajmërime dhe çlajmërime) dhe të njëjtat azhurnohen, ndërsa informacionet nga përpunimi dorëzohen deri te BANKAT.

Në vitin 2011 grupi për skenimin dhe arkivimin e fletëparaqitjeve punonte në arkivimin e 500.000 fletëparaqitjeve M1/M/2M/4 si prioritet në punë, përpunim i rregullt i fletëparaqitjeve M4 që arrijnë tek ne nga aktivitetet e rregullta të njësive rajonale (projekt pako ditore). Gjithashtu përfundon kontrolli i rregullt rrjedhës i

mikro filmave të digjitalizuar që kanë arritur për punë dhe mundësimin e On –Line gasje dhe kopjet e shfletuara nga fletëparaqitjet e arkivuara të të gjithëve të cilëve kjo u është e nevojshme sipas vendit të punës.

12. Ekonomizim me pronën e Fondit dhe standardin shoqëror të përfituesve të pensionit

Në vitin 2011 Departamenti për ekonomizim me pronën e Fondit, në mbështetje të programit për punë i miratuar nga Këshilli drejtues zbatoi një sërë aktivitete në lidhje me kompetencat e sajë dhe obligimet për funksionim kualitativ të shtëpive për jetesë të përfituesve të pensionit, ekonomizim me hapësirën banesore dhe afariste, zbatimin e programit për rikonstruim, adaptim dhe mirëmbajtje investuese të objektit të Fondit sikurse filialet dhe Qendrën ashtu edhe një pjesë të shtëpive të pensionistëve, dhënien e objekteve për pushim dhe rekreacion për të punësuarit në Fond, sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e objekteve në pronësi të Fondit në evidencën e kadastërit dhe marrjen e fletë pronësive.

Në Vend ka gjithsej 37 shtëpi për jetesë të përfituesve të pensionit prej të cilave, me 17 ekonomizon Fondi për vendosjen e përfituesve të pensionit të cilat disponojnë me 341 njësi banesore. Apartamente të lira ka dy në shtëpinë e pensionistëve në Shën Nikollë me arsye se nuk ka kërkesë nga përfituesit e pensionit të cilët i plotësojnë kushtet për vendosje dhe një në Gostivar për të cilin apartament udhëhiqet kontest gjyqësor për shpërngulje. Qiraja për shfrytëzimin e hapësirës banesore paguhet rregullisht nëpërmjet mbajtjes

nga pensioni përderisa shpenzimet tjera (shërbime komunale) me vështirësi më të vogla paguhen drejtpërdrejtë nga përfituesit. Huamarrja totale në bazë të qirasë për hapësirë banesore për vitin 2011 arrin 2,93 milion denarë, ndërsa janë paguar mjete në shumë prej 2,91 milion denarë apo 99,3%.

Dhënia e hapësirës së lirë për jetesë të përfituesve të pensionit kryhet gjatë lirimit të apartamenteve në mbështetje të shpalljes dhe vendimeve të miratuara nga ana e komisioneve në filialet. Në vitin 2011 janë lidhur gjithsej 35 marrëveshje në të gjitha shtëpitë në Vend. Shtëpitë për jetesë rregullisht mirëmbahen, ndërsa me këtë krijohen kushte të mira për jetesë të përfituesve të pensionit.

Fondi disponon edhe me hapësirë afariste në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit në sipërfaqe prej 6.355,98 m² prej të cilit është dhënë 5.248,1 m², ndërsa 1.107,88 m² nuk është dhënë me qira. Për dhënien me qira të hapësirës afariste shpallen konkurse, ndërsa komisioni i posaçëm nga Fondi kryen zgjidhjen për dhënien e të njëjtit. Në vitin 2011 Fondi në emër qira për hapësirë afariste ka faturuar gjithsej 12,52 milion denarë dhe 2,02 milion denarë kërkesa të bartura nga viti 2010, apo gjithsej 14,54 milion denarë, ndërsa nga qiratë janë paguar mjete në shumë prej 11,92 milion denarë apo 82% nga gjithsej kërkesat. Në vitin 2011 për pagesë jo të rregullt të qirasë janë parashtruar 3 padi.

Në vitin 2011 me dhënien e objekteve për pushim dhe rekreacion me të cilat disponon Fondi, në mbështetje me kërkesat e parashtruara janë realizuar 1.005 net nga ana e të punësuarve në Fond dhe të njëjtat nga viti në vit rriten për shkak kushteve të mira në pushimoret e Fondit.

Në vitin 2011 departamenti kishte zbadhuar aktivitetet edhe rreth azhurnimit të dokumentacionit për regjistrimin e pronës së Fondit në Agjencinë e kadastërit të patundshmërive. Fondi në vitin 2011 zbatoi procedurë për zgjidhjen e firmës së autorizuar gjeodezike për përpunimin e elaboratit gjeodezik për regjistrimin e objekteve dhe ndarjes fizike të objekteve të përbashkëta me Fondin e sigurimit shëndetësor të Maqedonisë. Janë përpunuar elaborate gjeodezike për 12 objekte dhe për të njëjtat udhëhiqet procedurë për regjistrim në Agjencinë e kadastërit të patundshmërive. Janë marrë fletë pronësi për ekspoziturën në Kratovë dhe klubin në Draçevë.

Aktiviteti për regjistrimin e objekteve do të vazhdojë edhe në vitin 2012. Gjithashtu në mbështetje të ligjit për trajtim me objektet e ndërtuara në mënyrë të pa ligjshme, Fondi deri te Ministria e Transportit dhe lidhjeve ka parashtruar 29 kërkesa për objektet për të cilat nuk disponon dokumentacion teknik që të mund t'i realizojë të njëjtat.

Invesime në vitin 2011

Në vitin 2011 janë bërë aktivitete investuese në kuadër të mjeteve të parapara me Buxhetin e Fondit për vitin 2011 me qëllim që të kërkohen kushtet për punën e të punësuarve, si dhe në shtëpitë për qëndrim të përfituesve të pensionit që të përmirësohen kushtet për qëndrim të përfituesve të pensionit në shtëpitë e pensionistëve.

- Qendra, filiale dhe ekspozitura

Janë bërë më shumë orvatje investuese në Qendër, filiale dhe ekspoziturat:

Ndërtesa administrative – Qendra – Shkup. Në vitin 2011 në objektin e ri – ndërtesa administrative e Fondit janë realizuar këto aktivitete: janë vendosur trape hekurudhore për sigurimin e parkingut, mbrojtjen e drunjve përreth gardhit, janë vendosur rrjete në dritaret në katin e katërt, përpunim i ndarjes metalike në hapësirat e bodrumit, është rirregulluar një zyrë në katin e tretë, sanim i bekatonit dhe izolimit, sanimi i gypit përçues në rrugë i cili ishte i dëmtuar.

Në filialin në Gostivar është kryer ri rregullim i një pjese të korridorit me çka është fituar edhe një hapësirë. Gjithashtu është kryer riparim i mbulojës së çatisë.

Në mbështetje të nevojave dhe mjeteve financiare të parapara në Buxhet, Fondi edhe më tutje do të vazhdojë me investime për mirëmbajtje investuese të objekteve me çka kushtet për punën e të punësuarve dhe përfituesve të shërbimeve nga Fondi do të jenë në një nivel solid.

- *Shtëpitë për jetesë*

Në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit në vitin 2011 u vazhdua investimi në përmirësimin e kushteve për vendosjen e shfrytëzuesve të pensionit.

Në Shtëpinë për jetesë të pensionistëve në Gjorçe Petrov është bërë ndërrimi i dyerve të brendshme të vjetruara në koridore me PVC dyer të reja, është mbuluar ballkoni i pakalueshëm me fletë plastike, janë ndërruar ullukët me ollukë të rij vertikal me fletë plastike.

Në Shtëpinë për jetesë të pensionistëve në Autokomandë është kryer ndërrim i dyerve dhe portalet të cilat ishin vjetruar me PVC dyer të reja dhe portale me çka janë mbrojtur banorët nga të ftohti nëpër korridore.

Me këto investime në mënyrë të konsiderueshme janë përmirësuar kushtet për jetesë të përfituesve të pensionit në Shtëpitë e pensionistëve. Fondi edhe më tutje do të vazhdojë me aktivitetet mbi investimin në shtëpitë, në mbështetje me nevojat dhe në mbështetje me mjetet në dispozicion për këtë synim.

PËRFUNDIM

Raporti vjetor për punën e Fondit për vitin 2011, sistematikisht dhe detajisht e paraqet realizimin e të gjitha funksioneve të rëndësishme të zbatimit të sigurimit pensional dhe invalidor të shprehura nëpërmjet treguesve të shumtë statistikor dhe treguesve të tjerë.

Pjesa hyrëse në formë të shkurtër i paraqet aktivitetet e rëndësishme të Fondit në vitin 2011, ndërsa në vazhdim të raportit në mënyrë krahasuese edhe në mënyrë analitike janë shfaqur rezultatet e realizuara.

Me të hyrat e realizuara në vitin 2011 dhe mjetet e bartura monetare nga viti 2010, Fondi rregullisht dhe në kohë të duhur i kryente obligimet ndaj shfrytëzuesve të pensionit dhe obligimet tjera.

Fondi punën e tij në vitin 2011 e ka kryer me sukses dhe në mënyrë efikase e cila rrjedh nga të dhënat e detajuara për kryerjen e detyrave.

Të siguruarit dhe shfrytëzuesit e pensionit pa pengesë kanë realizuar të drejtat e tyre në Fond në mbështetje me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Fondit.

Fondi pagesën e pensioneve e ka kryer rregullisht në afatet e parapara, si dhe harmonizimin e pensioneve në mbështetje me dispozitat ligjore.

Në shërbimin profesional të Fondit implementohet Projekti i ri pensional me të cilin ngrihet procedura për realizimin e të drejtës së pensionit edhe në pjesën e pagesës së pensioneve.

* *

*

Këshilli drejtues i Fondit, në seancën e mbajtur më 3 maj të vitit 2012 miratoi Raportin për punën e Fondit gjatë vitit 2011.

Drejtor i Fondit

Bekim Neziri

Kryetar i Këshillit Drejtues të

Fondit

Aco Stojanov

Shkup, prill viti 2012